

Indeksi:

PJESA E PARË. PARIME TË PROCEDURËS SË FALIMENTIMIT	1
KREU I. Dispozita të Përgjithshme.....	1
Neni 1 Objekti i ligjit	1
Neni 2 Qëllimi i procedurës së falimentimit	1
Neni 3 Përkufizime	2
Neni 4 Parimi i trajtimit të barabartë dhe i barazisë.....	4
Neni 5 Parimi i efektivitetit ekonomik	4
Neni 6 Parimi i zbatimit të procedurës gjyqësore	4
Neni 7 Parimi i legjislacionit tëzbatueshëm.....	5
Neni 8 Parimi i shpejtësisë.....	5
Neni 9 Parimi i transparencës dhe i informimit.....	5
Neni 10 Debitori në procedurën e falimentimit.....	5
Neni 11 Sektorët me interes publik ose strategjik	5
Neni 12 Akses i publik.....	6
Neni 13 Juridiksioni i gjykatës së falimentimit.....	6
Neni 14 Hetimi gjyqësor nga gjykata e falimentimit	6
Neni 15 Juridiksioni i posaçëm i gjykatës së falimentimit	7
Neni 16 Juridiksioni i gjykatës së apelit.....	7
Neni 17 Kompetenca tokësore	8
Neni 18 Njoftimet dhe shpalljet	8
Neni 19 Roli i Agjencisë Kombëtare të Falimentimit	9
PJESA E DYTË. HAPJA E PROCEDURËS SË FALIMENTIMIT,PALET PJESEMMARRËSE DHE MASA E FALIMENTIMIT	10
KREU I. HAPJA E PROCEDURËS SË FALIMENTIMIT	10
Neni 20 Shkaqet e hapjes së procedurës së falimentimit.....	10
Neni 21 Kërkesa për hapjen e procedurës së falimentimit.....	10
Neni 22 Dokumentacioni që shoqëron kërkesën e debitorit.....	10
Neni 23 Detyrimi për kërkesën e hapjes së procedurës të falimentimit.....	11
Neni 24 E drejta dhe detyrimi i personave juridikë dhe shoqërive të thjeshta	11
Neni 25 Kërkesa e kreditorit	11
Neni 26 Shqyrtimi i çështjes dhe dhënia e vendimit për hapjen e procedurës së falimentimit.....	12
Neni 27 Pamjaftueshmëria e masës së falimentimit	12
Neni 28 Fondi i posaçëm publik.....	12
Neni 29 Detyrimi i dhënies së informacionit dhe i bashkëpunimit gjatë hapjes së procedurës së falimentimit.....	12
Neni 30 Urdhri për masa të përkohshme.....	13
Neni 31 Vendosja e masave të sigurisë	13
Neni 32 Administratori i përkohshëm i falimentimit	14
Neni 33 Shpallja publikisht e kufizimit të disponimit të pasurive.....	15
Neni 34 Pasojat që rrjedhin nga kufizimi i disponimit të pasurisë	15
Neni 35 Shfuqizimi i masave të sigurisë.....	15
Neni 36 Shpërblimi i administratorit të përkohshëm të falimentimit.....	16
Neni 37 Vendimi për hapjen e procedurave të falimentimit.....	16
Neni 38 Kërkesat ndaj kreditorëve dhe debitorëve.....	16
Neni 39 Caktimi i mbledhjeve	17
Neni 40 Shpallja publikisht e vendimit të hapjes së procedurës së falimentimit.....	17
Neni 41 Regjistri tregtar.....	17
Neni 42 Regjistri i Pasurive të Paluajtshme	17

Neni 43 Verifikimi nga Prokurori.....	18
Neni 44 Pasojat e ndërprerjes së procedurës së falimentimit për shkak të prishjes së vendimit për hapjen e procedurës së falimentimit.....	18
Neni 45 Kundërshtimi.....	18
KREU II. KLASIFIKIMI I KREDITORËVEDHE TË DREJTAT E TYRE.....	19
Neni 46 E drejta e veçimit.....	19
Neni 47 Kreditorët e siguruar	19
Neni 48 Shpenzime të procedurës së falimentimit.....	19
Neni 49 Shpenzimet e tjera administrative.....	19
Neni 50 Shlyerja e kreditorëve të masës së falimentimit.....	20
Neni 51 Kreditorët e falimentimit.....	20
Neni 52 Llogaritja e pretendimeve	20
Neni 53 Kreditorët e siguruar në rolin e kreditorëve të falimentimit.....	21
Neni 54 Kreditorët e falimentimit të rangjeve më të ulëta të preferimit.....	21
KREU III. ADMINISTRATORI I FALIMENTIMIT. ORGANET E PËRFAQËSIMIT TË KREDITORËVE	21
Neni 55 Caktimi i administratorit të falimentimit.....	22
Neni 56 Mbikëqyrja nga gjykata e falimentimit	22
Neni 57 Shkarkimi i administratorit të falimentimit.....	22
Neni 58 Zëvendësimi i administratorit të falimentimit.....	23
Neni 59 Përgjegjësitë e administratorit të falimentimit	23
Neni 60 Parashkrimi	23
Neni 61 Paga dhe shpërblimi i administratorit të falimentimit.....	23
Neni 62 Vendimet e gjykatës së falimentimit.....	24
Neni 63 Paraqitja e llogarive	24
Neni 64 Caktimi i komitetit të kreditorëve.....	24
Neni 65 Zgjedhja e anëtarëve të komitetit të kreditorëve	25
Neni 66 Detyrat e komitetit të kreditorëve	25
Neni 67 Shkarkimi i anëtarëve të komitetit të kreditorëve.....	25
Neni 68 Përgjegjësia e anëtarëve të komitetit të kreditorëve	25
Neni 69 Vendimet e komitetit të kreditorëve.....	26
Neni 70 Shpenzimet e anëtarëve të komitetit të kreditorëve.....	26
Neni 71 Thirrja e mbledhjes së kreditorëve	26
Neni 72 Kërkesa për thirrjen e mbledhjes së kreditorëve	26
Neni 73 Vendimet e mbledhjes së kreditorëve.....	27
Neni 74 Përcaktimi i të drejtës së votës.....	27
Neni 75 Prishja e vendimit të marrë nga mbledhja e kreditorëve.....	27
Neni 76 Vënia në dijeni e mbledhjes së kreditorëve	28
PJESA E TRETË. PASOJAT E HAPJES SË PROCEDURËS SË FALIMENTIMIT	29
KREU I. PASOJA TË PËRGJITHSHME	29
Neni 77 E drejta për transferimin dhe administrimin e masës së falimentimit	29
Neni 78 Disponimi nga debitori	29
Neni 79 Veprimet në favor të debitorit.....	29
Neni 80 Pasuria e trashëgimlënësit. Bashkësia vazhduese	30
Neni 81 Likuidimi i një shoqërie të thjeshtë ose ortakërie.....	30
Neni 82 Pezullimi i padive të ngritura.....	30
Neni 83 Vazhdimi i padive të ngritura, ku debitori është paditës	30
Neni 84 Vazhdimi i padive të ngritura, ku debitori është i paditur.....	30
Neni 85 Pretendimet e paraqitura nga kreditorët e procedurës së falimentimit.....	31
Neni 86 Ekzekutimi përpara hapjes së procedurës së falimentimit.....	31

Neni 87 Dëmi i përgjithshëm.....	31
Neni 88 Përgjegjësia e pakufizuar e ortakëve	31
Neni 89 Mbajtja e së drejtës për kompensim të ndërsjellë të pretendimeve.....	31
Neni 90 Fitimi i së drejtës për kompensim të ndërsjellë të pretendimeve	31
Neni 91 Ndalimi i kompensimit të ndërsjellë	32
Neni 92 Detyrimi i debitorit për të paraqitur të dhëna dhe për të bashkëpunuar	32
Neni 93 Detyrimet e debitorit për bashkëpunim në zbulimin e informacionit të falimentimit	33
Neni 94 Zbatimi i detyrave të debitorit.....	33
Neni 95 Kontrolli i postës së debitorit	33
Neni 96 Anëtarët e organit përfaqësues të debitorit. Punonjësit.....	34
Neni 97 Pagesat nga masa e falimentimit për shpenzimet e jetesës	34
KREU II. PËRMBUSHJA E VEPRIMEVE LIGJORE	34
Neni 98 Kontratat që vazhdojnë	35
Neni 99 Veprimet me data fikse. Titujt financiarë.....	35
Neni 100 Kontrata periodike.....	36
Neni 101 Rezerva e pronësisë	36
Neni 102 Vazhdimësia e kontratave	36
Neni 103 Debitori si qiramarrës ose leasing-marrës	36
Neni 104 Debitori në rolin e pronarit ose të qiradhënësit.....	37
Neni 105 Shitja e pasurive të debitorit të dhëna me qira.....	37
Neni 106 Moszgjidhja e kontratës së qirasë	37
Neni 107 Zgjidhja e kontratës së shërbimit	38
Neni 108 Mbarimi i porosisë	38
Neni 109 Pavlefshmëria e marrëveshjeve që bien ndesh me dispozitat e mësipërme.....	38
KREU III. KUNDËRSHTIMI I VEPRIMEVE TË DEBITORIT NË NJË PROCEDURË FALIMENTIMI..	38
Neni 110 Parimi i përgjithshëm	38
Neni 111 Kontratat me personat e lidhur me debitorin	39
Neni 112 Kundërshtimi i përmbushjes së detyrimit.....	39
Neni 113 Kundërshtimi i detyrimeve të përmbushur në mënyrë të parregullt.....	40
Neni 114 Veprimet që dëmtojnë drejtpërdrejt kreditorët e falimentimit.....	40
Neni 115 Dëmtimi i qëllimshëm	40
Neni 116 Veprimet juridike pa ose pothuaj pa shpërblim.....	40
Neni 117 Afatet Kohore	41
Neni 118 Pasojat ligjore	41
Neni 119 Kundërshtimi ndaj trashëgimtarëve dhe personave të tretë.....	41
PJESA E KATËRT. ADMINISTRIMI DHE DISPONIMI I MASËS SË FALIMENTIMIT	42
KREU I. SIGURIMI I MASËS SË FALIMENTIMIT	42
Neni 120 Marrja në zotërim e masës së falimentimit	42
Neni 121 Sendet e çmuara.....	42
Neni 122 Inventari i masës së falimentimit	42
Neni 123 Lista e kreditorëve	43
Neni 124 Kontrolli i pasurisë	43
Neni 125 Depozitimi në sekretarinë e gjykatës së falimentimit.....	43
Neni 126 Mbajtja e llogarive sipas të drejtës tregtare dhe të legjislacionit tatimor	43
KREU II. VENDIMI PËR DISPONIMIN	43
Neni 127 Mbledhja e raportimit.....	44
Neni 128 Vendimmarrja për ecurinë e mëtejshme të procedurës	44
Neni 129 Veprimet veçanërisht të rëndësishme.....	44
Neni 130 Disponimi i masës së falimentimit	44
KREU III. SENDE QË I NËNSHTROHEN TË DREJTËS SË RIPAGIMIT TË VEÇANTË	45

Neni 131 E drejta e disponimit të sendit.....	45
Neni 132 Njoftimi paraprak i shitjes.....	45
Neni 133 Mbrojtja e kreditorit nga shitja e vonuar	45
Neni 134 Shpërndarja e të ardhurave	46
Neni 135 Llogaritja e kontributit për shpenzimet.....	46
PJESA E PESTË RIPAGIMI I KREDITORËVE TË FALIMENTIMIT. NDËRPRERJA E PROCEDURËS.....	47
KREU I. PËRCAKTIMI I PRETENDIMEVE	47
Neni 136 Depozitimi i pretendimeve.....	47
Neni 137 Tabela e pretendimeve.....	47
Neni 138 Mbledhja për verifikimin e pretendimeve	47
Neni 139 Depozitimet e vonuara.....	47
Neni 140 Kushtet dhe pasojat e vërtetimit të pretendimeve.....	48
Neni 141 Pretendimet e kundërshtuara.....	48
Neni 142 Kompetenca e gjykatave për vërtetimin e pretendimeve	49
Neni 143 Kufijtë e vërtetimit të pretendimeve.....	49
Neni 144 Pasoja juridike të vërtetimit me rrugë gjyqësore.....	49
KREU II. SHPËRNDARJA	49
Neni 145 Pagimi i kreditorëve të falimentimit	49
Neni 146 Shpërndarja e pasurisë sipas radhës së preferimit.....	49
Neni 147 Përbushja e kërkesave.....	50
Neni 148 Lista e shpërndarjes	50
Neni 149 Fondet e mbajtura për të ripaguar pretendimet e kundërshtuara.....	50
Neni 150 Fondet e mbajtura për të ripaguar kreditorët me të drejtë ripagimi të veçantë	51
Neni 151 Fondet e mbajtura për ripagimin e pretendimeve me kusht	51
Neni 152 Ripagimi i mëvonshëm.....	51
Neni 153 Ndryshimi i listës së shpërndarjes	51
Neni 154 Kundërshtimet ndaj listës së shpërndarjes	51
Neni 155 Përcaktimi i pjesëve të pretendimit	52
Neni 156 Shpërndarja e fundit	52
Neni 157 Mbledhja përfundimtare	52
Neni 158 Depozitimi i shumave të mbajtura	52
Neni 159 Tepërcat pas shpërndarjes përfundimtare.....	53
Neni 160 Përfundimi i procedurës së falimentimit.....	53
Neni 161 Të drejtat e kreditorëve të falimentimit pas mbylljes së procedurës së falimentimit.....	53
Neni 162 Vendimi i gjykatës për shpërndarje të vonuar.....	53
Neni 163 Ankimi.....	54
Neni 164 Kryerja e shpërndarjes së vonuar	54
KREU III. NDËRPRERJA E PROCEDURËS.....	54
Neni 165 Pezullimi për mungesë të pasurive në masën e falimentimit	54
Neni 166 Mbyllja për shkak të zhdukjes së mëvonshme të shkakut për hapjen e procedurës së falimentimit.....	54
Neni 167 Ndërprerja me miratimin e kreditorëve	54
Neni 168 Procedura e ndërprerjes	55
Neni 169 Shpallja publikisht dhe pasojat ligjore të ndërprerjes.....	55
Neni 170 Ankimi	55
PJESA E GJASHTË MJETET DHE PROCEDURAT PËR PARANDALIMIN E LIKUIDIMIT. RIORGANIZIMI DHE RISTRUKTURIMI I BORXHIT	56
KREU I. RREGULLA TË PËRGJITHSHME.....	56

Neni 171 Qëllimi i parandalimit të likuidimit	56
Neni 172 Parandalimi përmes ristrukturimit të borxhit.....	56
Neni 173 Paraqitja e kërkesës për miratimin e marrëveshjes për ristrukturimin e borxhit	56
Neni 174 Publikimi i marrëveshjes së ristrukturimit.....	57
Neni 175 Pezullimi i veprimeve për shkak të marrëveshjes së ristrukturimit	57
Neni 176 Vendimi i gjykatë së falimentimit lidhur me Marrëveshjene Ristrukturimit të Borxhit ..	58
KREU II. PLANI I RIORGANIZIMIT	58
Neni 177 Parandalimi përmes riorganizimit.....	58
Neni 178 Paraqitja e planit të riorganizimit	58
Neni 179 Përmbajtja e planit.....	59
Neni 180 Pjesa paraqitëse	59
Neni 181 Pjesa arsyetuese.....	59
Neni 182 Krijimi i grupeve	59
Neni 183 Trajtimi i barabartë i pjesëtarëve brenda grupit	60
Neni 184 Të drejtat e kreditorëve me të drejtë ripagimi të veçantë	60
Neni 185 Të drejtat e kreditorëve të falimentimit	60
Neni 186 Të drejtat e kreditorëve të rangjeve më të ulëta	60
Neni 187 Të drejtat e ortakëve ose aksionerëve.....	61
Neni 188 Përgjegjësia e debitorit.....	61
Neni 189 Veprimet lidhur me të drejtat mbi pasuritë e paluajtshme	61
Neni 190 Administrimi dhe mbikëqyrja e pasurisë.Të ardhurat dhe plani financiar.....	61
Neni 191 Veprimet që kërkojnë pëlqim.....	62
Neni 192 Deklaratat shoqëruese të planit	62
Neni 193 Dorëzimi i planit	62
Neni 194 Mospranimi i planit	62
Neni 195 Komente për planin	63
Neni 196 Pezullimi i disponimit dhe shpërndarjes.....	63
KREU II. PRANIMI DHE MIRATIMI I PLANIT TË RIORGANIZIMIT	63
Neni 197 Mbledhja për diskutimin dhe mbledhja për votimin e planit	63
Neni 198 Mbledhja e veçantë për votim.....	64
Neni 199 Përputhja e datës së mbledhjes për diskutimin e planit me atë të mbledhjes për verifikimin e pretendimeve	64
Neni 200 E drejta e votës së kreditorëve të falimentimit.....	64
Neni 201 Lista e votimit	64
Neni 202 Ndryshimi i planit	64
Neni 203 Votimi në grupe.....	65
Neni 204 Shumica e nevojshme	65
Neni 205 Ndalimi i bllokimit	65
Neni 206 Miratimi i ortakëve/aksionereve.....	66
Neni 207 Miratimi i debitorit.....	66
Neni 208 Miratimi i planit nga gjykata e falimentimit.....	66
Neni 209 Pasojat e shkeljes së dispozitave procedurale	66
Neni 210 Mbrojtja e pakicave	66
Neni 211 Shpallja e vendimit	67
Neni 212 Ankimi.....	67
KREU IV. PASOJAT E PLANIT TË MIRATUAR. MBIKQYRJA E PËRMBUSHJES SË PLANIT	67
Neni 213 Pasojat e përgjithshme të planit.....	67
Neni 214 Të drejtat mbi sendet e luajtshme.....	68
Neni 215 Pretendimet e kundërshtueshme dhe pretendimet me zëvendësim.....	68
Neni 216 Zbatimet e planit.....	68

Neni 217 Publikimi i vendimit për miratimin e planit.....	69
Neni 218 Pasojat e verifikimit të planit nga gjykata.....	69
Neni 219 Mbrojtja kundrejt ekzekutimit.....	69
Neni 220 Periudha e kufizimeve të veçanta.....	69
Neni 221 Mbikëqyrja e zbatimit të planit dhe shpenzimet e mbikqyrjes.....	70
Neni 222 Subjektet mbikëqyrëse të zbatimit të planit të riorganizimit.....	70
Neni 223 Detyrimi i administratorit mbikëqyrës për të njoftuar	70
Neni 224 Konvertimi i procedurës nga riorganizimi në likuidim	70
Neni 225 Përfundimi i mbikëqyrjes	71
KREU V. VETADMINISTRIMI NGA DEBITORI.....	71
Neni 226 Kushtet.....	71
Neni 227 Anulimi i vendimit të gjykatës së falimentimit për vetadministrim	71
Neni 228 Publikimi	72
Neni 229 Statusi i administratorit mbikëqyrës	72
Neni 230 Miratimi nga administratori mbikëqyrës.....	72
Neni 231 Pëlqimi i komitetit të kreditorëve	72
Neni 232 Mospërfshirja e njërive mbikëqyrëse	73
Neni 233 Urdhër i gjykatës së falimentimit për miratim.....	73
Neni 234 Fondet për përballimin e jetesës së debitorit.....	73
Neni 235 Kundërshtimi i veprimeve të debitorit në vetadministrim.....	73
Neni 236 Detyrimi i debitorit për raportim	73
Neni 237 Zotërimi i kolateralit. Disponimi i garancive	74
Neni 238 Pagimi i kreditorëve të falimentimit	74
Neni 239 Plani i riorganizimit.....	74
PJESA E SHTATË. SHKARKIMI NGA DETYRIMET E PASHLYERA	75
KREU I.	75
Neni 240 Parimi.....	75
Neni 241 Kërkesa e debitorit për shkarkimin e detyrimeve të pashlyera	75
Neni 242 Vendimi i gjykatës së falimentimit për shkarkimin e detyrimeve të pashlyera.....	75
Neni 243 Refuzimi për shkarkimin nga detyrimi i mbetur.....	75
Neni 244 Statusi juridik i kujdestarit.....	76
Neni 245 Shpërblimi i kujdestarit	76
Neni 246 Trajtimi i barabartë i kreditorëve	77
Neni 247 Detyrimet e debitorit	77
Neni 248 Revokimi i shkarkimit të detyrimeve të pashlyera për shkak të shkeljes së detyrimevetë debitorit	77
Neni 249 Revokimi i shkarkimit të detyrimeve të pashlyera për shkak të dënimit penal	78
Neni 250 Revokimi për shkak të mospagimi të shpërblimit të kujdestarit	78
Neni 251 Përfundimi i parakohshëm.....	78
Neni 252 Vendimi për mbylljen e procedurës së falimentimit	78
Neni 253 Pasoja e mbylljes së procedurës së falimentimit	79
Neni 254 Detyrimet që nuk shkarkohen	79
Neni 255 Prapësimi i shkarkimit nga detyrimi i pashlyer	80
PJESA E TETË. PROCEDURA E FALIMENTIMIT PËR KONSUMATORËT DHE	
PROCEDURA TË TJERA MË PAK TË RËNDËSISHME.....	81
KREU I. FUSHA E ZBATIMIT.....	81
Neni 256 Parime të përgjithshme	81
KREU II. PLANI I SHLYERJES SË DETYRIMEVE	81
Neni 257 Kërkesa e debitorit për hapjen e procedurës së falimentimit	81

Neni 258 Pezullimi i procedurës.....	81
Neni 259 Shërbimi ndaj kreditorëve.....	82
Neni 260 Pranimi i planit të shlyerjes së detyrimeve.....	82
Neni 261 Zëvendësimi i miratimit	82
Neni 262 Shpenzimet	83
KREU III. PROCEDURË FALIMENTIMI E THJESHTUAR.....	83
Neni 263 Fillimi i punës për hapjen e procedurës së falimentimit	83
Neni 264 Thjeshtimet e përgjithshme të procedurës	83
Neni 265 Administratori i falimentimit në procedurën e falimentimit të thjeshtuar	83
Neni 266 Shpërndarja e thjeshtuar.....	84
PJESA E NENTË. LLOJE TË VEÇANTA TË PROCEDURËS SË FALIMENTIMIT	85
Kreu I. Procedurat e falimentimit mbi trashëgiminë	85
Neni 267 Kompetenca tokësore.....	85
Neni 268 Hapja e procedurës së falimentimit.....	85
Neni 269 E drejtë për të kërkuar hapjen e procedurës	85
Neni 270 E drejta e kërkesës mbi pasurinë martesore	86
Neni 271 Afati i kërkesës	86
Neni 272 Ekzekutimi ndaj trashëgimisë.....	86
Neni 273 Veprimi i kundërshtuar nga trashëgimtari.....	86
Neni 274 Shpenzimet e trashëgimtarit.....	86
Neni 275 Shpenzimet mbi pasuritë e përfshira në procedurat e falimentimit.....	86
Neni 276 Detyrimet mbi masën e falimentimit	87
Neni 277 Pretendimet e trashëgimtarit.....	87
Neni 278 Detyrimet e rangjeve më të ulëta.....	87
Neni 279 Objektet e kthyer.....	87
Neni 280 Blerja e Pasurisë trashëgimore.....	88
KREU II. PROCEDURAT E FALIMENTIMIT QË LIDHEN ME BASHKËPRONËSINË E NJË BASHKËSIE TË VAZHDUESHME	88
Neni 281 Referimi në hapjen e procedurës së falimentimit.....	88
KREU III. PROCEDURA E FALIMENTIMIT LIDHUR ME ADMINISTRIMIN E PËRBASHKËT TË PASURISË SË PËRBASHKËT MARTESORE.....	88
Neni 282 E drejta për të paraqitur kërkesë. Kushtet për hapjen e procedurës së falimentimit.....	88
Neni 283 Përgjegjësia personale e bashkëshortëve	89
PJESA E DHJETË. PROCEDURA E FALIMENTIMIT E LIDHURME SHITJE TË TJERA. 90	90
KREU I. DISPOZITA TË PËRGJITHSHME	90
Neni 284 Qëllimi i procedurave ndërkombëtare të falimentimit	90
Neni 285 Kufijtë e zbatimit të procedurave ndërkombëtare të falimentimit	90
Neni 286 Detyrimet ndërkombëtare të Shqipërisë sipas ligjit të falimentimit	90
Neni 287 Juridiksioni i falimentimit ndërkombëtar	91
Neni 288 Autorizimi i administratorit të falimentimit për të vepruar jashtë Shqipërisë.....	91
Neni 289 Refuzimi për Papajtueshmëri me Rendin Publik	91
Neni 290 Ndihma për përfaqësuesin e huaj.....	91
Neni 291 Interpretimi	91
KREU II. AKSESI I PËRFAQËSUESVE DHE KREDITORËVE TË HUAJ PËRPARA GJYKATËS SË FALIMENTIMIT	91
Neni 292 E drejta për akses të drejtpërdrejtë.....	91
Neni 293 Juridiksioni i kufizuar	92
Neni 294 E drejta e përfaqësuesit të huaj për fillimin e procedurës të falimentimit.....	92
Neni 295 Pjesëmarrja e një përfaqësuesi të huaj në procedurë falimentimi shqiptare	92

Neni 296 Aksesi i Kreditorëve në procedurë sipas ligjit shqiptar të falimentimit.....	92
Neni 297 Njoftimi i kreditorëve të huaj në një procedurë falimentimi sipas ligjit shqiptar.....	92
KREUIII. NJOHJA E PROCEDURAVE TË HUAJ TË FALIMENTIMIT DHE NDIHMAT	93
Neni 298 Kërkesa për njohje të procedurës së huaj.....	93
Neni 299 Presumime në lidhje me njohjen.....	93
Neni 300 Vendimi mbi njohjen e procedurës së huaj	94
Neni 301 Informacionet e mëvonshme.....	94
Neni 302 Ndihma që ofrohet gjatë aplikimit për njohjen e procedurës së huaj	94
Neni 303 Efektet e njohjes së procedurës kryesore të huaj	95
Neni 304 Ndihma që mund të garantohet pas njohjes së një procedure të huaj.....	95
Neni 305 Mbrojtja e kreditorëve dhe personave të tjerë të interesuar	96
Neni 306 Veprimet për të shmangur dëme ndaj kreditorëve.....	96
Neni 307 Ndërhyrja e përfaqësuesit të huaj në procedurën e falimentimit që zhvillohet në Shqipëri.....	96
KREUIV. BASHKËPUNIMI ME GJYKATAT E HUAJA DHE PËRFAQËSUESIT E HUAJ.....	97
Neni 308 Bashkëpunimi dhe komunikimi i drejtpërdrejtë midis gjykatës së falimentimit dhe gjykatave të huaja ose përfaqësuesve të huaj	97
Neni 309 Bashkëpunimi dhe komunikimi i drejtpërdrejtë midis administratorit të falimentimit dhe gjykatave të huaja ose përfaqësuesve të huaj.....	97
Neni 310 Format e bashkëpunimit.....	97
KREUV PROCEDURA TË NDËRTHURURA.....	98
Neni 311 Hapja e procedurës së falimentimit pas njohjes së procedurës kryesore të huaj	98
Neni 312 Ndërthurja e procedurës së falimentimit dhe procedurës së huaj	98
Neni 313 Ndërthurja e disa procedurave të huaja	98
Neni 314 Presumimi i paaftësisë paguese bazuar në njohjen e një procedure kryesore të huaj	99
Neni 315 Shlyerja e pagesave në procedurat e ndërthurura.....	99
PJESA E NJËMBËDHJETË. AGJENCIA KOMBËTARE E FALIMENTIMIT.....	100
Neni 316 Agjencia Kombëtare e Falimentimit.....	100
Neni 317 Statusi i Agjencisë.....	100
Neni 318 Përgjegjësitë e Agjencisë.....	100
Neni 319 Veprimtaria mbikëqyrëse e Agjencisë.....	100
Neni 320 Ekspertiza e huaj	101
Neni 321 Burimet e financimi të Agjencisë	101
Neni 322 Kundërvajtjet Administrative	101
Neni 323 Kundërvajtjet administrative të administratorit	101
Neni 324 Dispozita Tranzitore	102
Neni 325 Ky ligj hyn në fuqi	102



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

KUVENDI

PROJEKTLIGJ

Nr. ____ / 2015

“PËR FALIMENTIMIN”

Në mbështetje të neneve 78, 81 dhe 83, pika 1 të Kushtetutës, me propozimin e Këshillit të Ministrave,

KUVENDI

I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

V E N D O S I:

PJESA E PARË

PARIME TË PROCEDURËS SË FALIMENTIMIT

KREU I

DISPOZITA TË PËRGJITHSHME

Neni 1

Objekti i ligjit

Objekti i këtij ligji është të caktojë rregulla të detyrueshme, të njëjta dhe të barabarta, si dhe të lehtësojë zgjidhjen dhe shlyerjen e detyrimeve të debitorit brenda dhe/ose jashtë procedurës së falimentimit.

Neni 2

Qëllimi i procedurës së falimentimit

1. Procedura e falimentimit ka qëllim të shlyejë, në mënyrë kolektive, detyrimet e debitorit nëpërmjet likuidimit të të gjitha pasurive të tij dhe shpërndarjes së të ardhurave, ose, nëpërmjet riorganizimit ose arritjes së një marrëveshjeje tjetër të re, me synim kryesor ruajtjen e veprimtarisë së debitorit.
2. Procedura, në kuptim të këtij ligji, mund të realizohet nëpërmjet:
 - a) Likuidimit,
 - b) Riorganizimit,

Draft Ligji i Falimentimit

- c) Ristrukturimit të borxhit për konsumatorët me të ardhura të rregullta, ose
 - d) Ristrukturimit të borxhit për subjektet tregtare përmes marrëveshjeve jashtëgjyqësore, të miratuara nga gjykata e falimentimit.
3. Çdo debitori të ndershëm, nëpërmjet procedurës së falimentimit, i jepet mundësia të shkarkohet nga pjesa e mbetur e detyrimeve.

Neni 3 **Përkufizime**

Në kuptim të këtij ligji:

1. “Administrator i falimentimit” është shtetasi shqiptar i cili ka kryer arsimin e lartë dhe ka një eksperiencë punë jo më pak se tri vjet, është trajnuar dhe licencuar nga Agjencia Kombëtare e Falimentimit për të ushtruar këtë funksion sipas kushteve dhe kritereve të përcaktuara nga ky ligj dhe caktohet me këtë detyrë nga gjykata e falimentimit.
 - a) “Administrator i përkohshëm i falimentimit” është administratori i cili caktohet nga gjykata e falimentimit përpara hapjes së procedurës së falimentimit dhe vepron për një periudhë kohe të caktuar.
 - b) “Administrator mbikëqyrës” është administratori që në rastin e procedurës së riorganizimit ose vetadministrimit nga debitori caktohet me këtë detyrë nga gjykata e falimentimit.
2. “Agjenci Kombëtare e Falimentimit” (Agjencia) është organi kompetent shtetëror për mbikëqyrjen, trajnimin dhe licencimin e veprimtarisë së administratorëve të falimentimit si dhe për të ndihmuar gjykatën e falimentimit për zbatimin elegjisacionit të falimentimit në Republikën e Shqipërisë.
3. “Bashkësi e administruar në mënyrë të përbashkët” është çdo bashkim i pasurive ose i mjeteve financiare të bashkëshortëve sipas regjimeve pasurore të Kodit të Familjes ose të bashkëjetuesve, për qëllime të përbashkëta me natyrë ekonomike.
4. “Bashkësi e vazhdueshme” është bashkësia pa personalitet juridik, e pasurive ose mjeteve financiare të dy ose më shumë personave, për një qëllim të përbashkët me natyrë ekonomike por jo tregtare.
5. “Debitor” është personi fizik ose juridik, privat ose publik, i cili paraqet ose ndaj të cilit paraqitet kërkesa e fillimit të procedurës së falimentimit.
6. “Detyrim i maturuar” ose “detyrim i kërkueshëm” është detyrimi me afat shlyerjeje të përcaktuar paraprakisht nga palët, i cili nuk është përmbushur ndonëse ka skaduar afati i shlyerjes, ose detyrimi që është parashikuar nga palët pa afat, me kusht që të kenë kaluar 15 ditë nga dita kur kreditori i kërkon debitorit shlyerjen e këtij detyrimi.
7. “Ekspert i gjykatës” është profesionisti i kualifikuar në fushat e teknikës ose shkencës, i pavarur nga palët, dhe i regjistruar si i tillë paraprakisht në regjistrin e ekspertëve të mbajtur nga gjykata e falimentimit.
8. “Ekspert i palës” është profesionisti i kualifikuar, që ka njohuri të posaçme të provuara në fushat e teknikës ose shkencës që asiston palët në proces me mendimin e vet të pavarur përmesnjë akti të shkruar ose thirrjes së tij si dëshmitar.
9. “Ekzekutor i testamentit” është personi i cili vepron sipas nenit 314 të Kodit Civil.
10. “Familje bujqësore” është:
 - a) anëtarë ose anëtarët e saj sipas përkufizimit të nenit 223 të Kodit Civil, të cilët janë të angazhuar në veprimtari bujqësore të tilla si punimin e tokës, administrimin blegtoral të bagëtive, të kafshëve të prodhimit dhe të punës; prodhimin dhe vjeljen e të

korrave; prodhimin dhe administrimin e pularive dhe të shpendëve të tjerë; si dhe prodhimin natyror në gjendje të papërpunuar nga pularitë dhe bagëtitë, nga e cila marrin më shumë se 50 % të të ardhurave bruto kryesore vjetore sipas përllogaritjeve të bëra deri ditën e paraqitjes së kërkesës;

- b) është shoqëria e bashkëpunimit bujqësor e cila krijohet dhe ushtron veprimtarinë e saj në përputhje me ligjin nr.38/2012 “Për shoqëritë e bashkëpunimit bujqësor” dhe në të cilën më shumë se 50 për qind e aksioneve ose e kapitalit neto është në pronësi të një familjeje, ose zotërohet nga një familje dhe prej anëtarëve të saj, dhe kur kjo familje ose anëtarët e saj kryejnë veprimtari bujqësore, dhe më shumë se 80 për qind e vlerës së aseteve të saj konsistojnë në veprimtari bujqësore.

11. “Fond publik i posaçëm” është fondi që administrohet nga Agjencia Kombëtare e Falimentimit dhe që përdoret për të mbuluar shpenzimet e likuidimit në një procedurë falimentimi në rast të pamjaftueshmërisë të pasurisë së debitorit për të mbuluar shpenzimet e procedurës së falimentimit.

12. “Gjykatë e falimentimit”, në kuptim të këtij ligji, është gjyqtari i vetëm i seksionit tregtar të gjykatës së rrethit gjyqësor.

13. “Gjykatë e huaj” është autoriteti kompetent për të kontrolluar ose monitoruar një procedurë të huaj.

14. “Kreditor i masës së falimentimit” është kreditori, kredia e të cilit ka lindur për shkak të financimit të shpenzimeve të procedurës së falimentimit të cilat shlyhen nga masa e falimentimit përpara pretendimeve të kreditorëve të falimentimit.

15. “Kreditor me të drejtë ripagimi të veçantë” është kreditori që pretendon të veçojë një send nga masa e falimentimit për shkak të një të drejte pronësie, si dhe kreditori që nëpërmjet një veprimi juridik ka vendosur garanci mbi sendin ose ka fituar, për shkak të ligjit, një të drejtë garancie mbi sendet e masës së falimentimit.

16. “Kujdestar” është çdo person fizik i caktuar nga gjykata e falimentimit për t'u kujdesur lidhur me përmbushjen e një detyrimi, zbatimin e një kontrate, ekzekutimin e detyrueshëm ndaj pasurisë së debitorit si dhe për detyra të tjera të caktuara rast pas rasti nga ligji ose vendimi i gjykatës së falimentimit.

17. “Kujdestar i pasurisë trashëgimore” është personi që vepron në bazë të nenit 344 të Kodit Civil.

18. “Likuiditet” është tërësia e mjeteve të pagesës të sigurta, si edhe e pasurisë të konvertueshme lehtësisht në mjete të pagesës të sigurta, të cilat disponohen nga debitori në momentin e fillimit të procedurës së falimentimit.

19. “Masë e falimentimit” është gjithë pasuria dhe të drejtat e debitorit në datën e hapjes së procedurës së falimentimit si dhe pasuria që ai fiton gjatë zbatimit të kësaj procedure, në territorin e Republikës së Shqipërisë dhe jashtë tij, me përjashtim të sendeve që, sipas dispozitave të Kodit të Procedurës Civile, përjashtohen nga ekzekutimi i detyrueshëm.

20. “Paaftësi paguese” është gjendja kur debitori, pavarësisht nëse është person juridik ose person fizik, nuk është i aftë të paguajë detyrimet e faturuara për shkak të mungesës së likuiditetitose, në rastin e një personi juridik, kur detyrimet e debitorit kapërcejnë totalin e pasurisë së tij në mënyrë të tillë që, sipas rrethanave, aktivitetit i debitorit nuk ka mundësi të vazhdojë për shkak të mbingarkesës në borxhe.

21. “Palë pjesëmarrëse” është çdo subjekt që bëhet pjesë e procedurës së falimentimit me statusin e debitorit, kreditorit ose të një pjesëmarrësi tjetër sipas parashikimeve të këtij ligji, duke realizuar të drejta dhe duke shlyer ose marrë përsipër detyrime.

22. “Person i lidhur me debitorin” është çdo person fizik ose juridik, i cili rezulton të ketë pasur ose të ketë lidhje interesi, pasurore ose personale jo pasurore me debitorin në formën e angazhimeve në veprimtari private me qëllim fitimi ose çdo lloj veprimtarie, që krijon të ardhura, si dhe angazhime në organizata fitimprurëse dhe jo-fitimprurëse, sindikata ose organizata profesionale, politike, shtetërore dhe çdo organizatë tjetër; për shkak të një marrëdhënie shoqërore, familjare dhe bashkëjetese, si dhe çdo marrëdhënie trashëgimore, kujdestarie ose pune, sipas nenit 3/11, pikat d), dh) dhe i) të ligjit 9367/2005, i ndryshuar, si edhe sipas nenit Neni 111 të këtij ligji.

23. “Përfaqësues i huaj” është personi ose institucioni, duke përfshirë edhe një të përkohshëm, i autorizuar nga një procedurë e huaj për të administruar riorganizimin ose likuidimin e pasurive ose të biznesit të debitorit ose që të operojë si përfaqësues i një procedure të huaj.

24. “Procedurë dytësore e huaj” është procedura e huaj që, në ndryshim nga procedura kryesore e huaj, zhvillohet në një shtet të huaj ku debitori ka vendndodhjen e një veprimtarie.

25. “Procedurë kryesore e huaj” është procedura e huaj që zhvillohet në një shtet të huaj ku debitori ka qendrën kryesore të interesit.

26. “Procedurë e huaj” është procedura kolektive juridike ose administrative në një shtet të huaj, duke përfshirë një procedurë të përkohshme, në lidhje me një ligj falimentimi ku procedurat mbi pasuritë dhe biznesin e debitorit, në lidhje me riorganizimin ose likuidimin e tij, janë subjekt i kontrollit ose monitorimit të një gjykatë të huaj.

27. “Qendër kryesore interesi” është vendi ku debitori në mënyrë të rregullt zhvillon administrimin e aktivitetit të vet dhe kur kjo njihet si e tillë nga palët e treta. Në rastin e një tregtari, shoqërie tregtare ose personi juridik, vendi ku debitori është regjistruar prezumohet si qendra kryesore e interesit nëse nuk vërtetohet e kundërta.

28. “Shkarkim i detyrimeve të pashlyera” është shuarja, me anë të vendimit të gjykatës së falimentimit, i një ose disa detyrimeve kundrejt një ose më shumë kreditorëve.

29. “Vendbanim” është vendi ku personi fizik, për shkak të punës ose të shërbimit të përhershëm, të ndodhjes së pasurisë ose të realizimit të interesave të veta, qëndron zakonisht ose të shumtën e kohës.

Neni 4

Parimi i trajtimit të barabartë dhe i barazisë

1. Gjatë procedurës së falimentimit kreditorët trajtohen në mënyrë të barabartë dhe në pajtim me statusin e tyre sipas rregullimeve të këtij ligji.
2. Kreditorët e së njëjtës radhë pagese janë të barabartë.

Neni 5

Parimi i efektivitetit ekonomik

Fazat e procedurës së falimentimit synojnë zgjidhjen dhe përmbushjen e interesave të kreditorëve në një masë sa më të lartë të mundshme kundrejt kostove sa më të ulëta.

Neni 6

Parimi i zbatimit të procedurës gjyqësore

Procedura e falimentimit, pas hapjes së saj, realizohet nga gjykata e falimentimit sipas këtij

ligji.

Neni 7

Parimi i legjislacionit tëzbatueshëm

1. Procedura e falimentimit rregullohet me këtë ligj.
2. Dispozitat e Kodit të Procedurës Civile dhe të ligjeve të tjera, zbatohen për çështjet që nuk janë të rregulluara me këtë ligj, për aq ato sa nuk bien në kundërshtim me të.

Neni 8

Parimi i shpejtësisë

1. Procedura e falimentimit zhvillohet nëpërmjet një procesi të rregullt dhe brenda afateve të shpejta e të arsyeshme.
2. Gjatë procedurës së falimentimit nuk lejohet pezullimi ose ndërprerja e kësaj procedure, përveç rasteve kur është parashikuar shprehimisht në këtë ligj.

Neni 9

Parimi i transparencës dhe i informimit

1. Procedura e falimentimit është publike.
2. Palët pjesëmarrëse në procedurën e falimentimit kanë të drejtë të njihen me të dhënat për zbatimin e procedurës, përveç kur me ligj parashikohet ndryshe.

Neni 10

Debitori në procedurën e falimentimit

1. Procedura e falimentimit e rregulluar nga ky ligj i shtrin efektet e veta mbi çdo debitor qoftë ky individ, tregtar, familje bujqësore, person juridik privat ose publik, fitimprurës ose jofitimprurës që ndjek qëllime ekonomike, shoqëri e thjeshtë, ose njësi administrative vendore.
2. Procedura e falimentimit mund të hapet edhe për pasurinë e trashëgimlënësit, bashkëpronësinë e bashkëshortëve sipas regjimit të bashkësisë ligjore dhe bashkësisë me kontratë, pronën e përbashkët të një bashkësie të vazhdueshme ose të një bashkësie të administruar në mënyrë të përbashkët.
3. Në rast se nuk është kryer ndarja e pasurisë, procedura e falimentimit mund të hapet edhe pas prishjes ose shpërndarjes së një personi juridik ose të një shoqërie të thjeshtë.
4. Subjektet publike ose njësitë administrative vendore, të tilla si: njësitë e administrimit vendor, institucionet, entet publike, e të tjera të ngjashme me to, të përcaktuara me Vendim të Këshillit të Ministrave, me përjashtim të ndërmarrjeve publike, i nënshtrohen vetëm procedurës së falimentimit nëpërmjet riorganizimit, pasi të merret leja e Kontrollit të Lartë të Shtetit.

Neni 11

Sektorët me interes publik ose strategjik

1. Procedura e falimentimit nuk mund të hapet për subjektet që ushtrojnë veprimtari në sektorët me interes publik dhe të caktuar si strategjikë, të tillë si: hekurudhat, furnizimi me energji elektrike, furnizimi me gaz, ujë, si dhe subjektet që ushtrojnë aktivitetin në fushën e sigurimeve, bankat, institucionet financiare, shoqatat e kursimeve dhe kredive, dhe të tjera, falimentimi i të cilave rregullohen me ligje të veçanta, për sa kohë ato janë të licencuar për kryerjen e këtyre veprimtarive.
2. Nga momenti që subjektet sipas pikës 1 të këtij neni nuk lejohen të ushtrojnë veprimtarinë e tyre në sektorin publik ose strategjik, këta këto mund të jenë subjekte të ligjit të falimentimit.
3. Në rast se ligjet e veçanta që rregullojnë sektorët publik ose strategjik, nuk parashikojnë rregulla mbi falimentimin, atëherë çdo subjekt, sipas pikës 1 të këtij neni, ka të drejtë të kërkojnë hapjen e procedurës së falimentimit, vetëm pasi të marrë lejen paraprake nga autoriteti rregullator përkatës.

Neni 12

Aksesi publik

1. Me kërkesë të një pale pjesëmarrëse në procedurën e falimentimit, administratori i falimentimit, brenda një afati të arsyeshëm, ukrijon mundësinë palëve të njihen me dokumentacionin e procedurës së falimentimit.
2. Gjykata e falimentimit ose administratori i falimentimit me kërkesë të palëve ose kryesisht, refuzon dhënien e informacionit nëse, për mbrojtjen e interesave të debitorit, konstaton se zbulimi i të dhënave përbën sekret tregtar, rrezik për debitorin ose pasurinë e tij, si dhe në raste të tjera të parashikuar me ligj.

Neni 13

Juridiksioni i gjykatës së falimentimit

1. Procedura e falimentimit sipas këtij ligji realizohet nga gjykata e falimentimit e cila disponon me vendime ose urdhra.
2. Vendimet dhe urdhrat e gjykatës janë të ekzekutueshme menjëherë. Ankimet ndaj vendimit nuk pezullojnë ekzekutimin e vendimit, me përjashtim të rasteve kur parashikohet ndryshe në këtë ligj.
3. Gjykata e falimentimit shqyrton dhe vendos lidhur me kërkesën për hapjen e procedurës së falimentimit jo më vonë se 60 ditë nga dorëzimi i kërkesës në sekretarinë e gjykatës.
4. Gjykata e falimentimit, në varësi të natyrës së çështjes, e shqyrton çështjen ose gojarisht në seancë dëgjimore ose në dhomën e këshillimimbi bazë aktesh shkresore. Mosparaqitja e palëve në gjykim nuk e pengon shqyrtimin e çështjes.

Neni 14

Hetimi gjyqësor nga gjykata e falimentimit

1. Gjykata e falimentimit heton kryesisht të gjitha rrethanat që kanë lidhje me procedurën e falimentimit.
2. Gjatë hetimit gjyqësor, gjykata e falimentimit mund të marrë si provë opinionin e ekspertit të palës ose/dhe të ekspertit të caktuar nga vetë gjykata e falimentimit.

3. Nëse gjykata e falimentimit ka dyshime për konkluzionet e akteve të ekspertimit të kërkuara nga palët, ose nëse ajo e çmon të nevojshme, mund të kërkojë ekspertimin si provë sipas këtyre rregullave. Në vendimin për kryerjen e ekspertimit përcakton fushën e ekspertimit, ekspertin nga lista e ekspertëve të regjistruar në gjykatë, detyrat përkatëse si dhe afatin e kryerjes së ekspertimit, i cili, si rregull nuk mund të jetë më i gjatë se 20 ditë.

Eksperti ka të drejtë të njihet me aktet e çështjes dhe nuk mund të refuzojë pa shkak të ligjshëm detyrën e caktuar.

4. Vendimi për kryerjen e ekspertimit u njoftohet menjëherë palëve në gjykim dhe ekspertit. Bashkë me vendimin për kryerjen e ekspertimit, gjykata e falimentimit i kërkon ekspertit të plotësojë dhe të nënshkruajë një deklaratë personale për dijeninë e tij për përgjegjësinë penale në rast ekspertimi të rremë dhe e fton që të bëjë betimin se do të kryejë mirë e me nder detyrat që i janë besuar, me të vetmin qëllim që t'ia bëjë të ditur gjykatës së falimentimit të vërtetën. Kjo deklaratë dorëzohet në sekretarinë e gjykatës së falimentimit së bashku me aktin e ekspertimit. Forma dhe përmbajtja e deklaratës miratohen me Urdhër të Ministrit të Drejtësisë.

5. Palët, brenda 3 ditëve nga njoftimi i vendimit kanë të drejtë të depozitojnë pretendimet e tyre me shkrim në lidhje me paanshmërinë, njohuritë e posaçme të ekspertit në fushën përkatëse dhe të kërkojnë përjashtimin e tij nëse janë kushtet e përcaktuara në nenin 72 të Kodit të Procedurës Civile.

6. Akti i ekspertimit depozitohet në sekretarinë e gjykatës së falimentimit në afatin e caktuar nga gjykata e falimentimit duke u dhënë mundësinë palëve të tërheqin kopje të aktit të ekspertimit para seancës dëgjimore.

Neni 15

Juridiksioni i posaçëm i gjykatës së falimentimit

Gjykata e falimentimit është kompetente edhe për gjykimin e çështjeve të tjera që lidhen me procedurën e falimentimit dhe masën e falimentimit, përfshirë por pa u kufizuar në:

- a) vazhdimin e gjyimit të padive të pezulluara për shkak të hapjes së procedurës së falimentimit;
- b) paditë e administratorit për pavlefshmërinë ose anulimin e veprimeve juridike të debitorit;
- c) paditë për vërtetimin dhe/ose kundërshtimin e pretendimeve të kreditorëve.

Neni 16

Juridiksioni i gjykatës së apelit

1. Vendimet e gjykatës së falimentimit ankimohen në gjykatën e apelit. Afati i ankimit është si rregull, brenda 15 ditëve nga shpallja e vendimit osenga njoftimi i vendimit për palët që nuk kanë qenë të pranishme në shpallje.

2. Afati i ankimit të veçantë sipas këtij ligji, është 5 ditë.

3. Gjykata e Apelit, gjykon çështjen në dhomë këshillimi, si rregull, brenda 30 ditëve nga data e regjistrimit të saj.

4. Gjykata e Apelit, përjashtimisht, mund të vendosë shqyrtimin e çështjes në seancë gjyqësore në prani të palëve, në rast se vlerëson se duhen vërtetuar fakte të reja, marrë prova të reja si dhe për çështjet e juridiksionit të posaçëm të gjykatës së falimentimit.

Neni 17

Kompetenca tokësore

1. Procedura e falimentimit shqyrtohet dhe gjykohet në gjykatën e falimentimit ku debitori ka qendrën e kryesore të interesit.
2. Nëse debitori e ka transferuar qendrën e kryesore të interesit në një vend tjetër, kompetenca tokësore është vetëm e gjykatës së falimentimit ku ndodhet qendra e re ose vendbanimi i ri.
3. Nëse debitori nuk ka qendër kryesore të interesit, seli ose vendbanim në Shqipëri, kompetenca tokësore i përket gjykatës së falimentimit ku debitori ka një degë ose ka çdo pasuri tjetër.
4. Në rast se një procedurë falimentimi është deklaruar në kompetencë tokësore të disa gjykatave të falimentimit, kompetente e drejtpërdrejtë për shqyrtimin dhe gjykimin e çështjes është gjykata ku është paraqitur fillimisht kërkesa për hapjen e procedurës së falimentimit.
5. Në rast se ndaj të njëjtin debitor depozitohen kërkesa të tjera për fillimin e procedurës së falimentimit, këto bashkohen në të njëjtën procedurë me kërkesën e depozituar më parë.

Neni 18

Njoftimet dhe shpalljet

1. Njoftimet për vendimin gjykatës së falimentimit për hapjen e procedurës së falimentimit bëhen nga gjykata e falimentimit me shërbim postar të shpejtë ose mjetet e komunikimit elektronik, sipas dispozitave të Kodit të Procedurës Civile lidhur me njoftimet.
2. Përveç njoftimit sipas pikës 1 të këtij neni, shpalljet e bëra në mjediset publike dhe faqen zyrtare të gjykatës së falimentimit, janë shpallje publike dhe merren si njoftim i të gjithë palëve pjesëmarrësve në procedurën e falimentimit nëçdo rast që gjykata e falimentimit vendos për këtë mënyrë njoftimi.
3. Gjykata e falimentimit ngarkon administratorin të kryejë të gjitha veprimet e nevojshme lidhur me njoftimet dhe shpalljet duke përfshirë edhe njoftimin për shpalljen publike në faqen zyrtare të debitorit nëse ekziston një e tillë.
4. Sekretaria e gjykatës njofton Agjencinë Kombëtare të Falimentimit jo më vonë se pesë ditë nga depozitimi i çdo kërkesë për hapjen e procedurës së falimentimit.
5. Sekretaria e gjykatës dërgon për publikim në Qendrën Kombëtare të Regjistrimit çdo vendim për hapjen, pezullimin, ndërprerjen dhe përfundimin e procedurës së falimentimit.
6. Akti i publikuar duhet të përmbajë të dhënat e debitorit dhe, në mënyrë të veçantë, adresën e vendbanimit të përhershëm ose të vendqëndrimit në të cilin debitori ka qendrën kryesore të interesit, si dhe qendrën ku ushtron veprimtarinë.
7. Gjykata e falimentimit mund të urdhërojë edhe publikime të tjera.

Neni 19
Roli i Agjencisë Kombëtare të Falimentimit

1. Agjencia Kombëtare e Falimentimit mbikëqyr dhe inspekton veprimtarinë e administratorit të falimentimit gjatë procedurës së falimentimit.
2. Agjencia Kombëtare e Falimentimit ka të të drejtë të ndjekë hetimin gjyqësor të çështjeve të falimentimit dhenëse kërkohet nga gjykata e falimentimit, jep opinione dhe dëgjohet vetëm lidhur me përmbushjen e kompetencave dhe detyrave ligjore.
3. Agjencia Kombëtare e Falimentimit kërkon, të paktën, një raportim në çdo 3 muaj nga ana e administratorit të falimentimit, një kopje të të cilit ia dërgon edhe gjykatës së falimentimit.

PJESA E DYTË.

HAPJA E PROCEDURËS SË FALIMENTIMIT, PALËT

PJESËMARRËSE DHE MASA E FALIMENTIMIT

KREU I.

HAPJA E PROCEDURËS SË FALIMENTIMIT

Neni 20

Shkaqet e hapjes së procedurës së falimentimit

1. Procedura e falimentimit mund të hapet ndaj debitorit nëse provohet se ky i fundit është në gjendjen e paaftësisë paguese.
2. Nëse hapja e procedurës së falimentimit kërkohet nga vetë debitori, përbën shkak për hapjen e procedurës së falimentimit edhe paaftësia paguese në një të ardhme të afërt.

Neni 21

Kërkesa për hapjen e procedurës së falimentimit

1. Procedura e falimentimit hapet vetëmme kërkesë me shkrim.
2. Kërkesa mund të paraqitet vetëm nga kreditorët dhe nga debitori.
3. Në rastin e personave juridikë, procedura e falimentimit mund të hapet edhe me kërkesën e organeve tatimore, kur rezulton me paaftësi paguesepër një periudhë 3-vjeçare.
4. Kërkesa e debitorit për hapjen e procedurës së falimentimit nëpërmjet riorganizimit ose rristrukturimit të borxhit konsiderohet kërkesë vullnetare për hapjen e procedurës së falimentimit. Kërkesa vullnetare nuk kërkon nga debitori të provojë shkakun e falimentimit.

Neni 22

Dokumentacioni që shoqëron kërkesën e debitorit

1. Dokumentat e mëposhtëm duhet të paraqiten nga debitori ose në emër të tij, së bashku ose menjëherë me kërkesën e debitorit:
 - a) listën e pasurive dhe të të ardhurave së bashku me një deklaratë, ku të shënohet vlera e çdo sendi dhe fakti nëse ky send është përdorur si mjet sigurimi, ose nëse është ngarkuar me barrë si i tillë;
 - b) listën e kreditorëve me emrat, adresat dhe shumat, që përbëjnë detyrimin përkatës ndajtyre.
 - c) një deklaratë, përmes së cilës vërtetohet se përmbajtja e dokumenteve të mësipërme është e plotë dhe e saktë. Nëse ka arsye për të besuar që përmbajtja e dokumenteve nuk është e plotë ose e saktë, kjo rezervë duhet thënë shprehimisht në tekstin e deklaratës.

2. Në rastin e një shoqërie të thjeshtë, ku asnjë nga ortakët nuk është individ, pika 1 e këtij neni zbatohet për anëtarët e bordit të drejtorëve si dhe anëtarët, ortakët, aksionerët që përfaqësojnë ortakët e shoqërisë së thjeshtë.

Neni 23

Detyrimi për kërkesën e hapjes së procedurës të falimentimit

1. Nëse një subjekt juridik bëhet i paaftë për të paguar, ose është i mbingarkuar në borxhe, atëherë përfaqësuesit e tij ligjorë, duhet të paraqesin një kërkesë për hapjen e procedurës së falimentimit, jo më vonë sesa 21 ditë nga momenti që ka ndodhur kjo gjendje. Në rastin e një shoqërie të thjeshtë, ku asnjë nga ortakët nuk është person fizik, këtë detyrim e kanë përfaqësuesit ligjor të ortakëve, të autorizuar për të prezantuar përfaqësuar shoqërinë dhe likuidatorët. Ky rregull nuk zbatohet nëse ortakët me përgjegjësi personale përfshihen në një person tjetër juridik, që ka një ortakë vetëm i cili është person fizik.

2. Paragrafi i parë zbatohet njëllëj edhe për subjektet tregtare të përcaktuara në fjalinë e dytë të pikës së parë të këtij neni, nëse përfaqësuesit ligjorë të autorizuar për të përfaqësuar shoqërinë, janë vetë subjekte tregtare, nëse asnjë nga ortakët e tyre me përgjegjësi personale nuk është person fizik, ose nëse bashkimi i tyre vazhdon në këtë mënyrë.

Neni 24

E drejta dhe detyrimi i personave juridikë dhe shoqërive të thjeshta

1. Ortakët ose aksionerët e shoqërive nëse kanë dijenipër paaftësinë paguese të shoqërisë, kanë të drejtë të paraqesin kërkesë për hapjen e procedurës së falimentimit brenda 3 muajve, nga dita në të cilën ata kanë dijeni.

2. Në rastin e një personi juridik, çdo anëtar i organit drejtues është i detyruar të kërkojë hapjen e menjëhershme të procedurës së falimentimit, por jo më vonë se 21 ditë nga data kur personi juridik është në gjendje paaftësie paguese. Nëse kreditorët pësojnë humbje për shkak të mosparaqitjes së kërkesës brenda këtij afati 21 ditor, këta janë personalisht përgjegjës për dëmshpërblimin e kreditorëve.

3. Nëse kërkesën nuk e paraqesin bashkërisht të gjithë anëtarët e organit drejtues, të gjithë ortakët e shoqërisë së thjeshtë ose të gjithë likuidatorët, kërkesa pranohet nga gjykata e falimentimit nëse janë të mjaftueshme dhe bindëse shkaqet e parashtruara për hapjen e procedurës së falimentimit. Gjykata e falimentimit, përpara se të marrë vendim, dëgjon anëtarët e tjerë të organit drejtues dhe ortakët e thjeshtë.

Neni 25

Kërkesa e kreditorit

1. Gjykata e falimentimit e pranon kërkesën e kreditorit nëse kreditoriprovon që debitori është në gjendje paaftësie paguese. Paaftësia paguese presumohet nëse kreditori ka dështuar në ekzekutimin e detyrimit në një procedurë të ekzekutimit të detyrueshëm në periudhën e ekzekutimit vullnetar sipas Kodit të Procedurës Civile.

2. Nëse kërkesa e kreditorit pranohet, gjykata e falimentimit thërret dhe dëgjon pretendimet e debitorit.

Neni 26

Shqyrtimi i çështjes dhe dhënia e vendimit për hapjen e procedurës së falimentimit

1. Gjatë shqyrtimit të kërkesës për hapjen e procedurës së falimentimit, gjykata e falimentimit mund të caktojë një ekspert me qëllim që:
 - a) të verifikojë nëse është real shkaku për hapjen e procedurës së falimentimit;
 - b) të verifikojë nëse pasuritë e debitorit mbulojnë shpenzimet e procedurës së falimentimit;
 - c) të verifikojë nëse është e nevojshme të merren masa për sigurimin e pasurisë;
 - d) të verifikojë nëse është mundësia për vazhdimësinë e veprimtarisë nga ana e debitorit.
2. Gjatë shqyrtimit të çështjes, gjykata e falimentimit, sipas nenit Neni 31 të këtij ligji, mund të vendosë masa sigurimi mbi pasurinë e debitorit.
3. Shqyrtimi i çështjes nga gjykata e falimentimit duhet të përfundojë në një kohë sa më të shkurtër dhe, në çdo rast, jo më vonë se 30 ditë nga data e paraqitjes së kërkesës për hapjen e procedurës së falimentimit.
4. Gjkata e falimentimit, brenda afateve të treguara në pikën 3 të këtij neni, mund të vendosë:
 - a) rrëzimin e kërkesës për mungesë të shkakut ligjor për hapjen e procedurës së falimentimit ose,
 - b) pranimin e kërkesës dhe hapjen e procedurës së falimentimit.
5. Kundër vendimit të gjykatës së falimentimit për pranimin e kërkesës për hapjen e procedurës së falimentimit ose për rrëzimin e saj, mund të bëhet ankim i veçantë nga debitori ose kërkuksi për hapjen e procedurës së falimentimit.

Neni 27

Pamjaftueshmëria e masës së falimentimit

Kur konstatohet pamjaftueshmëria e masës së falimentimit për të mbuluar shpenzimet e procedurës së falimentimit, kostot e saj mbulohen nga fondi publik i posaçëm.

Neni 28

Fondi i posaçëm publik

Fondi publik i posaçëm krijohet përmes kontributeve nga buxheti i shtetit; nga detyrimet financiare të debitorëve që likuidohen, si dhe nga burime të tjera të përcaktuara me Vendim të Këshillit të Ministrave. Shuma e detyrimeve financiare për fondin publik të posaçëm, përcaktohet nga Vendim të Këshillit të Ministrave në përqindje të masës së falimentimit.

Neni 29

Detyrimi i dhënies së informacionit dhe i bashkëpunimit gjatë hapjes së procedurës së falimentimit

1. Kur gjykata e falimentimit vendos për hapjen e procedurës së falimentimit, debitori i paraqet kësaj gjykate të gjitha të dhënat e nevojshme, duke përmbushur detyrimet e

parashikuara përkatësisht sipas nenit Neni 21, si dhe në nenet Neni 92, Neni 93, Neni 94 dhe Neni 96 të këtij ligji.

2. Nëse debitori është një person fizik, ai duhet të informohet që mund të shkarkohet nga detyrimet e mbetura sipas parashikimit të neneve Neni 240 deri Neni 255 të këtij ligji.

Neni 30

Urdhri për masa të përkohshme

1. Me miratimin e komitetit të kreditorëve dhe të gjykatës, administratori i falimentimit mund të marrë hua me qëllim që të realizojë përgjegjësitë e veta sipas këtij ligji të cilat përllogariten në zërin e shpenzimeve të administratorit.

2. Pas nxjerrjes së vendimit të fillimit të procedurës së falimentimit, sipas pikës 1 të këtij neni, çdo kreditor mund t'i kërkojë gjykatës së falimentimit që ka dhënë vendimin ta ndryshojë atë, me kusht që kërkesa t'i njoftohet administratorit dhe kërkuesi të mund të tregojë se është cenuar materialisht dhe në mënyrë të padrejtë nga vendimi i dhënë dhe ky cenim kapërcen përfitimet që mund të marrin të gjithë kreditorët e tjerë.

3. Kreditorët e siguruar duhet të njoftohen për këtë kërkesë në mënyrë që atyre tu jepet mundësia të shprehen përpara se gjykata të vendosë lidhur me të.

4. Kur gjykata e falimentimit merr vendimin sipas pikës 1, të këtij neni, duhet të marrë parasysh ndër të tjera:

- a) periudhën gjatë së cilës pritet hapja e procedurës së falimentimit për shoqërinë debitore;
- b) mënyrën si do të drejtohet shoqëria gjatë procedurës së falimentimit;
- c) nëse shoqëria ka mundësi që të ristrukturohet me sukses dhe nëse huaja do të rrisë mundësitë e një ristrukturimi të zbatueshëm për shoqërinë;
- d) nëse vendosja e një garancie për marrjen e huasë është i vetmi mjet realist për ristrukturimin e shoqërisë;
- e) natyrën dhe vlerën e pasurisë dhe
- f) nëse kreditori do të cenohet materialisht, si rezultat i vendimit të kërkuar dhe nëse ky cenimkapërcen përfitimet që mund të marrin të gjithë kreditorët e tjerë.

5. Në vlerësimin e faktorëve të mësipërm, gjykata e falimentimit mund të marrë parasysh, gjithashtu, nëse çdo cenim i pësuar nga kreditori lehtësohet nga masat e sigurisë së dhënë kreditorëve, duke përfshirë:

- a) pagesat në të holla nga pasuria;
- b) dhënien e sigurisë shtesë dhe
- c) masa të tjera, siç mund të vendosin palët dhe gjykata.

6. Kur procedura e riorganizimit konvertohet në likuidim, çdo përparësi e dhënë sipas paragrafit 4 në riorganizim duhet të vazhdojë të njihet në likuidim.

Neni 31

Vendosja e masave të sigurisë

1. Derisa gjykata e falimentimit të marrë vendim për kërkesën për hapjen e procedurës së falimentimit, ajo vendos mbi pasuritë e debitorit çdo lloj mase që e gjykon të nevojshme për të shmangur përkeqësimin e gjendjes financiare të debitorit në dëm të kreditorëve.

2. Në mënyrë të veçantë, gjykata e falimentimit mund:

- a) të vendosë ndaj debitorit kufizim të përgjithshëm disponimi ose pranimi të shlyerjes së detyrimeve ose të urdhërojë që çdo disponim i pasurisë së tij të kryhet vetëm me miratimin përfundimtar të administratorit të përkohshëm;
 - b) të vendosë ndaj debitorit pezullim të përkohshëm të masave të sigurisë dhe të ekzekutimit të një të drejte të siguruar;
 - c) të emërojë një administrator të përkohshëm falimentimi.
3. Masat e sigurisë mbi pasurinë e debitorit, sipas këtij neni, mund të vendosen nga gjykata e falimentimit për një afat prej 30ditë edhe në rastin e procedurave të ekzekutimit të një detyrimi mbi këtë pasuri nga kreditori i siguruar. Ky afatmund të zgjatet edhe për një afat tjetër prej 30 ditë, por vetëm në rast se:
- a) gjykata e falimentimit çmon se vlera e barrës siguroese është më e madhe se vlera e kredisë së siguruar dhe e shpenzimeve të ekzekutimit të këtij detyrimi të marra së bashku;
 - b) debitori, përpara përfundimit të afatit prej 30 ditë, paraqet para gjykatës së falimentimit prova të mjaftueshme për mundësinë e zbatimit të një plani riorganizimi për realizimin e të cilit është thelbësor përdorimi i barrës siguroese.
4. Gjkata e falimentimit vendos masat e sigurisë, të parashikuara në pikën 3 të këtij neni, jo më vonë se 15 ditë nga data e paraqitjes së kërkesës për hapjen e procedurës së falimentimit, pasi të ketë dëgjuar më parë kreditorët e siguruar. Pas kalimit të afatit të parashikuar në pikën 3 të këtij neni, masa e sigurisë mbi pasurinë e debitorit shuhet.
5. Kundër vendimit të gjykatës së falimentimit për vendosjen e masës së sigurimit mund të bëhet ankim i veçantë.

Neni 32

Administratori i përkohshëm i falimentimit

1. Në rast se gjykata e falimentimit cakton një administrator të përkohshëm falimentimi dhe i heq debitorit të drejtën e disponimit të pasurisë, e drejta e administrimit dhe e disponimit të pasurisë së debitorit i kalon administratorit të përkohshëm të falimentimit. Në këtë rast administratori i përkohshëm i falimentimit:
- a) kujdeset për sigurimin dhe ruajtjen e pasurisë së debitorit;
 - b) vazhdon drejtimin e përditshëm të veprimtarisë së debitorit derisa gjykata e falimentimit të vendosë për hapjen e procedurës së falimentimit, me përjashtim të rastit kur gjykata e falimentimit miraton mbylljen e veprimtarisë për të shmangur humbje të mëtejshme të ndjeshme të pasurisë së debitorit;
 - c) kryen, si ekspert, detyrat e caktuara në pikën 1 të nenit Neni 26 të këtij ligji.
2. Nëse gjykata e falimentimit cakton një administrator të përkohshëm falimentimi pa i hequr debitorit të drejtën e përgjithshme të disponimit, gjykata i përcakton administratorit të përkohshëm, edhe detyra të tilla si mbikëqyrjen e veprimeve të debitorit si dhe i kërkon të vërë në dijeni gjykatën nëse janë të nevojshme masa të mëtejshme.
3. Në rastet e parashikuara në pikat 1 dhe 2 të këtij neni, administratori i përkohshëm i falimentimit ka të drejtën të hyjë në mjediset ku ushtron veprimtarinë debitori dhe të hetojë. Debitori e lejon administratorin e përkohshëm të bëjëinspektimin e librave të llogarive dhe të dokumenteve të veprimtarisë si dhe i jeptë gjitha të dhënat e nevojshme.
4. Administratori i përkohshëm i falimentimit ka të drejtë t’u japë furnizuesve, si kreditorë të masës së falimentimit, përparësi në pagesë me mallra, shërbime ose kredi të nevojshme.

5. Për kryerjen e veprimeve sipas pikës 4 të këtij neni, administratori kërkon miratimin e gjykatës së falimentimit. Gjykata e falimentimit, e jep miratimin nëse përmbushen kriteret e mëposhtme:

- a) veprimi është i vlefshëm për vazhdimin e funksionimit të një veprimtarie;
- b) furnizimi me mallra, shërbime ose kredi është i pashmangshëm;
- c) provohet se një vendim i tillë është në interesin më të lartë të pjesëmarrësve.

6. Në raste të ngutshme, kur miratimi i veprimit nga gjykata e falimentimit mund të vononte kryerjen e veprimit, administratori mund ta kryejë veprimin e sipërpërmendur edhe pa miratimin e saj, me kusht që të përmbushen kriteret e pikës 5 germa 'b' e këtij neni.

7. Administratori i përkohshëm është përgjegjës për dëmet në të njëjtën shkallë si administratori i falimentimit, sipas përcaktimeve të bëra në nenin Neni 59 të këtij ligji.

Neni 33

Shpallja publikisht e kufizimit të disponimit të pasurive

1. Vendimi për çdo lloj kufizimi të disponimit të pasurisë, të parashikuar në pikën 2 të nenit Neni 31 të këtij ligji, si dhe për caktimin e një administratori të përkohshëm falimentimi, duhet të shpallet publikisht. Vendimi i njoftohet drejtpërdrejtë debitorit, çdo personi që ka pretendime ndaj debitorit dhe administratorit të përkohshëm të falimentimit. Njëkohësisht, debitorëve të debitorit u kërkohet të përmbushin detyrimet ndaj debitorit, sipas këtij vendimi.

2. Vendimi për çdo lloj kufizimi të disponimit të pasurisë u dërgohet, për të bërë shënimet përkatëse, të gjithë autoriteteve publike, të ngarkuara nga ligji, për regjistrimin e veprimtarisë së debitorit ose të një pjese a tërësisë së pasurive të tij.

Neni 34

Pasojat që rrjedhin nga kufizimi i disponimit të pasurisë

1. Janë të pavlefshme veprimet juridike të debitorit, në kundërshtim me kufizimet e disponimit të pasurisë, të parashikuara në nenin Neni 31 të këtij ligji. Vlera e paguar i kthehet palës tjetër, në rast se pasuritë e marra vazhdojnë të përbëjnë begatim pa shkak të debitorit.

2. Nëse në kundërshtim me kufizimin e disponimit, vlerën e përfiton debitori në vend të administratorit të përkohshëm të falimentimit, pagesi shkarkohet nga detyrimi vetëm në rast se vërtetohet që, në kohën e pagimit të vlerës, nuk kishte dijeni për kufizimet e disponimit të debitorit.

Neni 35

Shfuqizimi i masave të sigurisë

1. Për shfuqizimin e masave të sigurisë, njoftimi dhe shpallja publike bëhen në të njëjtën mënyrë si në rastin e vendosjes së tyre.

2. Kur e drejta për disponimin e pasurisë së debitorit i ka kaluar administratorit të përkohshëm të falimentimit, ky i fundit, para mbarimit të mandatit të tij, ka për detyrë të shlyejë këto shpenzime të cilat duhet të trajtohen si shpenzime të administrimit dhe detyrimet e lindura gjatë periudhës së administrimit të pasurisë prej tij.

3. Pika 2 e këtij neni zbatohet edhe për detyrimet e lindura nga kontratat nëse, në bazë të tyre, administratori i përkohshëm i falimentimit ka marrë një vlerë në favor të pasurisë së administruar prej tij.

Neni 36

Shpërblimi i administratorit të përkohshëm të falimentimit

1. Nëse procedura e falimentimit nuk hapet, gjykata e falimentimit duhet të përcaktojë një shpërblim për administratorin e përkohshëm të falimentimit duke detyruar debitorin të rimbursojë shpenzimet. Vendimi i komunikohet administratorit të përkohshëm të falimentimit dhe debitorit.
2. Administratori i përkohshëm i falimentimit dhe debitori kanë të drejtën e ankimit të veçantë.
3. Paga e administratorit të përkohshëm përcaktohet me Vendim të Këshillit të Ministrave.

Neni 37

Vendimi për hapjen e procedurave të falimentimit

1. Gjykata e falimentimit vendos hapjen e procedurës së falimentimit kur çmon se janë shkaqet dhe kushtet e parashikuara në këtë ligj për hapjen e procedurës së falimentimit.
2. Vendimi për hapjen e procedurës së falimentimit përmban :
 - a) emrin, mbiemrin dhe vendbanimin e debitorit në rastin e personave, ose emrin, llojin e veprimtarisë dhe selinë në rastin e personit juridik;
 - b) emrin, mbiemrin dhe adresën e administratorit të falimentimit;
 - c) orën e saktë kur është hapur procedura e falimentimit;
 - d) të dhënat e parashikuara në nenet Neni 38 dhe Neni 40 të këtij ligji.
 - e) urdhërimin e detyrimit për publikimin e vendimit në internet, në faqen zyrtare të gjykatës, të Qendrës Kombëtare të Regjistrimit dhe të organit tatimor përkatës.
3. Nëse vendimi nuk përcakton orën e saktë të hapjes së procedurës së falimentimit, atëherë si orë e saktë e hapjes së kësaj procedure merret ora dymbëdhjetë e ditës së shpalljes së vendimit.
4. Së bashku me hapjen e procedurës së falimentimit, gjykata e falimentimit vendos emërimin e administratorit të falimentimit nëse nuk është kërkuar vazhdimi i administrimit nga vetë debitori.
5. Rregullat e parashikuara në këtë nen nuk përjashtojnë zbatimin e detyrimeve të parashikuara në nenet Neni 226 dhe Neni 265 të këtij ligji.

Neni 38

Kërkesat ndaj kreditorëve dhe debitorëve

1. Në vendimin e hapjes së procedurës së falimentimit kreditorëve u kërkohet të paraqesin, brenda një afati të përcaktuar në të, tek administratori i falimentimit, pretendimet e tyre sipas nenit Neni 136 të këtij ligji. Afati kohor për paraqitjen e pretendimeve nuk mund të jetë më pak se 15 ditë dhe jo më shumë se 90 ditë. Në caktimin e këtij afati, gjykata e falimentimit, merr në konsideratë nëse ndër kreditorët ka nga ata që kanë qendrën kryesore të interesit jashtë shtetit.

2. Në vendimin e hapjes së procedurës së falimentimit, kreditorëve u kërkohet të njoftojnë, sa më shpejt të jetë e mundur, administratorin e falimentimit për pretendimet dhe të drejtat e siguruara që kanë mbi pasuritë e debitorit. Njoftimi i pretendimeve duhet të përmbajë të dhëna të hollësishme për sendin mbi të cilin pretendohet e drejta e siguruar, natyrën dhe shkakun e lindjes së të drejtës së siguruar dhe për pretendimet e siguruara. Kreditorët që për faj të tyre nuk japin të dhënat e kërkuara ose i japin ato me vonesë, janë përgjegjës për pasojat që vijnë nga dëmet e shkaktuara.

3. Në vendimin e hapjes së procedurës së falimentimit përcaktohet se personat që kanë detyrime ndaj debitorit ia paguajnë dhe ia shlyejnë ato administratorit të falimentimit.

Neni 39

Caktimi i mbledhjeve

1. Në vendimin e hapjes së procedurës së falimentimit, gjykata e falimentimit cakton afatet kohore për:

- a) zhvillimin e mbledhjes së kreditorëve për raportim. Kjo mbledhje, mbahet brenda 45 ditësh dhe, në çdo rast, jo më vonë se 90 ditë nga data e shpalljes së vendimit, dhe në bazë të një raporti të administratorit të falimentimit vendos për vazhdimin e mëtejshëm të procedurës së falimentimit;
- b) zhvillimin e mbledhjes së kreditorëve për verifikim. Kjo mbledhje, e cila shqyrton dhe bën verifikimin e pretendimeve të depozituara, mbahet jo më parë se 10 ditë dhe jo më vonë se 60 ditë nga përfundimi i afatit për depozitim të pretendimeve,

2. Nëse administratori i falimentimit e sheh të arsyeshme, mbledhja për raportim dhe për verifikim mund të bëhet në të njëjtën kohë.

Neni 40

Shpallja publikisht e vendimit të hapjes së procedurës së falimentimit

1. Gjkata e falimentimit shpall publikisht dhe pa vonesë vendimin e hapjes së procedurës së falimentimit, në përputhje me nenin Neni 18 të këtij ligji.

2. Kopje e shkurtuar e këtij vendimi u dërgohet secilit prej kreditorëve, debitorit, debitorëve të debitorit dhe prokurorit.

3. Kur debitori është person fizik, me vendimin e hapjes së procedurës së falimentimit atij i jepet e drejta dhe mundësia për t'u shkarkuar nga detyrimi i mbetur, në përputhje me parashikimet e këtij ligji.

Neni 41

Regjistri tregtar

Nëse debitori është i regjistruar në regjistrin tregtar, gjykata e falimentimit i dërgon organit ku është kryer regjistrimi një kopje të vendimit të hapjes së procedurës, nëse procedura e falimentimit është hapur.

Neni 42

Regjistri i Pasurive të Paluajtshme

1. Vendimi për hapjen e procedurës së falimentimit regjistrohet në Regjistrin e Pasurive të Paluajtshme, duke bërë shënimet përkatëse:
 - a) mbi çdo pasuri të paluajtshme, ku debitori është regjistruar si pronar;
 - b) mbi të gjitha të drejtat e tjera të regjistruara të debitorit mbi pasuri të paluajtshme ose të drejta të tjera të regjistruara nëse këto të drejta, për nga lloji dhe rrethanat, nëse nuk do të shënoheshin, mund të çonin në dyshime se kreditori i përfshirë në procedurën e falimentimit do të vendosej në disavantazh.
2. Nëse gjykata e falimentimit vihet në dijeni për pasuri të paluajtshme, ku debitori është pronar ose gëzon të drejta të tjera të regjistrueshme, gjykata urdhëron administratorin të kërkojë këtë regjistrim në Regjistrin e Pasurive të Paluajtshme.
3. Procedurat e parashikuara në këtë nen zbatohen, sipas rastit, edhe për regjistrimin e vendimit të hapjes së procedurës së falimentimit dhe vendosjen e shënimeve përkatëse në regjistrat e tjerë, të mbajtur, sipas ligjit, nga autoritete të tjera publike, të ngarkuara me regjistrimin e pronësisë ose të të drejtave të tjera të debitorit mbi sende që bëjnë pjesë në masën e falimentimit.

Neni 43

Verifikimi nga Prokurori

1. Me marrjen e një kopjeje të vendimit për hapjen e procedurës së falimentimit, prokurori, me qëllim shmangien e abuzimit ose mashtrimit me procedurat e falimentimit, i kërkon administratorit të falimentimit që të verifikojë transfertat dhe veprimet juridike që lidhen me pasuritë e debitorit dhe të personave të lidhur me të, të kryera, të paktën tri vitet e fundit përpara aplikimit për hapjen e procedurës së falimentimit.
2. Në kuptim të këtij neni ruhet statusi si person i lidhur me debitorin deri në një periudhë tre vjeçare pas mbarimit të lidhjes përkatëse sipas përcaktimeve të nenit Neni 3 pika 22 të këtij ligji.
3. Subjektet bankare, subjektet e tjera që licencohen ose mbikëqyren nga Banka e Shqipërisë, duke përfshirë, por pa u kufizuar, në subjektet financiare jobanka, zyrat e këmbimeve valutore, shoqëritë e kursim-kreditit, shërbimet postare që kryejnë shërbime pagesash, Zyra e Regjistrimit të Pasurive të Paluajtshme, Qendra Kombëtare e Regjistrimit të Tregtarëve, janë të detyruar t'i dorëzojnë administratorit të falimentimit të dhënat dhe dokumentet përkatëse për veprimet juridike të parashikuara në pikën 1 të këtij neni.

Neni 44

Pasojat e ndërprerjes së procedurës së falimentimit për shkak të prishjes së vendimit për hapjen e procedurës së falimentimit

1. Vendimi i gjykatës më të lartë që, në bazë të ankimit të veçantë, ka vendosur prishjen e vendimit të gjykatës së falimentimit për hapjen e procedurës së falimentimit dhe pushimin e çështjes, shpallet publikisht.
2. Përfundimi i procedurës së falimentimit, sipas pikës 1 të këtij neni, nuk cenon pasojat juridike të veprimeve të kryera nga administratori i falimentimit ose palët e treta.

Neni 45

Kundërshtimi

Kundër vendimit të gjykatës për pranimin e kërkesës ose rrëzimin e kërkesës për hapjen e procedurës së falimentimit mund të bëhet ankim nga kërkuuesi ose nga debitori në gjykatën e apelit. Nëse gjykata e apelit vendos ndryshimin e vendimit të gjykatës së falimentimit që ka vendosur hapjen e procedurës së falimentimit duke rrëzuar kërkesën për hapjen e procedurës së falimentimit, përfundimi i procedurave të falimentimit bëhet publik. Efektet e veprimeve të ndërmarra nga ose kundër administratorit të falimentimit do të mbeten të paprekur nga një përfundim i tillë.

KREU II.

KLASIFIKIMI I KREDITORËVEDHE TË DREJTAT E TYRE

Neni 46

E drejta e veçimit

1. Çdo person ka të drejtë të pretendojë veçimin e një sendi nga masa e falimentimit në bazë të një të drejte pronësie. E drejta e veçimit të këtij sendi rregullohet sipas dispozitave të parashikuara jashtë procedurës së falimentimit.
2. Nëse para hapjes së procedurës së falimentimit, debitori e ka shitur sendin për të cilin pretendohet veçimi, pa marrë parasysh të drejtën e parashikuar në pikën 1 të këtij neni, ose nëse sendin e ka shitur administratori i falimentimit pas hapjes së procedurës së falimentimit, çdo person, që ka të drejtën e veçimit, mund të kërkojë njohjen e së drejtës mbi vlerën e sendit për sa kohë që nuk është paguar vlera e tij. Pagimi i vlerës nga masa e falimentimit mund të kërkohet për aq kohë sa kjo vlerë vazhdon, në formë të dallueshme në masën e falimentimit.

Neni 47

Kreditorët e siguruar

Kreditorët, që nëpërmjet një veprimi juridik, kanë vendosur mjete sigurimi mbi sendin ose në bazë të ligjit kanë fituar një të drejtë mbi sende të masës së falimentimit, si mjet sigurimi për pretendimet e tyre, kanë të drejtë të realizojnë shlyerjen e detyrimit nga kolaterali, në përputhje me dispozitat e zbatueshme jashtë procedurës së falimentimit. Në këtë rast zbatohen përjashtimet e neneve Neni 131 deri Neni 135 të këtij ligji.

Neni 48

Shpenzime të procedurës së falimentimit

Quhen shpenzime të procedurës së falimentimit:

- a) shpenzimet gjyqësore;

- b) paga e administratorit të përkohshëm të falimentimit dhe e administratorit të falimentimit përfshirë edhe periudhën kur ushtron funksionin si administrator mbikëqyrës;
- c) shpenzimet e komitetit të kreditorëve.

Neni 49

Shpenzimet e tjera administrative

Vlerësohen si shpenzime të tjera administrative, shpenzimet e mëposhtme:

- a) detyrimet që lindin si pasojë e veprimtarisë së administratorit të falimentimit ose në çdo mënyrë tjetër gjatë administrimit, disponimit dhe shpërndarjes së masës së falimentimit, por që nuk janë pjesë e shpenzimeve të procedurës së falimentimit;
- b) detyrimet sipas kontratave të dyanshme, që pretendohet se duhet të paguhen në favor të masës së falimentimit ose që duhet të paguhen pas hapjes së procedurës së falimentimit;
- c) detyrimet për kthimin e shumave në të holla në rastin e begatimit pa shkak të masës së falimentimit;
- d) detyrimet që lindin si pasojë e veprimtarisë së administratorit të përkohshëm të falimentimit nëse ai, me miratimin e gjykatës së falimentimit, u ka dhënë përparësi në pagesë.
- e) shpenzimet mbi pasuritë e përfshira në procedurat e falimentimit parashikuar në nenin Neni 275 të këtij ligji.

Neni 50

Shlyerja e kreditorëve të masës së falimentimit

1. Kreditorët që kanë të drejta që lidhen me detyrimet e parashikuara nga nenet Neni 48 dhe Neni 49 të këtij ligji, janë kreditorë të masës së falimentimit dhe paguhen nga masa e falimentimit përpara kreditorëve të falimentimit, sipas radhës së përcaktuar në këto dispozita.
2. Shpenzimet e procedurës së falimentimit dhe shpenzimet e tjera administrative të parashikuara në nenet Neni 48, Neni 49 dhe Neni 61 të këtij ligji, me përjashtim të shpërblimit që përlllogaritet në bazë të përqindjes mbi sasinë e detyrimeve të përmbushura nga masa e falimentimit, shlyhen nga masa e falimentimit përpara shpërndarjes së saj.
3. Kreditorët e masës së falimentimit, pretendimet e tyre ndaj administratorit të falimentimit, i ngrenë dhe i përmbushin sipas dispozitave të zbatueshme jashtë procedurës së falimentimit.

Neni 51

Kreditorët e falimentimit

1. Pretendimet e kreditorëve të falimentimit llogariten sipas kritereve të parashikuara në nenin Neni 52 të këtij ligji.
2. Kreditorët e falimentimit mund të ekzekutojnë pretendimet e tyre, sipas dispozitave të procedurës së falimentimit. Ata duhet të paraqesin pretendimet e tyre për verifikim, sipas

neneve Neni 136 deri Neni 144 të këtij ligji, si dhe marrin pjesë në shpërndarje, sipas neneve Neni 145 deri Neni 164 të këtij ligji.

Neni 52

Llogaritja e pretendimeve

1. Pretendimet e kreditorit për detyrime të pa-maturuara, për efekt të procedurës së falimentimit, quhen si të maturuara.
2. Pretendimet që i nënshtrohen një kushti zgjidhës, përderisa kushti nuk është vërtetuar, nuk quhen si pretendime me kusht zgjidhës për efekt të procedurës së falimentimit.
3. Në procedurën e falimentimit, kreditori që ka pretendime ndaj disa personave me përgjegjësi solidare, mund të paraqesë një pretendim në shumën e plotë kundër secilit prej debitorëve derisa të realizojë plotësisht pretendimin në të njëjtën mënyrë sikur të kishte pretendim për shumën e plotë në datën e hapjes së procedurës së falimentimit.
4. Pretendimi që nuk shprehet në monedhë paraqitet në një shumë, e cila vlerësohet duke u referuar në datën e hapjes së procedurës së falimentimit. Pretendimet e shprehura në monedhë të huaj ose në njësi matëse shprehen të kthyer në lekë, sipas kursit zyrtar të këmbimit të zbatueshëm në vendin e pagesës, në kohën e hapjes së procedurës së falimentimit.
5. Pretendimet për pagesa që përsëriten me shuma të caktuara dhe për periudha të caktuara paraqiten në shumën që shpreh tërësinë e të gjitha pagesave të mbetura, të cilat zbriten në mënyrën e përmendur në pikën 1 të këtij neni. Ky rregull zbatohet edhe në rastin kur periudha e këtyre pagesave është e pacaktuar.

Neni 53

Kreditorët e siguruar në rolin e kreditorëve të falimentimit

Kreditorët e siguruar quhen kreditorë falimentimi dhe gëzojnë të drejtë ripagimi të veçantë e cila mund të jetë e pjesshme në zbatim të kushteve të nenit Neni 145, vetëm në masën që nuk janë shlyer sipas të drejtës së ripagimit të veçantë ose kanë hequr dorë nga e drejta e ripagimit të veçantë.

Neni 54

Kreditorët e falimentimit të rangjeve më të ulëta të preferimit

1. Pretendimet e përmendura më poshtë shlyhen pas pretendimeve të kreditorëve të falimentimit dhe në përputhje me sasinë e shumave, nëse kanë status të njëjtë:
 - a) interesat e fituara mbi shumat e pretendimeve sidhe penaltetet e vonesave të kreditorëve të falimentimit që nga koha e hapjes së procedurës së falimentimit;
 - b) gjoba ose pagesa që në bazë të dispozitave të Kodit Civil, legjislacionit administrativ dhe Kodit Penal përbëjnë detyrime të debitorit;
 - c) pretendime për kontribute pa shpërblim ndaj debitorit;
2. Kërkesat për ripagim të një kredie nga një aksioner, ose kërkesa të krijuara nga kontrata të tjera me vlerë ekonomike ekuivalente.
3. Pretendimet mbi të cilat kreditori dhe debitori kanë rënë dakord të radhiten në radhët më të ulëta të preferimit përmbushen pas pretendimeve të përmendura në pikën 1 të këtij neni, me kusht që në marrëveshjen ndërmjet tyre të mos jetë parashikuar ndryshe.

4. Interesat që fitohen në procedurën e falimentimit, mbi shumën e pretendimeve të kreditorëve të rangjeve më të ulëta të preferimit, radhiten me të njëjtin status si pretendimet e këtyre kreditorëve.

KREU III.

ADMINISTRATORI I FALIMENTIMIT.

ORGANET E PËRFAQËSIMIT TË KREDITORËVE

Neni 55

Caktimi i administratorit të falimentimit

1. Gjykata e falimentimit cakton si administrator falimentimi një person fizik të licencuar si administrator falimentimi, të pavarur nga kreditorët dhe debitorët.
2. Administratori i falimentimit emërohet me vendimin për hapjen e procedurës së falimentimit.
3. Personat e mëposhtëm nuk mund të caktohen si administratorë falimentimi, për shkak të konfliktit të interesit, sipas këtij ligji:
 - a) personat të cilët kanë lidhje familjare ose biznesi me debitorin ose nëpunësit, drejtorët, punonjësit, aksionarët ose kreditorët e debitorit;
 - b) personat, të cilët kanë lidhje familjare ose biznesi me gjyqtarin e falimentimit;
 - c) personat të cilët janë nëpunës, drejtorë, punonjës, aksionarë të konkurrentëve të drejtpërdrejtë të biznesit të debitorit;
 - d) personat të cilët kanë falimentuar në kohën e emërimit;
 - e) personat të cilët, në përputhje me ligjet e tjera të Republikës së Shqipërisë, nuk mund të emërohen si drejtorë të një shoqërie tregtare;
 - f) personat të cilët i kanë dhënë më parë këshilla profesionale debitorit.
4. Administratori i falimentimit, para pajisjes me licencë, depoziton në formën e garancisë një shumë monetare. Shuma e depozitës caktohet nga Agjencia Kombëtare e Falimentimit.

Neni 56

Mbikëqyrja nga gjykata e falimentimit

1. Gjykata e falimentimit dhe AKF mbikëqyrin veprimtarinë e administratorit të falimentimit. Gjykata e falimentimit mund t'i kërkojë administratorit, në çdo kohë, të dhëna të veçanta ose raportime për ecurinë e procedurës së falimentimit dhe administrimin e masës së falimentimit.
2. Gjykata e falimentimit njofton AKF për mospërmbushjen e detyrave nga ana e administratorit të falimentimit si dhe për rastet e dënimit administrativ të tij.

Neni 57

Shkarkimi i administratorit të falimentimit

1. Gjykata e falimentimit mund të shkarkojë nga detyra administratorin e falimentimit për shkaqe të rëndësishme. Shkarkimi mund të bëhet kryesisht nga gjykata e falimentimit, ose me

kërkesën e komitetit të kreditorëve ose të mbledhjes së kreditorëve. Përpara marrjes së vendimit, gjykata e falimentimit dëgjon shpjegimet e administratorit të falimentimit.

2. Administratori i falimentimit mund të dorëhiqet nga detyra vetëm për shkaqe që e bëjnë të pamundur vazhdimin e kryerjes së detyrës. Kërkesa e dorëheqjes vlerësohet nga gjykata e falimentimit pasi të jetë konsultuar edhe me komitetin e kreditorëve.

3. Kundër vendimit të gjykatës së falimentimit për shkarkimin e tij, administratori i falimentimit ka të drejtën e ankimit të veçantë.

4. Kundër vendimit të gjykatës së falimentimit për rrëzimin e kërkesës për shkarkimin e administratorit, kanë të drejtën e ankimit të veçantë komiteti i kreditorëve ose, çdo kreditor falimentimi, kur propozimin për shkarkimin e tij e ka bërë mbledhja e kreditorëve.

Neni 58

Zëvendësimi i administratorit të falimentimit

1. Në rast se, për shkaqe të shkarkimit, dorëheqjes ose shkaqe të tjera administratori i falimentimit është në pamundësi të vazhdojë ushtrimin e detyrës, ai zëvendësohet nga gjykata e falimentimit, pasi të jetë konsultuar më parë me komitetin e kreditorëve, ose nga gjykata nëse ky komitet nuk ekziston.

2. Administratori i dorëhequr ose i shkarkuar qëndron në detyrë deri në momentin e dorëzimit të detyrës tek administratori zëvendësues.

Neni 59

Përgjegjësitë e administratorit të falimentimit

1. Administratori i falimentimit është përgjegjës për dëmet që u shkaktohen palëve pjesëmarrëse në procedurën e falimentimit në rast se ai, shkel ose nuk përmbush detyrat që i ngarkohen nga ky ligj. Administratori i falimentimit ka për detyrë që, në ushtrimin e veprimtarisë, të tregojë kujdes dhe të veprojë si një administrator i ndërgjegjshëm dhe i zellshëm.

2. Nëse për përmbushjen e detyrave, administratorit i duhet të angazhojë punonjësit e mëparshëm të debitorit, brenda pozicionit dhe rolit të punës që kanë kryer më parë dhe, nëse këta punonjës vlerësohen të përshtatshëm, administratori i falimentimit nuk mban përgjegjësi për pakujdesinë e këtyre personave në ushtrimin e detyrës, por përgjigjet vetëm për mbikëqyrjen e tyre si dhe për vendime të një rëndësie të veçantë të marrë prej tyre.

Neni 60

Parashkrimi

1. Padia për shpërblimin e dëmit të shkaktuar nga shkelje ose mospërmbushje të detyrimeve të administratorit të falimentimit parashkruhet pas tre vjetësh nga data kur pala e dëmtuar ka marrë dijeni për dëmin dhe për rrethanat që tregojnë përgjegjësinë e administratorit për dëmin e shkaktuar.

2. Padia sipas pikës 1 të këtij neni nuk mund të ngrihet pas tre vjetëve nga data e përfundimit të procedurës së falimentimit.

Neni 61

Paga dhe shpërblimi i administratorit të falimentimit

1. Administratori i falimentimit ka të drejtën:
 - a) e pagës mujore,
 - b) të shpërblimit si përqindje mbi sasinë e detyrimeve të shlyera nga masa e falimentimit, si edhe
 - c) të rimbursimit për shpenzimet e bëra gjatë përmbushjes së detyrës.
2. Niveli i pagës mujore vlerësohet në varësi të vëllimit dhe të shkallës së vështirësisë gjatë ushtrimit të detyrës së administratorit të falimentimit.
3. Masa e shpërblimit llogaritet në kohën e përfundimit të procedurës së falimentimit.
4. Rregullat e hollësishme lidhur me pagën, kushtet dhe kriteret e përcaktimit të masës së shpërblimit dhe të rimbursimit të shpenzimeve të administratorit të falimentimit, caktohen me Vendim të Këshillit të Ministrave.
5. Çdo administrator falimentimi që ka të paktën tri raste falimentimi ka detyrim të realizojë të paktën një procedurë falimentimi falas brenda tri vjetëve.

Neni 62

Vendimet e gjykatës së falimentimit

1. Paga, shpërblimi dhe shpenzimet që i rimbursohen administratorit të falimentimit miratohen nga gjykata e falimentimit në bazë të kërkesës së administratorit.
2. Vendimi i gjykatës së falimentimit, me përjashtim të shumave së parashikuara në pikën 1 të këtij neni, shpallet publikisht dhe i njoftohet personalisht administratorit të falimentimit, debitorit dhe anëtarëve të komitetit të kreditorëve. Në vendimin e shpallur publikisht, duhet të vihet në dukje se teksti i plotë i këtij vendimi gjendet në sekretarinë e gjykatës së falimentimit.
3. Kundër vendimit të gjykatës së falimentimit, administratori i falimentimit, debitori dhe çdo kreditor falimentimi kanë të drejtën e ankimit të veçantë sipas këtij ligji.

Neni 63

Paraqitja e llogarive

1. Në përfundim të detyrës, administratori i falimentimit ka detyrim të paraqesë llogaritë në mbledhjen e kreditorëve.
2. Përpara zhvillimit të mbledhjes së kreditorëve, gjykata e falimentimit verifikon llogaritë përfundimtare të përgatitura nga administratori i falimentimit së bashku me dokumentacionin mbështetës shoqëruar me një koment-vërejtje që tregon verifikimin e llogarive dhe me çdo koment të komitetit të kreditorëve nëse është caktuar një i tillë. Gjkata e falimentimit mund të caktojë një afat për bërjen e deklaratës nga komiteti i kreditorëve.
3. Në rastet kur është caktuar një komitet kreditorësh, llogarive përfundimtare të përgatitura nga administratori i falimentimit i bashkëlidhen edhe komentet e këtij komiteti, për përgatitjen e të cilave gjykata e falimentimit cakton një afat kohor.
4. Periudha ndërmjet paraqitjes së dokumentacionit, sipas këtij neni dhe datës së mbajtjes së mbledhjes së kreditorëve duhet të jetë të paktën shtatë ditë.

5. Mbledhja e kreditorëve mund t'i ngarkojë administratorit të falimentimit të paraqesë llogari ndërmjetëse, në data të caktuara, gjatë zbatimit të procedurës së falimentimit, duke zbatuar, njëlloj, rregullat e parashikuara në këtë nen.

Neni 64

Caktimi i komitetit të kreditorëve

1. Para mbledhjes së parë të kreditorëve, gjykata e falimentimit ka të drejtë të caktojë një komitet të kreditorëve të përkohshëm.
2. Gjkata e falimentimit, kryesisht ose me kërkesë të çdo personi të interesuar dhe nëçdokohë, mund të zëvendësojë anëtarët e komitetit të kreditorëve.
3. Komiteti i kreditorëve përfaqëson kreditorët e procedurës së falimentimit me pretendimet më të mëdha dhe kreditorët e shumave të vogla.
4. Nëse debitori ka një numër minimal prej 20 punonjësish, në komitetin e kreditorëve duhet të marrë pjesë të paktën një përfaqësues i punonjësve.
5. Nëse debitori ushtron veprimtari në sektorin e interesit publik të tillë që kontrollohet prej një autoritet rregullator, anëtarë të komitetit të kreditorëve mund të emërohen edhe persona që nuk janë kreditorë por përfaqësues të këtij autoriteti.

Neni 65

Zgjedhja e anëtarëve të komitetit të kreditorëve

1. Mbledhja e kreditorëve vendos nëse duhet të caktohet një komitet i kreditorëve. Në rast se komiteti i kreditorëve të përkohshëm është caktuar nga gjykata e falimentimit përpara zhvillimit të mbledhjes së kreditorëve, kjo e fundit mund të vendosë nëse ky komitet do të vijojë ose do të shpërndahet.
2. Mbledhja e kreditorëve ka të drejtë të vendosë për heqjen e anëtarëve që ka caktuar gjykata e falimentimit ose për emërimin e anëtarëve të tjerë në komitetin e kreditorëve. Numri i anëtarëve të komitetit të kreditorëve nuk mund të jetë më i madhe se pesë.

Neni 66

Detyrat e komitetit të kreditorëve

1. Anëtarët e komitetit të kreditorëve mbështesin dhe mbikëqyrin veprimtarinë e administratorit të falimentimit.
2. Anëtarët e komitetit të kreditorëve kanë të drejtë të kërkojnë dhe të marrin të dhëna për ecurinë e punëve gjatë procesit të falimentimit, të kontrollojnë librat e llogarive dhe dokumentet e tjera, si dhe të verifikojnë veprimet monetare dhe gjendjen e arkës.

Neni 67

Shkarkimi i anëtarëve të komitetit të kreditorëve

1. Gjkata e falimentimit, kryesisht, ka të drejtë të shkarkojë nga detyra një anëtar të komitetit të kreditorëve për një shkak të rëndësishëm.

2. Shkarkimi mund të bëhet me kërkesë të mbledhjes së kreditorëve. Para marrjes së vendimit, gjykata e falimentimit dëgjon anëtarin e komitetit të kreditorëve ose të mbledhjes së kreditorëve.

3. Kundër vendimit të gjykatës së falimentimit, anëtari i shkarkuar i komitetit të kreditorëve ka të drejtën e ankimit të veçantë.

Neni 68

Përgjegjësia e anëtarëve të komitetit të kreditorëve

1. Anëtarët e komitetit të kreditorëve janë përgjegjës dhe detyrohen të dëmshpërblejnë në rast se, për faj të tyre, shkelin ose nuk përmbushin detyrat që u ngarkon ky ligj.

2. Në rastin e pikës 1 të këtij neni, janë të zbatueshme njëlloj rregullat e parashkrimit të parashikuara në nenin Neni 60 të këtij ligji.

Neni 69

Vendimet e komitetit të kreditorëve

Vendimet e komitetit të kreditorëve janë të vlefshme kur në vendimmarrje ka marrë pjesë shumica e anëtarëve të tij dhe vendimi është marrë me shumicën e votave të anëtarëve pjesëmarrës. Lejohet edhe votimi me anë të përfaqësimit.

Neni 70

Shpenzimet e anëtarëve të komitetit të kreditorëve

Anëtarët e komitetit të kreditorëve kanë të drejtën të rimbursohen për shpenzimet e arsyeshme.

Neni 71

Thirrja e mbledhjes së kreditorëve

1. Mbledhja e kreditorëve thirret nga gjykata e falimentimit. Të drejtën e pjesëmarrjes në mbledhje e kanë të gjithë kreditorët me të drejtë ripagimi të veçantë, të gjithë kreditorët e procedurës së falimentimit, administratori i falimentimit, anëtarët e mbledhjes së kreditorëve dhe debitori.

2. Koha, vendi dhe rendi i ditës i mbledhjes së kreditorëve shpallet publikisht. Mbledhja e kreditorëve mund të mos shpallet publikisht në qoftë se gjykata e falimentimit vendos shtyrjen e saj.

Neni 72

Kërkesa për thirrjen e mbledhjes së kreditorëve

1. Mbledhja e kreditorëve thirret kur kërkohet nga:

- a) administratori i falimentimit;
- b) komiteti i kreditorëve;

- c) të paktën pesë nga kreditorët me të drejtë ripagimi të veçantë ose kreditorë të rangjeve jo të ulëta të procedurës së falimentimit, të drejtat dhe pretendimet e të cilëve së bashku rivlerësohen nga gjykata e falimentimit të barabarta me një të pestën e shumës së të drejtave dhe pretendimeve të kreditorëve me të drejtë ripagimi të veçantë dhe të kreditorëve të rangjeve jo të ulëta të procedurës së falimentimit.
 - d) një ose më shumë kreditorët me të drejtë ripagimi të veçantë ose kreditorë të rangjeve jo të ulëta të procedurës së falimentimit, të drejtat dhe pretendimet e të cilëve së bashku rivlerësohen nga gjykata e falimentimit të barabarta me dy të pestat e shumës së të drejtave dhe pretendimeve.
2. Nga marrja e kërkesës deri në datën e mbledhjes së kreditorëve nuk duhet të kalojnë më shumë se 15 ditë.
 3. Nëse gjykata e falimentimit vendos refuzimin e thirrjes së mbledhjes së kreditorëve, pala kërkuuese ka të drejtën e ankimit të veçantë.

Neni 73

Vendimet e mbledhjes së kreditorëve

1. Mbledhja e kreditorëve drejtohet nga administratori i falimentimit.
2. Vendimet e mbledhjes së kreditorëve janë të vlefshme nëse shumica e pretendimeve të kreditorëve në favor të vendimit është më e madhe se gjysma e shumës së përgjithshme të pretendimeve të kreditorëve me të drejtë vote, të cilët mund të votojë personalisht ose me përfaqësim. Për kreditorët e siguruar me të drejtë ripagimi të veçantë, kundrejt të cilëve debitori nuk është përgjegjës personalisht, pretendimi zëvendësohet me vlerën e kësaj të drejte.

Neni 74

Përcaktimi i të drejtës së votës

1. E drejta e votës përcaktohet në bazë të pretendimeve të paraqitura nga kreditori dhe që nuk janë kundërshtuar nga administratori i falimentimit ose nga ndonjë kreditor me të drejtë vote. Kreditorët e rangjeve më të ulëta të preferimit nuk kanë të drejtë vote.
2. Kreditorët, pretendimet e të cilëve janë kundërshtuar, kanë të drejtë vote, me kusht që administratori, të ketë rënë dakord për ta lejuar këtë të drejtë vote gjatë mbledhjes së kreditorëve. Në rast se palët nuk arrijnë një marrëveshje, vendos gjykata e falimentimit. Gjukata e falimentimit mund të ndryshojë vendimin, me kërkesë të administratorit ose të një kreditori, pjesëmarrës në mbledhjen e kreditorëve.
3. Pika 2 e këtij neni zbatohet njëllë për:
 - a) kreditorët me pretendim të kushtëzuar nga një kusht i mëparshëm;
 - b) kreditorët me të drejtë ripagimi të veçantë.

Neni 75

Prishja e vendimit të marrë nga mbledhja e kreditorëve

1. Kundër vendimit të mbledhjes së kreditorëve kanë të drejtë të ankohen brenda 5 ditëve nga marrja në dijeni për vendimin, kreditorët me të drejtë ripagimi të veçantë, kreditorët e rangjeve jo të ulëta të procedurës së falimentimit ose administratori i falimentimit.

2. Vendimi mund të ankohet nëse bie në kundërshtim me interesat e përbashkëta të kreditorëve të falimentimit, për parregullsi të procedurës së mbledhjes së kreditorëve ose për veprime të pandershme të konstatuara gjatë saj.
3. Nëse vendimi është marrë me shumicë kreditorësh që përfaqësojnë në të njëjtën kohë edhe shumicën e pretendimeve, atëherë vendimi mund të ankimohet vetëm për shkaqe procedurale lidhur me parregullsi të procedurës së mbledhjes së kreditorëve ose për veprime të pandershme të konstatuara gjatë saj.
4. Vendimi i gjykatës së falimentimit për prishjen e vendimit të mbledhjes së kreditorëve shpallet publikisht.
5. Kundër vendimit të gjykatës së falimentimit për prishjen e vendimit të mbledhjes së kreditorëve, çdo kreditor me të drejtë ripagimi të veçantë dhe çdo kreditor falimentimi, që nuk bën pjesë në rangjet më të ulëta të preferimit, kanë të drejtën e ankimit. Pala kërkuese, ka të drejtën e ankimit të veçantë kundër një vendimi që refuzon këtë prishje.

Neni 76

Vënia në dijeni e mbledhjes së kreditorëve

1. Mbledhja e kreditorëve mund t'i kërkojë administratorit të falimentimit dhënien e informacioneve të veçanta dhe një raport për ecurinë e procedurës së falimentimit dhe për administrimin e masës së falimentimit.
2. Nëse nuk është caktuar një komitet kreditorësh, mbledhja e kreditorëve mund të verifikojë veprimet monetare të administratorit dhe gjendjen e të hollave të disponueshme.

PJESA E TRETË.

PASOJAT E HAPJES SË PROCEDURËS SË FALIMENTIMIT

KREU I.

PASOJA TË PËRGJITHSHME

Neni 77

E drejta për transferimin dhe administrimin e masës së falimentimit

Me hapjen e procedurës së falimentimit, e drejta e debitorit për të administruar dhe disponuar pasurinë, që bën pjesë në masën e falimentimit, nëse nuk është vendosur ndryshe nga gjykata e falimentimit, i kalon administratorit të falimentimit.

Neni 78

Disponimi nga debitori

1. Nëse pas hapjes së procedurës së falimentimit debitori tjetëron sende nga masa e falimentimit, këto veprime janë të pavlefshme. Vlera e përfituar nga tjetërsimi i kthehet palës tjetër, duke u nxjerrë nga masa e falimentimit, sipas pikës 3 të këtij neni.
2. Lidhur me detyrimin e pretendimeve të ardhshme për pagesat ndaj debitorit që burojnë nga një kontratë shërbimi ose pagesat e përsëritura që i zëvendësojnë ato, pika 1 e këtij nenizbatohet në masën sa këto detyrime mbulojnë çdo pagesë që merret nga debitori pas përfundimit të procedurës së falimentimit. Nuk cenohet e drejta e debitorit për të ngarkuar një person të besuar për pagesa të tilla me qëllim ripagimin e veçantë të kreditorëve të procedurës së falimentimit.
3. Nëse debitori ka kryer veprimin në ditën e hapjes së procedurës së falimentimit, transferimi prezumohet të jetë kryer pas hapjes së kësaj procedure. Çdo transferim i bërë nga debitori pas ditës kur procedura e falimentimit është hapur do të sjellë pasoja juridike, nëse një transferim i tillë është bërë ditën e hapjes së procedurës edhe nëse pala tjetër provon se nuk ka pasur dijeni ose nuk ka qenë e detyruar të dinte për hapjen e procedurës së falimentimit.

Neni 79

Veprimet në favor të debitorit

1. Në rast se pas hapjes së procedurës së falimentimit është shlyer një detyrim në favor të debitorit, pala përmbushëse shkarkohet nga detyrimi, nëse nuk ka qenë në dijeni të hapjes së procedurës së falimentimit në kohën e kryerjes së veprimit.
2. Nëse pala përmbushëse e ka shlyer detyrimin para shpalljes së vendimit për hapjen e procedurës, prezumohet se kjo palë nuk ka pasur dijeni për këtë procedurë.

Neni 80
Pasuria e trashëgimlënësit. Bashkësia vazhduese

Nëse debitori para hapjes së procedurës së falimentimit ose gjatë saj trashëgon një pasuri, vetëm debitori ka të drejtë të heq dorë nga trashëgimia osenga pasuria trashëgimore. I njëjti rregull do të zbatohet në rastin e një bashkësie vazhduese.

Neni 81
Likuidimi i një shoqërie të thjeshtë ose ortakërie

1. Në rast se ndërmjet debitorit dhe të tretëve është krijuar një ortakëri, një bashkëpronësi ose një shoqëri e thjeshtë, çdo shpërndarje ose likuidim kryhet në përputhje me dispozita të parashikuara jashtë procedurës së falimentimit.
2. Marrëveshja që mohon të drejtën e likuidimit të një ortakërie, përgjithmonë ose për një kohë të caktuar, nuk sjell pasoja të detyrueshme për procedurën e falimentimit. I njëjti rregull zbatohet edhe për testamentin e personit që ka vdekur kur përmban një kusht me të njëjtën përmbajtje, si dhe për një marrëveshje të ngjashme të lidhur midis trashëgimtarëve.

Neni 82
Pezullimi i padive të ngritura

1. Me hapjen e procedurës së falimentimit pezullohen të gjitha paditë civile ku debitori është palë.
2. Pezullimi i parashikuar në pikën 1 të këtij neni nuk zbatohet për paditë civile të ngritura, ku palë janë kreditorët e siguruar, përveç rasteve kur parashikohet ndryshe në këtë ligj.

Neni 83
Vazhdimi i padive të ngritura, ku debitori është paditës

Paditë e lidhura me pasuritë e masës së falimentimit, ku debitori është paditës, të pezulluara nga data kur procedura e falimentimit është hapur, rifillojnë në favor të masës së falimentimit, me kërkesë të administratorit të falimentimit nëse është caktuar një i tillë.

Neni 84
Vazhdimi i padive të ngritura, ku debitori është i paditur

1. Paditë e pezulluara kundër debitorit si i paditur në datën kur ka filluar procedura e falimentimit mund të rifillojnë me kërkesë të administratorit të falimentimit ose të paditësit nëse ato kanë lidhje me:
 - a) veçimin e një sendi nga masa e falimentimit;
 - b) ripagimin e veçantë;
 - c) detyrimin ndaj një pasurie të përfshirë në masën e falimentimit.
2. Nëse administratori i falimentimit i njeh këto padi menjëherë, paditësi mund të kërkojë rimbursim të shpenzimeve për ngritjen e padive vetëm në cilësinë e kreditorit të falimentimit.

Neni 85
Pretendimet e paraqitura nga kreditorët e procedurës së falimentimit

Kreditorët e procedurës së falimentimit do të lejohen që të kryejnë ekzekutim të detyrueshëm të pretendimeve të tyre sipas dispozitave që rregullojnë procedurën e falimentimit.

Neni 86
Ekzekutimi përpara hapjes së procedurës së falimentimit

1. Çdo urdhër ekzekutimi i detyrueshëm mbi pasurinë e debitorit është i pavlefshëm derisa të marrë formë përfundimtare plani i zyrës së përmbarimit për ndarjen e të ardhurave.
2. Pasuria e debitorit që sekuestrohet nga përmbaruesi gjyqësor dhe shumat e fituara nga shitja e pasurive bëhen pjesë e masës së falimentimit dhe përmbaruesi gjyqësor duhet t'ia dorëzojë administratorit të falimentimit.

Neni 87
Dëmi i përgjithshëm

1. Administratori i falimentimit është i vetmi person, i cili, gjatë procedurës së falimentimit, mund të pretendojë të drejtën për dëmshpërblim të kreditorëve të falimentimit për dëme që ata kanë pësuar bashkërisht, para ose pas hapjes së procedurës së falimentimit, për shkak të zvogëlimit të pasurive të masës së falimentimit.
2. Nëse padia e ngritur sipas pikës 1 të këtij neni drejtohet kundër administratorit të falimentimit, pretendimi ngrihet vetëm nga administratori tjetër i falimentimit, i emëruar pas tij.

Neni 88
Përgjegjësia e pakufizuar e ortakëve

Nëse procedura e falimentimit është hapur për pasuritë e një shoqërie të thjeshtë ose një shoqërie me përgjegjësi të pakufizuar, vetëm administratori i falimentimit mund të kërkojë përmbushjen e detyrimeve të shoqërisë nga përgjegjësia personale e një ortaku për detyrimet e shoqërisë gjatë procedurës së falimentimit.

Neni 89
Mbajtja e së drejtës për kompensim të ndërsjellë të pretendimeve

Në rast se, sipas ligjit ose një marrëveshjeje, në kohën e fillimit të procedurës së falimentimit, një kreditor falimentimi ka të drejtën e kompensimit të ndërsjellë të pretendimeve në datën e hapjes së procedurës së falimentimit, kjo e drejtë nuk cenohet nga procedura e falimentimit.

Neni 90
Fitimi i së drejtës për kompensim të ndërsjellë të pretendimeve

1. Nëse në datën kur procedura e falimentimit është hapur rezulton se një ose më shumë kërkesa për kompensim kundrejt njëra-tjetrës ishin të kushtëzuara, të pamaturuara ose nuk mbulojnë lloje të ngjashme të përmbushjes, këto kompensime nuk mund të realizohen pa u plotësuar kushtet. Në këtë rast, lidhur me llogaritjen e pretendimeve, nuk do të zbatohet pika 1 dhe pika 4 e nenit Neni 52.
2. Kompensimi përjashtohet në qoftë se kërkesa kundrejt të cilës kompensimi do të kryhet duhet të jetë i pakushtëzuar dhe i maturuar para se të mund të kompensohet.
3. Kompensimi nuk përjashtohet kur pretendimet që shprehen në monedha të ndryshme nëse këto monedha janë lirisht të shkëmbyeshme në vendin e pagesës ku do të kryhet kompensimi. Shumat e detyrimeve do të konvertohen sipas vlerës së këmbimit në vendin dhe në kohën e pranimit të deklaratës së kompensimit.

Neni 91

Ndalimi i kompensimit të ndërsjellë

Kompensim i ndërsjellë nuk kryhet në rastet kur:

- a) detyrimet e një kreditori falimentimi ndaj masës së falimentimit kanë lindur vetëm pas hapjes së procedurës së falimentimit;
- b) një kreditor falimentimi e ka fituar të drejtën e kompensimit të ndërsjellë nga një kreditor tjetër vetëm pas hapjes së procedurës së falimentimit;
- c) një kreditor falimentimi e ka fituar të drejtën e kompensimit të ndërsjellë të pretendimit nëpërmjet një veprimi që duhet shmangur;
- d) një kreditor me të drejtë veçimi, pretendimi i të cilit duhet të përmbushet nga pasuria e debitorit që nuk është mjet sigurimi, ka një detyrim ndaj masës së falimentimit.

Neni 92

Detyrimi i debitorit për të paraqitur të dhëna dhe për të bashkëpunuar

1. Anëtarët e bordit të drejtorëve si dhe anëtarët/ortakët/aksionerët e shoqërisë, ndaj së cilës është hapur procedura e falimentimit, kanë detyrë të venë në dijeni gjykatën e falimentimit, administratorin e falimentimit, komitetin e kreditorëve dhe, nëse urdhërohet nga gjykata e falimentimit, edhe mbledhjen e kreditorëve, për të gjitha rrethanat që kanë të bëjnë me procedurën e falimentimit.
2. Anëtarët e bordit të drejtorëve si dhe anëtarët/ortakët/aksionerët e shoqërisë, ndaj së cilës është hapur procedura e falimentimit, duhet të ndihmojnë administratorin e falimentimit për kryerjen e detyrës.
3. Gjykata e falimentimit mund të urdhërojë që anëtarët e bordit të drejtorëve si dhe anëtarët/ortakët/aksionerët e shoqërisë, ndaj së cilës është hapur procedura e falimentimit, të jenë të gatshëm, në çdo kohë, për të përmbushur detyrimet për të paraqitur të dhëna dhe për të bashkëpunuar. Anëtarët e bordit të drejtorëve si dhe anëtarët/ortakët/aksionerët e shoqërisë, ndaj së cilës është hapur procedura e falimentimit, ndalohen të kryejnë çfarëdo lloj veprimi, që pengon përmbushjen e këtyre detyrave.

Neni 93

Detyrimet e debitorit për bashkëpunim në zbulimin e informacionit të falimentimit

1. Debitori duhet të zbulojë çdo rrethanë që lidhet me procedurën e falimentimit para gjykatës së falimentimit, administratorit të falimentimit dhe komitetit të kreditorëve dhe nëse urdhërohet nga gjykata edhe para mbledhjes së kreditorëve. Ai duhet të zbulojë çdo fakt që sjell përgjegjësi për çdo procedim penal ose administrativ. Fakti që zbulohet nga debitori nën detyrimin e parashikuar sipas kësaj pike mund të mos përdoret kundër debitorit pa pëlqimin e tij në një procedim administrativ ose penal.
2. Debitori duhet të mbështesë administratorin në përmbushjen e detyrave të tij.
3. Debitori mund të urdhërohet me një vendim gjykate që të përmbushë detyrimet e tij për zbulimin e bashkëpunimit në një kohë të përshtatshme. Ai do të ndalojë çdo veprim që kundërshton përmbushjen e detyrimeve të tij.

Neni 94

Zbatimi i detyrave të debitorit

1. Nëse është e nevojshme të paraqiten deklarata të vërtetuara, gjykata e falimentimit urdhëron debitorin të paraqesë një deklaratë me shkrim lidhur me faktin se provat që ai ka paraqitur përmbajnë të dhëna të vërteta, të sakta dhe të plota mbi faktet e kërkuara.
2. Gjkata mund të thërrasë debitorin të paraqitet me detyrim si dhe të mos largohet nga vendbanimi ose selia, pas marrjes së tij në pyetje, në rastet kur:
 - a) debitori përfshirë, drejtorët, zyrtarët, ortakët ose aksionarët e shoqërisë, ndaj së cilës është hapur procedura e falimentimit, nuk pranon të japë të dhëna ose deklarata të shkruar ose të mbështesë përmbushjen e detyrimeve të administratorit të falimentimit;
 - b) debitori përpiqet të shmangë ekzekutimin e detyrimeve për të paraqitur ose për të bashkëpunuar, veçanërisht duke përgatitur largimin e tij, ose
 - c) nëse thirrja e detyruar dhe ndalimi i lëvizjes janë të nevojshme për të shmangur veprime të debitorit që janë në kundërshtim me zbatimin e detyrimit të tij për të paraqitur të dhëna dhe për të bashkëpunuar veçanërisht, për të siguruar vlerat e përfshira në procedurat e falimentimit.
3. Urdhri për masën e kufizimeve të mësipërme do të hiqet kryesisht sapo të konstatohet se nuk ka më kushte për vazhdimin e një mase të tillë. Kundër vendimit për detyrimin e qëndrimit, si dhe kundër vendimit që rrëzon kërkesën për heqjen e kësaj mase bëhet ankim veçantë.

Neni 95

Kontrolli i postës së debitorit

1. Nëse është e nevojshme për të hetuar ose parandaluar veprimet e debitorit që dëmtojnë kreditorët, gjykata e falimentimit, me kërkesë të administratorit të falimentimit ose kryesisht, me vendim të arsyetuar, urdhëron që subjektet e përfshira në vendim të ridrejtojnë për tek administratori një pjesë ose të gjithë shkëmbimin e korrespondencës drejtuar debitorit. Para shpalljes së këtij vendimi, gjykata e falimentimit kërkon dhe dëgjon debitorin, me përjashtim të rastit kur, për shkak të rrethanave të veçanta, një gjë e tillë rrezikon qëllimin e urdhërimit.

Nëse debitori nuk dëgjohej paraprakisht, nëvendimin e gjykatës së falimentimit shpjegohen arsyet për mospërbushjen ekëtij veprimi dhe seanca e dëgjimit të debitorit duhet të mbahet pa vonesë.

2. Administratori ka të drejtë të hapë korrespondencën e debitorit, që i është ridrejtuar atij. Korrespondenca që nuk ka të bëjë me masën e falimentimit i dorëzohet menjëherë debitorit. Debitori mund të kontrollojë edhe korrespondencat e tjera postare.

3. Debitori mund të bëjë ankim të veçantë kundër vendimit për kontroll të korrespondencës së vet. Në rast se nuk ekziston më shkak për ushtrimin e këtij kontrolli të korrespondencës, gjykata e falimentimit pezullon zbatimin e vendimit për kontrollin e korrespondencës së debitorit, pasi dëgjon më parë administratorin e falimentimit.

Neni 96

Anëtarët e organit përfaqësues të debitorit. Punonjësit

1. Kur debitori nuk është person fizik, nenet Neni 92, Neni 93 dhe Neni 95 të këtij ligji zbatohen njëjloj edhe për anëtarët e bordit të drejtorëve si dhe anëtarët/ortakët/aksionerët e shoqërisë ndaj së cilës është hapur procedura e falimentimit, si dhe për ortakët e përgjithshëm, që kanë të drejtë ta përfaqësojnë atë.

2. Nenet Neni 92 pika 1 dhe Neni 93 të këtij ligji zbatohen njëjloj për punonjësit e debitorit dhe për punonjësit që kanë jo më pak se dy vjet që janë larguar nga detyra, përpara se të kërkohej hapja e procedurës së falimentimit. Nëse debitori nuk ka përfaqësues, kjo zbatohet për individët që marrin pjesë në të.

3. Nëse personat e përmendur në pikat 1 dhe 2 të këtij neni nuk plotësojnë detyrimet e tyre për të bërë të mundur të dhënat ose bashkëpunimin, ata mund të urdhërohen të paguajnë koston e procedurës së falimentimit në rast se ka pamjaftueshmëri për mbulimin e shpenzimeve të saj.

Neni 97

Pagesat nga masa e falimentimit për shpenzimet e jetesës

1. Administratori i falimentimit pasi konsultohet me komitetin e kreditorëve kur ky ekziston ose me mbledhjen e kreditorëve, vendos nëse debitori dhe familja e tij duhet të marrë nga masa e falimentimit ndonjë pagesë për mjete jetese si dhe masën e pagesës.

2. Pagesa për mjete jetese duhet të parashikojë përmbushjen e nevojave të debitorit, të fëmijëve të mitur në ngarkim dhe të bashkëshortit/es, ish-bashkëshortit/es përsa i përket detyrimeve sipas legjislacionit në fuqi.

3. Pagesa për mjete jetese nuk mund të jetë më e vogël se shuma që parashikon legjislacioni i posaçëm për mbështetjen sociale.

4. Kundër vendimit të administratorit të falimentimit për caktimin e pagesës për mjete jetese mund të bëhet ankim në gjykatën e falimentimit.

KREU II.

PËRMBUSHJA E VEPRIMEVE LIGJORE

Neni 98

Kontratat që vazhdojnë

1. Kur një kontratë, në kohën e fillimit të procedurës së falimentimit, nuk është zbatuar plotësisht, si nga debitori ashtu edhe nga pala tjetër, administratori i falimentimit mund ta zbatojë këtë kontratë në vend tëdebitorit dhe të pretendojë nga pala tjetër pagesën e vlerës ose përmbushjen e detyrimit.
2. Në qoftë se administratori i falimentimit nuk pranon zbatimin e kësaj kontrate, pala tjetër ka të drejtë të ngrejë pretendim për moszbatim kontrate vetëm si kreditor falimentimi. Nëse pala tjetër i kërkon administratorit të falimentimit të ushtrojë ose të refuzojë të drejtën e zbatimit të kontratës, administratori i falimentimit duhet të deklarojë, pa vonesë, nëse do të kërkojë zbatimin e kontratës. Nëse administratori i falimentimit nuk bën një deklaram të tillë, ai humbet të drejtën për të kërkuar më pas zbatimin e detyrimit ose përmbushjen e veprimit, sipas kontratës.
3. Pikat 1 dhe 2 të këtij neni nuk zbatohen për dispozita dhe kontrata të veçanta, të parashikuara në nenet në vijim të këtij kreu.

Neni 99

Veprimet me data fikse. Titujt financiarë

1. Në qoftë se është rënë dakord që dorëzimi i mallrave të kryhet në një afat të caktuar dhe në rast se ky afat përfundon pasi është hapur procedura e falimentimit, nuk mund të kërkohe përmbushja në natyrë e detyrimit, por mund të ngrihet vetëm pretendimi për dëmin e shkaktuar nga mospërmbushja e tij.
2. Nëse është rënë dakord që zbatimi i një veprimi të natyrës financiare me çmim tregu ose burse të kryet në një afat të caktuar dhe në rast se ky afat kohor përfundon pas hapjes së procedurës së falimentimit zbatohen njëllor pika 1 e këtij neni. Quhen veprime me natyrë financiare veçanërisht:
 - a) dorëzimi i metaleve të çmuara;
 - b) dorëzimi i letrave me vlerë ose i të drejtave të ngjashme, me kusht që të mos jetë si qëllim pjesëmarrja në një shoqëri ose veprimtari për vendosjen e një pjesëmarrjeje afatgjatë;
 - c) përmbushjet në lloj, që duhet të kryhen në monedhë të huaj ose njësi matëse përkatëse sipas kursit të këmbimit;
 - d) të drejta të tjera për furnizime ose zbatime kontrate në lloj në kuptimin e germës ‘a’, ‘b’ dhe ‘c’ të kësaj pike;
 - e) sigurimet financiare sipas legjislacionit bankar.
3. Nëse transaksionet për performancat financiare janë të përfshira në një kontratë tip ose model për të cilën është arritur një marrëveshje që në rast arsyes për falimentimin ajo mund të ndërpritet në mënyrë tërësore, këto transaksione do të konsiderohen si një kontratë e përbashkët, sipas kuptimit të neneve Neni 98 dhe Neni 99 të këtij ligji.
4. Pretendimi për dëmin që vjen nga mospërmbushja e detyrimit llogaritet si diferenca midis çmimit të rënë dakord me çmimin mbizotërues të tregut ose të bursës në vendin dhe kohën e rënë dakord nga palët, por, megjithatë, jo më vonë se dita e pestë e punës pasi janë hapur procedurat e falimentimit për një kontratë ku përcaktohet periudha e përmbushjes. Nëse palët nuk arrijnë të bien dakord, kjo datë do të jetë dita e dytë e punës pas hapjes së

procedurës së falimentimit. Pala tjetër ka të drejtë të ngrejë pretendime për moszbatim kontrate vetëm si kreditor falimentimi.

Neni 100

Kontrata periodike

1. Nëse përmbushjet kontraktore që përbëjnë detyrime ndaj palëve janë periodike, dhe nëse pala tjetër ka përmbushur një pjesë të shërbimeve në kohën kur është hapur procedura e falimentimit, kjo palë quhet kreditor falimentimi për shumën e pretendimit të saj, për vlerën që i përgjigjet pjesës së shërbimeve të kryera, edhe sikur administratori i falimentimit të pretendojë kryerjen e shërbimeve ende të papërmbushura.
2. Pala tjetër nuk ka të drejtë të kërkojë kthimin e pjesës së shërbimeve që i ka kaluar pasurisë së debitorit para hapjes së procedurës së falimentimit, duke nxjerrë si shkak pretendimin për mospagim të detyrimit përkatës.

Neni 101

Rezerva e pronësisë

1. Nëse para hapjes së procedurës së falimentimit debitori ka shitur një send të luajtshëm me rezervë pronësie duke ia kaluar blerësit zotërimin e sendit, blerësi mund të pretendojë zbatimin e kontratës së shitjes.
2. Nëse para hapjes së procedurës së falimentimit debitori ka blerë një send të luajtshëm, ku shitësi ushtron të drejtën e rezervës së pronësisë, ndërkohë që shitësi ose administratori i falimentimit i ka kaluar zotërimin debitorit, administratori i falimentimit, të cilit shitësi i ka kërkuar të ushtrojë të drejtën e zgjedhjes zbatimit ose moszbatimit, nuk është i detyruar, sipas pikës 2 të nenit Neni 98, të paraqesë deklaratë, në rast se nuk do të ketë një vonesë të arsyeshme pas mbledhjes mbi raportimin. Kjo dispozitë nuk zbatohet kur gjatë periudhës para mbledhjes së raportimit pritet një pakësim i ndjeshëm i vlerës së sendit dhe kreditori ia ka vënë në dukje këtë rrethanë administratorit të falimentimit.

Neni 102

Vazhdimësia e kontratave

1. Kontratat e lidhura ndërmjet debitorit si qiradhënës ose qiramarrës, për qiranë e objekteve të paluajtshme ose pjesëve të tyre dhe për shërbime që duhen kryer lidhur me to, vazhdojnë të ekzistojnë në favor të masës së falimentimit. Ky rregull do të zbatohet edhe për kontratat e qirasë të lidhura nga debitori si pronar ose qiradhënës mbi pasuri të fituara për shkak të financimit nga një palë e tretë e cila i ka siguruar ato.
2. Kontrata e huasë e lidhur nga debitori si qiradhënës do të vazhdojë të ekzekutohet mbi masën e falimentimit për aq kohë sa objekti i zotëruar i është ofruar marrësit.
3. Pretendimet e ngritura para hapjes së procedurës së falimentimit mund të ngrihen nga pala tjetër vetëm në cilësinë e kreditorit të procedurës të falimentimit.

Neni 103

Debitori si qiramarrës ose leasing-marrës

1. Administratori i falimentimit mund të zgjidhë një kontratë qiraje për objekte të paluajtshme, kontrate qiraje për pjesë të tyre ose kontratë leasing ku debitori është qiramarrës ose leasing-marrës, pavarësisht kushteve të kontratës ose periudhës së njoftimit për të cilën është rënë dakord në marrëveshjen e palëve. Periudha e njoftimit zgjat deri në tri muaj deri në datën e fundit të muajit. Nëse objekt i një kontrate leasing është banesa e debitorit, administratori i falimentimit ka të drejtë që në vend të zgjidhjes së kontratës të deklarojë të mos përfshijë pretendimin në procedurat e falimentimit në rast se pretendimeve u ka kaluar afati i përcaktuar në fjalinë e dytë të kësaj pike. Nëse administratori i falimentimit e zgjidh kontratën sipas fjalisë sëparë ose deklaron sipas fjalisë së tretë, pala tjetër mund të pretendojë dëmshpërblim kontrate si kreditor falimentimi.

2. Nëse debitori, në kohën e hapjes së procedurës së falimentimit, nuk kishte fituar ende zotërimin e sendeve të paluajtshme, administratori dhe pala tjetër mund të tërhiqen nga kontrata. Kur tërhiqet administratori, pala tjetër, mund të kërkojë, si kreditor falimentimi, dëmshpërblim për zgjidhje të parakohshme të kontratës. Me kërkesë të palës tjetër, secila prej palëve duhet të deklarojë, brenda 15 ditësh, nëse ka synim të tërhiqet nga kontrata. Nëse asnjëra prej palëve nuk bën një deklaratë të tillë, ajo humbet të drejtën e tërheqjes nga kontrata.

Neni 104

Debitori në rolin e pronarit ose të qiradhënësit

1. Në qoftë se para hapjes së procedurës së falimentimit debitori, si pronar ose qiradhënës i lokaleve ose sendeve të paluajtshme, ia ka kaluar një pale të tretë të drejtën e mbajtjes ose pagesës së qirasë përpara hapjes së procedurës së falimentimit, ky kalim mbetet i vlefshëm vetëm për pagesën e qirasë së muajit në të cilin është hapur procedura e falimentimit. Në qoftë se procedura është hapur pas ditës së pesëmbëdhjetë të muajit, e drejta e pagesës mbetet e vlefshme edhe për muajin e ardhshëm.

2. Kundër pretendimit të pagesës së qirasë që mbulon periudhën e përmendur në pikën 1 të këtij neni, qiramarrësi mund të kërkojë dëmshpërblim të ndërsjellë për çdo pretendim kundrejt debitorit.

3. Në rastin e pikës 2 të këtij neni mbeten të pazbatueshme parashikimet e nenit Neni 89 të këtij ligji.

Neni 105

Shitja e pasurive të debitorit të dhëna me qira

Nëse administratori i falimentimit shet sende të paluajtshme të cilat debitori i ka dhënë me qira dhe nëse blerësi zëvendëson debitorin si palë në marrëdhënien e qirasë, blerësi mund të zgjidhë marrëdhënien e qirasë.

Neni 106

Moszgjidhja e kontratës së qirasë

Nëse nuk është parashikuar ndryshe, kontrata e qirasë e lidhur mes debitorit si qiramarrës dhe një pale tjetër, nuk mund të zgjidhet nga qiradhënësi pasi të jetë kërkuar hapja e procedurës së

falimentimit për shkak të:

- a) mospagimit të qirasë para hapjes së procedurës së falimentimit;
- b) përkeqësimit të gjendjes pasurore të debitorit.

Neni 107

Zgjidhja e kontratës së shërbimit

Administratori i falimentimit dhe pala tjetër mund të zgjidhin një kontratë, ku shërbimet kryhen në favor të debitorit, duke dhënë njoftimin brenda afatit ligjor, pavarësisht nga një kohëzgjatje tjetër ose përjashtimi me marrëveshje të drejtës për zgjidhje kontrate, sipas rregullit të përgjithshëm, për të cilën është rënë dakord ndërmjet palëve. Nëse nuk është bërë marrëveshje për një periudhë më të shkurtër, periudha e njoftimit është deri në 15 ditë. Në rast se administratori i falimentimit zgjidh kontratën, pala tjetër mund të kërkojë dëmshpërblim, për shkak të zgjidhjes së parakohshme të kontratës, si kreditor falimentimi.

Neni 108

Mbarimi i porosisë

1. Porosia e caktuar nga debitori dhe që i referohet masës së falimentimit mbaron me hapjen e procedurës së falimentimit.
2. Nëse mbarimi i porosisë mund të shkaktojë dëme, i porosituri vazhdon të kryejë veprimet e caktuara derisa administratori i falimentimit të ketë mundësinë të kujdeset vetë për këto veprime. Porosia quhet se vazhdon për këtë qëllim. I porosituri mund të pretendojë rimbursim të shpenzimeve të kryera për vazhdimin e punës, si kreditor i masës së falimentimit.
3. Nëse i porosituri, jo për faj të tij, nuk ka dijeni për hapjen e procedurës së falimentimit, prezumohet se porosia vazhdon në favor të tij. I porosituri renditet si kreditor i procedurave të falimentimit me pretendimet e rimbursimit të vazhdimësisë së porosisë.

Neni 109

Pavlefshmëria e marrëveshjeve që bien ndesh me dispozitat e mësipërme

Është e pavlefshme çdo marrëveshje që kundërshton ose kufizon zbatimin e neneve Neni 98 deri Neni 108 të këtij ligji.

KREU III.

KUNDËRSHTIMI I VEPRIMEVE TË DEBITORIT NË NJË PROCEDURË FALIMENTIMI

Neni 110

Parimi i përgjithshëm

1. Administratori i falimentimit mund të kundërshtojë veprimet e kryera përpara hapjes së procedurës së falimentimit, të cilat dëmtojnë kreditorët e falimentimit, ose që i vendosin disa

kreditorë falimentimi në një pozitë më të favorshme sesa të tjerët, sipas dispozitave të këtij ligji.

2. Në rastin e parashikuar në pikën 1, mosveprimi vlerësohet i barasvlefshëm me veprimin.
3. Veprimi juridik mund të kundërshtohet edhe sikur pala tjetër të ketë siguruar një titull ekzekutiv ose sikur ky veprim të kryhej me rrugë ekzekutimi.
4. E drejta për kundërshtim mund të ushtrohet nga dita e hapjes së procedurës së falimentimit deri në ditën kur bëhet mbledhja përfundimtare për shpërndarjen e masës së falimentimit.

Neni 111

Kontratat me personat e lidhur me debitorin

1. Kontrata e lidhur me debitorin me një person që ka lidhje të ngushta me të, sipas pikës 22 të nenit Neni 3, të këtij ligji, duke sjellë drejtpërsëdrejti dizavantazhe për kreditorët e falimentimit, mund të anulohet. Ky anulim mund të përjashtohet vetëm nëse kontrata është lidhur të paktën dy vjet përpara paraqitjes së kërkesës për hapjen e procedurës së falimentimit.
2. Personat e lidhur me debitorin do të konsiderohen çdo person fizik ose juridik i cili, ka ose ka patur një interes të lidhur pasuror ose jo pasuror në raport me debitorin ose personi që ka patur një marrëdhënie personale me debitorin.
3. Kur personi është fizik, rastet janë si më poshtë:
 - a) bashkëshorti/ja ose bashkëjetuesi/ja e debitorit edhe kur bashkëjetesa ose martesë është lidhur vetëm pas kryerjes së veprimit juridik ose është zgjidhur ose anuluar në vitin e fundit përpara veprimit juridik;
 - b) paraardhësit ose pasardhësit e debitorit ose të bashkëshortit/bashkëjetuesit; motra dhe vëllezër dhe të afërt të debitorit dhe të bashkëshortit/bashkëjetuesit, dhe bashkëshortët/bashkëjetuesit e këtyre personave;
 - c) persona që jetojnë në banesën e debitorit ose kanë jetuar në këtë banesë në vitin e fundit para këtij veprimi, dhe persona që për efekt të marrëdhënies me debitorin, kanë mundësi për të marrë informacione mbi gjendjen financiare të debitorit;
4. Kur personi është juridik, rastet janë si më poshtë:
 - a) anëtarët e organit përfaqësues ose mbikëqyrës, ortakë të përgjithshëm, si dhe personat që zotërojnë më shumë se një të katërtën e kapitalit të debitorit;
 - b) një person, i cili ka patur mundësinë të ketë dijeni për gjendjen financiare të debitorit për shkak të lidhjes sipas ligjit për shoqëritë tregtare ose për shkak të një kontrate shërbimesh.
 - c) personi që ka një marrëdhënie personale.

Neni 112

Kundërshtimi i përmbushjes së detyrimit

1. Çdo veprim për përmbushjen e një detyrimi i kryer në një periudhë prej 6 muajsh përpara kërkesës për hapjen e procedurës së falimentimit, mund të kundërshtohet nëse debitori ka qenë në gjendje paaftësie paguese gjatë kësaj periudhe, dhe kreditori ka qenë në dijeni të këtij fakti.
2. Çdo veprim për përmbushjen e një detyrimi i kryer pas kërkesës për hapjen e procedurës së falimentimit, është i kundërshtueshëm.

Neni 113
Kundërshtimi i detyrimeve të përmbushur në mënyrë të parregullt

Çdo veprim i ndërmarrë në një periudhë prej 12 muajsh përpara kërkesës për hapjen e procedurës së falimentimit për përmbushjen e një detyrimi të pamaturuar, ose kundrejt një kreditori që nuk e ka këtë të drejtë, ose kur ai e ka këtë të drejtë, por përmbushja nuk është bërë në kohën dhe mënyrën e duhur, mund të kundërshtohet.

Neni 114
Veprimet që dëmtojnë drejtpërdrejt kreditorët e falimentimit

1. Veprimet e debitorit që dëmtojnë drejtpërdrejt kreditorët e falimentimit mund të kundërshtohen nëse janë kryer:
 - a) gjatë gjashtë muajve të fundit, para kërkesës për hapjen e procedurës së falimentimit, nëse debitori ka qenë në gjendjen e paaftësisë paguese në kohën e kryerjes së veprimit dhe nëse pala tjetër në këtë kohë ka pasur ose duhet të kishte dijeni për paaftësinë;
 - b) pas kërkesës për hapjen e procedurës së falimentimit dhe nëse pala tjetër në kohën e veprimit ka pasur ose duhet të kishte dijeni për paaftësinë paguese ose për kërkesën e hapjes së procedurës së falimentimit.
2. Një veprim që dëmton drejtpërdrejt kreditorët e falimentimit vlerësohet i njëjtë me çdo veprim tjetër të debitorit që e zhvesh atë nga secila prej të drejtave të tij ose që pengon të drejtën e debitorit për ngritjen e një pretendimi në të ardhmen ose që ka një pretendim pronësie ndaj debitorit ose që e bën këtë pretendim të ekzekutueshëm ndaj debitorit.
3. Pala tjetër kontraktore do të konsiderohet se dinte ose duhet ta dinte për paaftësinë paguese të debitorit, ose për hapjen e procedurës së falimentimit, nëse kishte dijeni rreth rrethanave që në mënyrë të pakundërshtueshme të çojnë në konkluzionin e mësipërm.

Neni 115
Dëmtimi i qëllimshëm

Çdo veprim i kryer nga debitori gjatë pesë viteve të fundit para kërkesës për hapjen e procedurës së falimentimit ose pas paraqitjes së kësaj kërkesë, për dëmtimin e kreditorëve të tij, mund të kundërshtohet nëse pala tjetër në kohën e veprimit ka pasur dijeni për qëllimin e debitorit. Kjo dijeni prezumohet kur pala tjetër dinte se debitori ka qenë në gjendjen e paaftësisë paguese dhe se veprimi dëmtonte kreditorët.

Neni 116
Veprimet juridike pa ose pothuaj pa shpërblim

1. Mund të kundërshtohet çdo veprim pa ose pothuaj pa shpërblim i dhënë nga debitori, me përjashtim të rastit kur ai është kryer më shumë se pesë vjet përpara kërkesës për hapjen e procedurës së falimentimit.
2. Nëse veprimi përbën një dhuratë të zakonshme me vlerë të vogël, apo dhuratë të dhënë për mirënjohje apo për qëllime humanitare kjo dhuratë mund të mos jetë subjekt i

kundërshtimit nëse konsiderohet e përshtatshme në raport me gjendjen financiare të debitorit në kohën kur është bërë.

3. Kur marrësi i një përfitimi pa ose pothuaj pa shpërblim nuk ka dijeni ose sipas rrethanave nuk kishte mundësi të dinte për dëmtimin e kreditorëve të procedurës së falimentimit, atëherë e kthen këtë përfitim vetëm në masën që ai është pasuruar prej tij.

4. Heqja dorë e debitorit nga trashëgimia nuk është objekt i kundërshtimit.

Neni 117 **Afatet Kohore**

1. Periudha kohore për kundërshtimet ndaj veprimeve të debitorit sipas këtij ligji, fillon nga data e depozitimit të kërkesës për hapjen e procedurës së falimentimit në gjykatën e falimentimit. Në qoftë se një datë e tillë mungon gjatë muajit, afati nis nga dita e parë e muajit pasardhës.

2. Në rast se janë marrë disa kërkesa për hapjen e procedurës së falimentimit, vlerësohet e vlefshme kërkesa e parë e pranueshme dhe që paraqet argumente për hapjen e procedurës së falimentimit, edhe sikur procedura të hapet mbi bazën e një kërkesë tjetër.

Neni 118 **Pasojat ligjore**

Nëse veprimi i kundërshtuar pranohet nga gjykata e falimentimit atëherë, pasuria e shitur e debitorit, pasuria e transferuar, pasuria e debitorit prej së cilës është hequr dorë sipas veprimit të kundërshtuar ose vlera e saj, duhet t'i kthehen masës së falimentimit.

Neni 119 **Kundërshtimi ndaj trashëgimtarëve dhe personave të tretë**

1. Padia e kundërshtimit mund të ngrihet edhe ndaj çdo trashëgimtari për pasurinë e përfituar nga veprimi i kundërshtueshëm.

2. Nëse pasuria objekt kundërshtimi i kalon një personi të tretë, atëherë padia mund të ngrihet ndaj këtij të fundit nëse:

- a) ka pasur dijeni për rrethanat që sollën pasurimin e palës së tij kontraktore;
- b) ka pasur lidhje me personat e afërt me debitorit sipas nenit Neni 111 të këtij ligji, në datën e përfitimit pasuror, përveç rastit kur personi i afërt nuk ka pasur dijeni për rrethanat që sollën pasurimin dhe për faktin që i ishte nënshtruar kundërshtimit në atë datë;
- c) ka fituar vlerën me anë të një veprimi juridik pa shpërblim.

PJESA E KATËRT.

ADMINISTRIMI DHE DISPONIMI I MASËS SË FALIMENTIMIT

KREU I.

SIGURIMI I MASËS SË FALIMENTIMIT

Neni 120

Marrja në zotërim e masës së falimentimit

1. Pas hapjes së procedurës së falimentimit, administratori i falimentimit merr menjëherë në zotërim dhe administrim të gjithë pasurinë që formon masën e falimentimit.
2. Administratori kërkon, përmes ekzekutimi të vendimit, marrjen e pasurive që ndodhen në ruajtje të debitorit duke paraqitur një kopje të vendimit të hapjes së procedurës së falimentimit. Në këtë rast gjykata e falimentimit zbaton dispozitat e Kreut IX dhe X të Pjesës së Katërt, Titulli II të Kodit të Procedurës Civile.

Neni 121

Sendet e çmuara

1. Administratori i falimentimit, me pëlqimin e komitetit të kreditorëve, mund të vendosë lidhur me agjencinë dhe kushtet e depozitimit ose të investimit të parave, të letrave me vlerë dhe sendeve të çmuara.
2. Kur është caktuar komiteti i kreditorëve, administratori i falimentimit ka të drejtë të depozitojë para, letra me vlerë ose sende të çmuara në agjencinë e depozitimit ose të investimit, vetëm në rast se një anëtar i këtij komiteti, së bashku me administratorin, nënshkruajnë faturën. Urdhrat e administratorit të falimentimit për këtë agjenci janë ligjërish të vlefshme me bashkë-nënshkrimin e një anëtari të komitetit të kreditorëve.
3. Mbledhja e kreditorëve, për çështjet e përmendura në këtë nen, mund të vendosë ndryshe.

Neni 122

Inventari i masës së falimentimit

1. Administratori i falimentimit përgatit një inventar të të gjithë pasurisë që përbën masën e falimentimit. Debitori merr pjesë në hartimin e këtij inventari nëse pjesëmarrja e tij nuk krijon vonesa të dëmshme për procedurën e falimentimit.
2. Vlera e çdo sendi duhet të jetë e përcaktuar. Në rast se vlera e sendit varet nga fakti nëse veprimtaria e debitorit do të vazhdojë ose do të mbyllet, paraqiten të dyja vlerat alternative përkatëse. Për përcaktimin e vlerës së sendeve, vlerësimi i të cilave paraqet vështirësi, mund të caktohet një ekspert.
3. Me kërkesë të arsyetuar të administratorit të falimentimit, gjykata e falimentimit ose komiteti i kreditorëve nëse është caktuar, mund të shtyjë kryerjen e inventarit.

Neni 123

Lista e kreditorëve

1. Administratori i falimentimit harton listën e të gjithë kreditorëve të debitorit, të cilët janë bërë të njohur nga librat e dokumentet e punës së debitorit, nëpërmjet njoftimit prej debitorit, me kërkesën e tyre ose me ndonjë mënyrë tjetër.
2. Lista e kreditorëve, me të drejtë ripagimi të veçantë dhe e çdo kategorie të rangjeve më të ulëta të kreditorëve të falimentimit duhet të paraqitet e ndarë. Për çdo kreditor shënohet adresa, arsyeja dhe shuma e pretenduar. Për kreditorët me të drejtë ripagimi të veçantë shënohet edhe sendi që është objekt pretendimi për ripagim të veçantë, si dhe shuma e mundshme e mospërmbushjes.
3. Gjithashtu lista duhet të tregojë gjendjen që mundëson kompensimin e ndërsjellë të pretendimeve dhe shumën e detyrimeve ndaj masës së falimentimit në rastin e një shitjeje të shpejtë të pasurisë së debitorit.

Neni 124

Kontrolli i pasurisë

Prej datës së hapjes së procedurës së falimentimit, administratori i falimentimit kryen një kontroll të detajuar ku tregohen objektet e përfshira masën e falimentimit dhe detyrimet e debitorit dhe bën bilancin e tyre.

Neni 125

Depozitimi në sekretarinë e gjykatës së falimentimit

Lista me sendet e masës së falimentimit, lista e kreditorëve dhe tabelat e pasurisë depozitohen në sekretarinë e gjykatës së falimentimit për t'u njohur nga palët, jo më vonë se një javë para mbledhjes së raportimit.

Neni 126

Mbajtja e llogarive sipas të drejtës tregtare dhe të legjislacionit tatimor

1. Detyrimet e debitorit, sipas të drejtës tregtare dhe të legjislacionit tatimor, për mbajtjen e llogarive, vijojnë. Administratori i falimentimit përcakton detyrimet për masën e falimentimit.
2. Me fillimin e procedurës së falimentimit fillon një vit i ri financiar.
3. Nëse është vendosur një auditor përpara vitit fiskal të hapjes së procedurave të falimentimit, auditori nuk ndryshohet nga hapja e procedurave të falimentimit.

KREU II.

VENDIMI PËR DISPONIMIN

Neni 127

Mbledhja e raportimit

1. Administratori i falimentimit raporton për gjendjen ekonomike të debitorit dhe shkaqet e falimentimit në mbledhjen e raportimit. Administratori analizon çdo perspektivë lidhur me mbajtjen tërësisht ose pjesërisht të veprimtarisë së debitorit, tregon mundësitë për hartimin e një plani riorganizimi dhe përshkruan pasojat e secilës prej zgjidhjeve për ripagimin e kreditorëve.
2. Në mbledhjen e raportimit u jepet mundësia debitorit, komitetit të kreditorëve dhe organit përfaqësues të punonjësve, të paraqesin deklaratat e tyre për raportin e administratorit.

Neni 128

Vendimmarrja për ecurinë e mëtejshme të procedurës

Gjatë mbledhjes së raportimit të kreditorëve vendoset nëse veprimtaria e debitorit duhet të mbyllet ose të vazhdojë përkohësisht. Mbledhja e kreditorëve mund të ngarkojë administratorin për hartimin e planit të riorganizimit duke përcaktuar objektivat e planit për të. Me kërkesë të administratorit ose të një të tretës së kreditorëve, për një vendimmarrje të mëtejshme, mbledhja mund të shtyhet jo më shumë se 10 ditë. Mbledhja mund të ndryshojë vendimet e veta në mbledhjet e mëvonshme.

Neni 129

Veprimet veçanërisht të rëndësishme

1. Nëse administratori i falimentimit synon të mbyllë, të shesë shoqërinë e debitorit ose të kryejë veprime të tjera me rëndësi të veçantë për procedurën e falimentimit, ai duhet të marrë miratimin e gjykatës së falimentimit e cila vendos pas dëgjimit të debitorit dhe komitetit të kreditorëve, nëse një i tillë ekziston.
2. Janë veprime veçanërisht të rëndësishme veprimet që synojnë:
 - a) të shitet ose të mbyllet veprimtaria, ndërmarrja, mallrat në tërësi, çdo pjesë e një sendi të paluajtshëm që shitet privatisht, aksionet ose pjesët e debitorit, një shoqërie tjetër, nëse këto aksione ose pjesë të këtyre aksioneve kanë për qëllim të krijojnë një lidhje të përhershme me ndërmarrjen tjetër ose t'i japin të drejtën e përfitimit të të ardhurave të përsëritshme;
 - b) marrjen e një huaje, e cila do të rëndonte në mënyrë të ndjeshme masën e falimentimit;
 - c) ngritjen e një padie ose marrjen pjesë në një padi për një vlerë të konsiderueshme që është objekt padie, të mos pranojë ngritjen e kësaj padie ose të negociohet hyrja në marrëveshje për një zgjidhje jashtëgjyqësore ose shmangie të padisë.

Neni 130

Disponimi i masës së falimentimit

Pas mbledhjes së raportimit, administratori i falimentimit duhet të likuidojë pa vonesë masën e falimentimit, përveç rastit kur mbledhja e kreditorëve vendos ndryshe.

KREU III.

SENDE QË I NËNSHTROHEN TË DREJTËS SË RIPAGIMIT TË VEÇANTË

Neni 131

E drejta e disponimit të sendit

1. Administratori i falimentimit, me miratimin e gjykatës së falimentimit, ka të drejtë të disponojë pa kufizim një send të paluajtshëm, i cili i nënshtrohet të drejtës së ripagimit të veçantë, në rast se vlera e kolateralit është më e madhe se vlera e kredisë së pretenduar nga kreditori i siguruar dhe shpenzimet për ekzekutimin e saj të marra së bashku.
2. Në rast se vlera e kolateralit është më e vogël ose e barabartë me vlerën e kredisë së pretenduar nga kreditori i siguruar dhe shpenzimet për ekzekutimin e saj, administratori i falimentimit vendos lejimin e kreditorit të siguruar për të ushtruar të drejtën e veçimit të sendit të paluajtshëm sipas këtij ligji.
3. Administratori i falimentimit, me miratimin e gjykatës së falimentimit, ka të drejtë të disponojë një send të luajtshëm mbi të cilin është vendosur një masë sigurimi, në rast se e zotëron atë. Ky rregull nuk zbatohet në rastet kur mjeti i sigurimit është në favor të një institucioni bankar.

Neni 132

Njoftimi paraprak i shitjes

1. Përpara se administratori i falimentimit t'i shesë një të tretit një send që disponon, ai njofton kreditorin me të drejtë ripagimi të veçantë për mënyrën e realizimit të kësaj shitjeje. Administratori i falimentimit, brenda një jave, i jep kreditorit mundësinë të propozojë një mundësi tjetër më të favorshme për shitjen e sendit.
2. Në qoftë se ky njoftim është bërë brenda një jave ose brenda një afati kohor të mjaftueshëm, përpara shitjes, administratori e përdor këtë mundësi ose kompenson kreditorin njësoj sikur do ta kishte përdorur këtë mundësi.
3. Mundësia tjetër e shitjes është shitja e sendit vetë kreditorit. Vlerësohet e favorshme shitja që kryhet me më pak shpenzime.

Neni 133

Mbrojtja e kreditorit nga shitja e vonuar

1. Në rast se nuk është shitur sendi për të cilin administratori i falimentimit ka të drejtën e disponimit, kreditorit i paguhet nga masa e falimentimit interesi i fituar që nga data e mbledhjes së raportimit. Në qoftë se gjykata e falimentimit ka vendosur një masë sigurie për ndalimin e kreditorit të shesë sendin para hapjes së procedurës së falimentimit, interesat e

mbetura paguhen jo më vonë se tre muaj pas vendimit të gjykatës. Dy fjalitë e para të kësaj pike nuk zbatohen për sa kohë shuma e pretendimeve të kreditorit, vlera dhe detyrimet e tjera, me të cilat është i ngarkuar sendi, nuk mund të mbulohen nga e ardhura e marrë prej shitjes për ripagimin e kreditorëve.

2. Pas përfundimit të afatit të përmendur në pikën 1 të këtij neni, kreditorët e siguruar mund t'i kërkojnë gjykatës së falimentimit heqjen e kufizimeve të vendosura prej saj. Gjykata e falimentimit duhet të japë miratimin pasi njofton dhe dëgjon administratorin e falimentimit, me përjashtim të rastit kur ky i fundit paraqet prova të mjaftueshme se kolaterali është i nevojshëm si pjesë e veprimtarisë ose e objektit ku kryhet kjo veprimtari.

3. Në çdo kohë, brenda afatit të përmendur në pikën 1 të këtij neni, gjykata e falimentimit duhet të heqë kufizimet e vendosura dhe të urdhërojë masa të tjera sigurimi, nëse kreditorët e siguruar provojnë se për shkak të veprimeve ose mosveprimeve të administratorit të falimentimit kolaterali po pëson humbje në vlerë.

Neni 134

Shpërndarja e të ardhurave

1. Në rastin e shitjes së një sendi, shpenzimet e përcaktimit dhe shpenzimet e shitjes së sendit i zbriten që më parë masës së falimentimit. Shuma e mbetur përdoret pa vonesë për ripagimin e kreditorëve me të drejtë ripagimi të veçantë.

2. Në qoftë se administratori i falimentimit i kalon kreditorit një send mbi të cilin ka të drejtën e shitjes sipas nenit Neni 131 të këtij ligji, me qëllim që të shitet prej këtij, kreditori i parapaguan masës së falimentimit një shumë, e cila mbulon shpenzimet e përcaktimit dhe taksat duke përdorur të ardhurat që ka fituar.

Neni 135

Llogaritja e kontributit për shpenzimet

1. Shpenzimet e përcaktimit përfshijnë shpenzimet e identifikimit konkret të sendit dhe ato të përcaktimit të të drejtave me të cilat është i rënduar ky send. Kjo pjesë e shpenzimeve llogaritet si shumë totale fikse prej katër për qind të të ardhurave.

2. Shpenzimet e disponimit do të vlerësohen si një shumë fikse prej pesë për qind e të ardhurave, përveç rasteve kur kostot që kanë qenë të nevojshme për disponimin, janë dukshëm më të ulëta ose më të larta.

3. Nëse ligji parashikon se, për masën e falimentimi duhen paguar detyrime fiskale, kjo shumë do të jetë e detyrueshme, përveç shumës fikse parashikuar prej këtij neni.

PJESA E PESTË

RIPAGIMI I KREDITORËVE TË FALIMENTIMIT. NDËRPRERJA E PROCEDURËS

KREU I.

PËRCAKTIMI I PRETENDIMEVE

Neni 136

Depozitimi i pretendimeve

1. Cilido që pretendon se është kreditor i falimentimit i paraqet me shkrim administratorit të falimentimit pretendimet e veta.
2. Kërkesës, të cilës i bashkëlidhen dokumentet që provojnë pretendimin, duhet të përmbajë arsyen, shumën e pretendimit dhe, sipas rastit, statusin si kreditor i siguruar ose me të drejtë ripagimi të veçantë.
3. Pretendimet mund të paraqiten edhe përmes dorëzimit elektronik të dokumenteve me kusht që administratori i falimentimi të ketë rënë dakord shprehimisht për këtë mënyrë dorëzimi. Në këtë rast, dokumentet ku shprehet pretendimi duhet të dorëzohen në formën e tyre origjinale menjëherë, sapo të kërkohen.

Neni 137

Tabela e pretendimeve

Administratori i falimentimit regjistron të gjitha pretendimet e kreditorëve. Tabela e pretendimeve depozitohet në gjykatën e falimentimit bashkë me aplikimet dhe vërtetimet e bashkëlidhura për inspektimin e bërë nga palët brenda një periudhe kohore sa një e treta e kohës ndërmjet ditës së fundit të afatit të depozitimit dhe mbledhjes për verifikimin e pretendimeve.

Neni 138

Mbledhja për verifikimin e pretendimeve

Në mbledhjen e verifikimit shqyrtohen pretendimet e paraqitura. Pretendimet që kundërshtohen nga administratori i falimentimit, debitori ose nga një kreditor falimentimi diskutohen në mënyrë të hollësishme.

Neni 139

Depozitimet e vonuara

1. Gjatë mbledhjes së verifikimit shqyrtohen edhe pretendimet e paraqitura pas përfundimit të afatit të vendosur për depozitimin e tyre. Në qoftë se verifikimi i këtyre pretendimeve kundërshtohet nga administratori i falimentimit ose nga një kreditor falimentimi, ose në qoftë

se pretendimi depozitohet pas mbledhjes së verifikimit, gjykata e falimentimit, me shpenzimet e të vonuarit, cakton një mbledhje të posaçme verifikimi ose urdhëron verifikimin në procedurë me shkrim.

2. Afati i mbledhjes së posaçme të verifikimit publikohet. Kreditorët e falimentimit, që kanë depozituar pretendimet, administratori i falimentimit dhe debitori duhet të marrin njoftim individual për thirrjen e kësaj mbledhjeje.

3. Nëse gjykata e falimentimit u kërkon kreditorëve të rangjeve më të ulëta të paraqesin pretendimet e tyre, dhe në qoftë se periudha kohore e përcaktuar për këtë pretendim skadon jo më vonë se një javë para mbledhjes së verifikimit, gjykata e falimentimit ose vë në rend dite një mbledhje verifikimi të veçantë ose urdhëron verifikimin me procedurat me shkrim dhe këtë kosto ia ngarkon masës së falimentimit.

Neni 140

Kushtet dhe pasojat e vërtetimit të pretendimeve

1. Një pretendim vlerësohet i vërtetuar nëse në mbledhjen e verifikimit ose gjatë procedurës me shkrim nuk është kundërshtuar nga administratori i falimentimit ose nga kreditorët e falimentimit.

2. Për çdo pretendim të depozituar, gjykata e falimentimit shënon në tabelë se në çfarë mase është vërtetuar shuma ose rangi, ose cila prej palëve ka kundërshtuar vërtetimin. Në tabelë regjistrohen edhe kundërshtimet e debitorit. Nëpunësi i regjistrimit të gjykatës së falimentimit shënon vërtetimin në kambiale dhe instrumente të tjera borxhi.

3. Për pretendimet e vërtetuara për shumën dhe rangun tyre, regjistrimi në tabelë ka efektin e një vendimi të formës së prerë për administratorin e falimentimit dhe për të gjithë kreditorët e falimentimit.

Neni 141

Pretendimet e kundërshtuara

1. Në qoftë se një pretendim është kundërshtuar nga administratori i falimentimit, nga debitori ose nga një kreditor falimentimi, kreditori duhet të fillojë procedurën për vërtetimin e këtij pretendimi ndaj palës kundërshtuese.

2. Në qoftë se një pretendim i tillë bazohet në një urdhër ekzekutimi ose vendim të formës së prerë, pala kundërshtuese duhet të kërkojë fillimin e procedurës për kundërshtimin e pretendimit.

3. Në rast se ekziston një titullekzekutiv ose një vendim i formës së prerë për një pretendim të tillë, është detyrë e debitorit për të ndjekur kundërshtimin e tij brenda një periudhe prej një muaji e cila fillon në datën e mbledhjes së verifikimit, ose, në rastin e procedurës me shkrim, në datën kur pretendimi është i diskutueshëm. Pas kalimit të periudhës, kundërshtimi konsiderohet i paparaqitur.

Neni 142

Kompetenca e gjykatave për vërtetimin e pretendimeve

1. Padia për vërtetimin e pretendimeve ngrihet sipas dispozitave të këtij ligji.
2. Në qoftë se në kohën e hapjes së procedurës së falimentimit ishte ngritur një padi për këto pretendime, kompetente për vazhdimin e gjykimit është gjykata e falimentimit.

Neni 143

Kufijtë e vërtetimit të pretendimeve

Vërtetimi i bazueshmërisë, madhësisë dhe renditjes së një pretendimi mund të bëhet deri në masën e deklaruar gjatë paraqitjes së kërkesës ose gjatë mbledhjes së verifikimit.

Neni 144

Pasojat juridike të vërtetimit me rrugë gjyqësore

Vendimi i formës së prerë që vërteton një pretendim ose që pranon një kundërshtimë të detyrues për administratorin e falimentimit dhe për të gjithë kreditorët e falimentimit dhe ndryshimet e vendosura prej tij pasqyrohen në tabelë.

KREU II. SHPËRNDARJA

Neni 145

Pagimi i kreditorëve të falimentimit

1. Pagimi i kreditorëve të falimentimit mund të fillojë vetëm pasi të ketë përfunduar procesi i verifikimit të pretendimeve të tyre.
2. Fondet mund t'u shpërndahen kreditorëve të falimentimit sapo konstatohet se masa e falimentimit ka likuiditet të mjaftueshëm.
3. Shpërndarjet bëhen nga administratori i falimentimit sipas renditjes së parashikuar në nenet Neni 48, Neni 49, dhe Neni 146 të këtij ligji. Para çdo shpërndarjeje administratori merr miratimin e gjykatës së falimentimit.

Neni 146

Shpërndarja e pasurisë sipas radhës së preferimit

Pasi përmbushen detyrimet sipas nenit Neni 50, vijon shlyerja e pretendimeve të kreditorëve sipas radhës së mëposhtme të preferimit në të gjitha rastet e likuidimit:

1. Pretendimet e siguruara deri në vlerën e pronës që shërben si garanci.
2. Pretendimet prioritare, ku përfshihen:
 - a) pretendimet e lindura nga përfundimi i marrëdhënies së punës për periudhën tre mujore përpara datës së paraqitjes së kërkesës ose datës së ndërprerjes së biznesit,

- për pagat, përfshirë lejet vjetore dhe shëndetësore, por jo më shumë se 500 mijë lekë në total;
- b) financimet e marra në formën e huasë;
 - c) pretendimet për detyrimin për ushqim të papaguar kur debitori është individ;
 - d) pretendimet e punonjësve për dëme ndaj jetës dhe shëndetit të shkaktuara gjatë punës pranë debitorit, si dhe dëmtimet të të njëjtës natyrë të personave të tretë si pasojë e veprimeve të paligjshme të debitorit;
 - e) pretendimet për taksat e papaguara për periudhën prej një viti përpara paraqitjes së kërkesës;
 - f) shpërblimi i administratorit të falimentimit;
 - g) detyrimet ndaj fondit publik të posaçëm;
 - h) shpenzimet e riorganizimit.
- 3. Pretendimet e kreditorëve të tjerë të falimentimit;
 - 4. Pretendimet e rangjeve më të ulëta, sipas nenit Neni 54 të këtij ligji;
 - 5. Pretendimet e ortakëve, aksionerëve, themeluesve, anëtarëve.

Neni 147

Përmbushja e kërkesave

- 1. Kërkesat do të përmbushen sipas klasave në mënyrë prioritare, siç përcaktohet në nenin Neni 146 të këtij ligji.
- 2. Përmbushja e kërkesave që i përkasin rangjeve me prioritet më të ulët mund të fillojë vetëm pas plotësimit të të gjitha kërkesave të rangjeve paraprake me prioritet më të lartë.
- 3. Kur burimet janë të pamjaftueshme për të plotësuar të gjitha kërkesat e rangut së caktuar, kërkesat e këtij rangu do të përmbushen në proporcion me shumën e secilës kërkesë.

Neni 148

Lista e shpërndarjes

- 1. Para çdo shpërndarjeje, administratori i falimentimit harton një listë të pretendimeve që përfitojnë nga shpërndarja sipas radhëve të preferimit të parashikuar në këtë ligj. Lista depozitohet pranë regjistratit të gjykatës së falimentimit për t'u inspektuar nga palët.
- 2. Administratori i komunikon gjykatës së falimentimit masën totale të pretendimeve dhe masën e disponueshme për shpërndarje nga masa e falimentimit. Gjykata e falimentimit publikon masën e deklaruar të pretendimeve dhe masën e disponueshme për shpërndarje.

Neni 149

Fondet e mbajtura për të ripaguar pretendimet e kundërshtuara

Një kreditor falimentimi, pretendimi i të cilit nuk është vërtetuar dhe nuk është bazuar në një titull ekzekutiv ose vendim të formës së prerë, duhet t'i provojë administratorit të falimentimit në mënyrë bindëse, jo më vonë se dy javë pas shpalljes publike, se për çfarë shume është bërë padia e vërtetimit të pretendimit ose ka vazhduar padia e ngritur më parë.

Neni 150

Fondet e mbajtura për të ripaguar kreditorët me të drejtë ripagimi të veçantë

1. Një kreditor me të drejtë ripagimi të veçantë duhet t'i provojë administratorit të falimentimit, jo më vonë se dy javë nga shpallja publike se për çfarë shume ka hequr dorë nga e drejta e ripagimit të veçantë ose për çfarë shume nuk është shlyer ripagimi i veçantë.
2. Kreditori quhet se ka përmbushur detyrimin e përmendur në pikën 1 të këtij neni për të marrë pjesën në shpërndarjen e parë, nëse ai i provon administratorit të falimentimit jo më vonë se periudha kohore e përcaktuar, që shitja e sendit që i nënshtrohet të drejtës së ripagimit të veçantë ka filluar si dhe pjesën e shumës së pretendimit të tij qëmbetet e pashlyer. Në këtë rast, pjesa që i përgjigjet pretendimit të tij mbahet gjatë shpërndarjes. Në qoftë se kushtet e pikës 1 të këtij neni nuk janë plotësuar, pjesa e rezervuar zhbllokohet në shpërndarjen përfundimtare dhe lejohet të përdoret gjatë kësaj shpërndarjeje.
3. Në qoftë se të drejtën e disponimit të sendit, që i nënshtrohet së drejtës për ripagim të veçantë e ka vetëm administratori i falimentimit, pikat 1 dhe 2 të këtij neni nuk zbatohen. Gjatë shpërndarjes së parë, administratori që nuk ka shitur ende sendin duhet të vlerësojë çfarë humbjeje ka pësuar kreditori dhe të mbajë pjesën që shërben për të shlyer këtë shumë.

Neni 151

Fondet e mbajtura për ripagimin e pretendimeve me kusht

1. Pretendimi me kusht merret parasysh në vlerën e tij të plotë gjatë shpërndarjes së parë. Pjesa që i përgjigjet pretendimit nuk paguhet gjatë shpërndarjes dhe ruhet.
2. Pretendimi me kusht nuk merret parasysh gjatë shpërndarjes së fundit nëse mundësia e plotësimit të kushtit është aq e largët sa që pretendimi humbet vlerën në kohën e shpërndarjes. Në këtë rast, pjesa e mbajtur sipas fjalisë së dytë të pikës 1 të këtij neni, paguhet gjatë shpërndarjes së fundit.

Neni 152

Ripagimi i mëvonshëm

Kreditorët, pretendimet e të cilëve nuk janë marrë parasysh gjatë një shpërndarjeje të parë dhe që plotësojnë kushtet e neneve Neni 149 dhe Neni 150 të këtij ligji, marrin nga masa e falimentimit, një shumë që i vë në kushte të barabarta me kreditorët e parë. Kjo shumë merret gjatë shpërndarjes në një datë të mëvonshme.

Neni 153

Ndryshimi i listës së shpërndarjes

Administratori i falimentimit shton në listën e shpërndarjes brenda tri ditësh nga mbarimi i afatit të përjashtimit të parashikuar në pikën 1 të nenit Neni 149 të këtij ligji, çdo ndryshim të bërë sipas neneve Neni 149 deri Neni 151 të këtij ligji.

Neni 154

Kundërshtimet ndaj listës së shpërndarjes

1. Gjatë shpërndarjes së parë, një kreditor i paraqet gjykatës së falimentimit vërejtjet e veta ndaj listës, brenda një jave pas mbarimit të afatit të parashikuar në pikën 1 të nenit Neni 149 të këtij ligji.
2. Çdo vendim i gjykatës së falimentimit që hedh poshtë këto vërejtje i dërgohet kreditorit dhe administratorit të falimentimit. Kreditori ka të drejtën e ankimit të veçantë ndaj këtij vendimi.
3. Vendimi i gjykatës së falimentimit që urdhëron një ndryshim në listë, u njoftohet kreditorit dhe administratorit dhe depozitohet në regjistrin e gjykatës për t'u inspektuar nga palët. Administratori dhe kreditorët e falimentimit kanë të drejtën e ankimit të veçantë ndaj vendimit. Afati i ankimit fillon nga data kur vendimi është depozituar në regjistrin e gjykatës së falimentimit.

Neni 155

Përcaktimi i pjesëve të pretendimit

1. Me propozimin e administratorit të falimentimit, pas konsultimit me komitetin e kreditorëve, gjykata e falimentimit përcakton pjesën e pretendimit që do të paguhet gjatë shpërndarjes së parë.
2. Administratori i falimentimit u komunikon kreditorëve se janë marrë parasysh pjesët e pretendimit që do t'u paguhen.

Neni 156

Shpërndarja e fundit

Shpërndarja e fundit bëhet me miratimin e gjykatës së falimentimit sapo të përfundojë shitja sendeve të masës së falimentimit.

Neni 157

Mbledhja përfundimtare

1. Kur jep pëlqimin për shpërndarjen përfundimtare, gjykata e falimentimit përcakton edhe afatin për një mbledhje përfundimtare të kreditorëve. Gjatë mbledhjes:
 - a) diskutohen llogaritë e paraqitura nga administratori i falimentimit;
 - b) paraqiten vërejtje ndaj listës përfundimtare.
2. Periudha kohore ndërmjet shpalljes së datës së mbledhjes dhe mbledhjes nuk mund të jetë më pak se një muaj dhe jo më shumë se dy muaj.
3. Mbi vërejtjet e një kreditori për vendimet e gjykatës së falimentimit, zbatohen njëjloj, parashikimet e pikave 2 dhe 3 të nenit Neni 154 të këtij ligji.

Neni 158

Depozitimi i shumave të mbajtura

Shumat që janë mbajtur gjatë shpërndarjes përfundimtare, me miratimin e gjykatës së falimentimit, depozitohen për llogari të palëve pjesëmarrëse.

Neni 159
Tepricat pas shpërndarjes përfundimtare

Në qoftë se pretendimet e të gjithë kreditorëve të procedurës së falimentimit mund të paguhen gjatë shpërndarjes së fundit, administratori i falimentimit ia kalon tepricën debitorit. Kur debitori nuk është person fizik, administratori ia ndan pjesën e tepricës çdo personi që mban pjesë të kapitaleve të debitorit.

Neni 160
Përfundimi i procedurës së falimentimit

1. Sapo të jetë kryer shpërndarja përfundimtare, gjykata e falimentimit vendos mbylljen e procedurës së falimentimit.
2. Vendimi dhe shkaku i mbylljes shpallen publikisht.

Neni 161
Të drejtat e kreditorëve të falimentimit pas mbylljes së procedurës së falimentimit

1. Pas mbylljes së procedurës së falimentimit, kreditorët e falimentimit mund të kërkojnë pa kufizim plotësimin e pretendimeve të mbetura ndaj debitorit.
2. Kreditorët e falimentimit, që kanë ngritur pretendime të vërtetuara, të cilat nuk janë kundërshtuar nga debitori gjatë mbledhjes së verifikimit, mund të përmbushin këto pretendime ndaj debitorit me rrugë ekzekutimi ligjor, duke u bazuar në regjistrimin në tabelë e cila ka të njëjtën vlerë si një vendim i ekzekutueshëm. Pretendimi i pakundërshtuar barazohet me një pretendim ndaj të cilit kundërshtimi nuk është pranuar.
3. Dispozitat për shkarkimin nga detyrimet e mbetura nuk cenohen.

Neni 162
Vendimi i gjykatës për shpërndarje të vonuar

1. Me kërkesë të administratorit të falimentimit ose të një kreditori të procedurës së falimentimit, gjykata e falimentimit urdhëron një shpërndarje të vonuar nëse mbas mbledhjes përfundimtare:
 - a) bëhen të mundshme për shpërndarje fonde të mbajtura;
 - b) kthehen shumat që janë paguar nga masa e falimentimit;
 - c) identifikohen, pas mbledhjes përfundimtare, sende të masës së falimentimit.
2. Mbyllja e procedurës së falimentimit nuk pengon marrjen e vendimit të gjykatës së falimentimit për kryerjen e shpërndarjes së vonuar.
3. Gjkata e falimentimit duke pasur parasysh vlerën e ulët të shumës ose të sendit dhe shpenzimet e një shpërndarjeje të vonuar, nëse e sheh të arsyeshme, mund të heqë dorë nga vendimi për shpërndarje të vonuar dhe t'i kalojë debitorit shumën e disponueshme ose sendin e identifikuar. Vendimi mund të kushtëzohet nga parapagimi i një shume të paracaktuar për mbulimin e shpenzimeve të shpërndarjes së vonuar.

Neni 163 **Ankimi**

1. Vendimi i gjykatës së falimentimit që refuzon shpërndarjen e vonuar i komunikohet palës kërkuese. Pala kërkuese mund të paraqesë ankim të veçantë ndaj këtij vendimi.
2. Vendimi i gjykatës së falimentimit që urdhëron një shpërndarje të vonuar u dorëzohet administratorit të falimentimit, debitorit dhe kreditorit që kanë bërë kërkesën për shpërndarje të vonuar. Debitori ka të drejtën e ankimit të veçantë ndaj këtij vendimi.

Neni 164 **Kryerja e shpërndarjes së vonuar**

Me dhënien e vendimit për shpërndarje të vonuar, administratori i falimentimit shpërndan shumën e vënë në dispozicion ose të ardhurat e marra nga shitja e sendit të identifikuar në bazë të listës përfundimtare. Administratori i falimentimit njofton gjykatën e falimentimit për këtë shpërndarje.

KREU III. **NDËRPRERJA E PROCEDURËS**

Neni 165 **Pezullimi për mungesë të pasurive në masën e falimentimit**

1. Nëse pas fillimit të procedurës së falimentimit rezulton se masa e falimentimit nuk mjafton për mbulimin e shpenzimeve të procedurës, gjykata e falimentimit pezullon procedurën dhe i kërkon Agjencisë Kombëtare të Falimentimit të marrë masa për mbulimin e kostove nga fondi publik i posaçëm.
2. Pezullimi nuk bëhet ose, nëse është bërë, procedura rifillon, sapo sigurohet fondi i mjaftueshëm për mbulimin e kostove nëpërmjet fondit publik të posaçëm ose financimit të palëve të interesuara.

Neni 166 **Mbyllja për shkak të zhdukjes së mëvonshme të shkakut për hapjen e procedurës së falimentimit**

Me kërkesë të debitorit, procedura e falimentimit mbyllet nëse provohet se nuk ekzistojnë më kushtet e nevojshme për hapjen e saj.

Neni 167 **Ndërprerja me miratimin e kreditorëve**

1. Procedura e falimentimit mbyllet me kërkesën e debitorit, kur ky, pasi përfundon periudha e njoftimit, paraqet një deklaratë miratimi të të gjithë kreditorëve të falimentimit, që kanë depozituar pretendime për mbylljen e kësaj procedure. Gjykata e falimentimit, sipas diskrecionit të saj, vendos për kreditorët, kërkesat e të cilëve janë kundërshtuar nga debitori ose administratori i falimentimit dhe për kreditorët me të drejtë ripagimi të veçantë, lidhur me kërkesat e miratimit të kreditorëve ose të mjeteve të sigurisë që ata duhet të paraqesin.
2. Procedura e falimentimit mund të mbyllet me kërkesën e debitorit edhe përpara mbarimit të afatit të depozitimit nëse nuk njihen kreditorë të tjerë përveç kreditorëve për të cilët debitori ka paraqitur deklaratat e miratimit prej tyre.

Neni 168

Procedura e ndërprerjes

1. Kërkesa për mbylljen e procedurës së falimentimit sipas neneve Neni 166 dhe Neni 167 të këtij ligji shpallet publikisht. Ajo depozitohet në regjistrin e gjykatës së falimentimit për inspektim të palëve. Në rastin e parashikuar në nenin Neni 170 kërkesa shoqërohet edhe nga deklarata e miratimit të kreditorëve. Brenda një jave pas shpalljes publike, kreditorët e falimentimit kanë mundësinë ta kundërshtojnë me shkrim këtë kërkesë në gjykatën e falimentimit.
2. Para se të vendosë për mbylljen e procedurës së falimentimit, gjykata e falimentimit dëgjon palën kërkuese, administratorin e falimentimit dhe komitetin e kreditorëve, nëse një i tillë është caktuar. Në rastin e kundërshtimit prej një kreditori, dëgjohej edhe kreditori kundërshtues.

Neni 169

Shpallja publikisht dhe pasojat ligjore të ndërprerjes

1. Vendimi për mbylljen e procedurës së falimentimit sipas neneve Neni 165 dhe Neni 166 të këtij ligji si dhe shkaku për mbylljen shpallen publikisht. Debitori, administratori i falimentimit dhe anëtarët e komitetit të kreditorëve njoftohen më parë për datën e hyrjes në fuqi të mbylljes.
2. Me mbylljen e procedurës së falimentimit debitori rifiton të drejtën të disponojë lirisht pasuritë e masës së falimentimit. Neni 161 i këtij ligji zbatohet njëjloj.

Neni 170

Ankimi

1. Në qoftë se procedura e falimentimit është pezulluar ose është mbyllur sipas këtij ligji, çdo kreditor falimentimi ka të drejtën e ankimit të veçantë. Debitori mund të paraqesë ankim të veçantë nëse procedura e falimentimit sipas nenit Neni 165 të këtij ligji është pezulluar.
2. Debitori ka të drejtën e ankimit të veçantë kundër vendimit të gjykatës së falimentimit, që refuzon kërkesën sipas neneve Neni 166 dhe Neni 167 të këtij ligji.

PJESA E GJASHTË
MJETET DHE PROCEDURAT PËR PARANDALIMIN E
LIKUIDIMIT. RIORGANIZIMI DHE RISTRUKTURIMI I
BORXHIT

KREU I.
RREGULLA TË PËRGJITHSHME

Neni 171
Qëllimi i parandalimit të likuidimit

1. Qëllimi i parandalimit të likuidimit është dhënia e mundësisë debitorit në gjendje vështirësie financiare për ta kapërcyer atë përmes propozimit ndaj kreditorëve të një përmes një plani riorganizimi ose marrëveshjeje jashtëgjyqësore për ristrukturimin e borxhit, të miratuar nga gjykata e falimentimit.
2. Parandalimi përmes ristrukturimit të borxhit synon mosfillimin e procedurës së falimentimit, ndërsa parandalimi përmes riorganizimit synon parandalimin e fazës për likuidimin e debitorit.
3. Përdorimi i mjeteve të parandalimit të likuidimit konsiderohet si një mundësi por jo parakusht për të kaluar në fazën e likuidimit.

Neni 172
Parandalimi përmes ristrukturimit të borxhit

Debitori në vështirësi financiare mund t'u propozojë kreditorëve një marrëveshje jashtëgjyqësore e cila përfshin mënyrën e ristrukturimit të borxhit dhe mënyrën e realizimit të pretendimeve të kreditorëve, si dhe çdo mënyrë tjetër për reduktimin e borxhit, të parashikuara nga Kodi Civil, Pjesa 4, Titulli 2, Kreu IV, lidhur me mbarimin ose shuarjen e detyrimeve.

Neni 173
Paraqitja e kërkesës për miratimin e marrëveshjes për ristrukturimin e borxhit

1. Debitori në vështirësi financiare, mund të kërkojë nga gjykata e falimentimit miratimin e marrëveshjes për ristrukturimin e borxhit, të arritur me pëlqimin e shumicës së kreditorëve sipas neneve Neni 204 dhe Neni 205 të këtij ligji.
2. Kërkesa për miratimin e marrëveshjes për ristrukturimin e borxhit bëhet pasi është arritur marrëveshja jashtëgjyqësisht. Kërkesa shoqërohet nga:
 - a) marrëveshja për ristrukturimin e borxhit, që përmban përshkrimin e metodave analitike dhe afatet e përmbushjes së detyrimeve;
 - b) një raport i përditësuar mbi gjendjen financiare dhe ekonomike të debitorit;

- c) një analizë mbi vlerësimin e asetëve dhe listën emërore të kreditorëve, me pretendimet të tyre përkatëse, si dhe evidentimin e kreditorëve me të drejtë parablerjeje;
 - d) lista e mbajtësve të të drejtave mbi pronat e paluajtshme ose të luajtshme në pronësi ose në posedim të debitorit;
 - e) vlera e aktiveve dhe kreditorët e çdo ortaku me përgjegjësi të pakufizuar;
 - f) pasqyrat financiare për tri vitet e fundit;
 - g) një relacion të përgatitur nga administratori i falimentimit ose nga një ekspert i cili ka përvojën e nevojshme dhe plotëson kriteret e parashikuara sipas nenit Neni 55 të këtij ligji, i cili garanton vërtetësinë e të dhënave dhe të gjendjes financiare të debitorit, mungesën e dyshimeve që lidhen me mashtrim ose abuzim në falimentim, si dhe mundësinë e zbatueshmërisë së marrëveshjes për të siguruar shlyerjen e plotë ndaj të gjithë kreditorëve.
3. Kërkesa për miratimin e marrëveshjes i komunikohet prokurorit dhe publikohet nga debitori, në regjistrin tregtar pas depozitimit në gjykatën e falimentimit.

Neni 174

Publikimi i marrëveshjes së rristurimit

1. Marrëveshja për rristurimin e borxhit publikohet nga gjykata e falimentimit në regjistrin tregtar.
2. Kreditorët kanë të drejtë që brenda 30 ditëve të kundërshtojë marrëveshjen e rristurimit të borxhit.

Neni 175

Pezullimi i veprimeve për shkak të marrëveshjes së rristurimit

1. Debitori, i cili ka arritur një marrëveshje për rristurimin e borxhit, ka të drejtë t'i kërkojë gjykatës së falimentimit pezullimin e veprimeve për ekzekutimin e detyrueshëm mbi pasurinë e debitorit, ose që të realizohen të drejta parablerjeje mbi këtë pasuri.
2. Kërkesa për pezullim duhet të shoqërohet me marrëveshjen e rristurimit, dhe me:
 - a) dokumentacionin e nevojshëm të parashikuar në pikën 2 shkronjat d), f) të nenit Neni 173 të këtij ligji;
 - b) një vetëdeklarim të debitorit ku të parashikohet shprehimisht se për propozimin në fjalë janë në vazhdim negociatat me kreditorët, si dhe
 - c) një deklarim të administratorit të falimentimit ose nga një ekspert i cili ka përvojën e nevojshme dhe plotëson kriteret e parashikuara sipas nenit Neni 55 të këtij ligji mbi ekzistencën e propozimit për marrëveshje për rristurimin e borxhit e cila synon realizimin e pagimit të të gjithë kreditorëve, si të atyre që janë duke zhvilluar negociime, edhe të atyre që kanë mohuar gatishmërinë për të negociuar.
3. Kërkesa për pezullim e parashikuar në pikën 2 të këtij neni, e depozituar në gjykatën e falimentimit, publikohet në regjistrin tregtar dhe gjykohet jo më vonë se 15 ditë nga depozitimi i kërkesës për pezullim. Vendimi i gjykatës së falimentimit për pezullim ka efekt deri në vendimin përfundimtar për miratimin ose refuzimin e marrëveshjes së rristurimit. Kundër vendimit të gjykatës së falimentimit për pezullimin lejohet ankimi i veçantë.

Neni 176

Vendimi i gjykatë së falimentimit lidhur me Marrëveshjene Ristrukturimit të Borxhit

1. Gjykata e falimentimit, pasi shqyrton kundërshtimet e mundshme të kreditorëve ose personave të interesuar lidhur me marrëveshjen, me vendim të arsyetuar, miraton ose refuzon marrëveshjen për rristurimin e borxhit jo më vonë se 60 ditë nga depozitimi i kërkesës.
2. Kundër vendimit të gjykatës së falimentimit mund të bëhet ankim në gjykatën e apelit.

KREU II.

PLANI I RIORGANIZIMIT

Neni 177

Parandalimi përmes riorganizimit

1. Debitori i cili është në gjendje vështirësie financiare mund t'u propozojë kreditorëve një marrëveshje të bazuar në një plan riorganizimi i cili ka për qëllim:
 - a) realizimin e pretendimeve të kreditorëve nëpërmjet çdo forme, përfshirë shitjen e pasurive, marrjen përsipër të detyrimeve të debitorit nga të tretët, ose marrëveshjet e tjera atipike ose të jashtëzakonshme, përfshirë këtu anulimin ose modifikimin e ndonjë kontrate të mëparshme, shtyrjen e një date maturimi ose ndryshimin e ndonjë norme interesi, transferimin nga kreditorët të aksioneve, kuotave ose obligacioneve, të konvertueshme ose jo në aksione, ose të instrumenteve të tjera financiare dhe titujve të borxhit;
 - b) transferimin e aktiviteteve të subjekteve që janë të interesuara për planin e propozuar. Si pranues mund të konsiderohen edhe kreditorët ose shoqëria, të cilët bëhen pjesë e procedurës dhe, të drejtat ose aksionet e tyre janë të destinuara që t'i transferohen kreditorëve për shkak të marrëveshjes;
 - c) nënndarjen e kreditorëve në klasa sipas statusit ligjor dhe interesave të tyre ekonomikë;
 - d) trajtimin e ndryshëm midis kreditorëve që i përkasin klasave të ndryshme;
 - e) përcaktimin e klasave të pretendimeve që nuk dëmtohen sipas planit, si dhe
 - f) specifikimin e trajtimit të çdo klase të pretendimeve.
2. Propozimi mund të parashikojë që kreditorët me të drejtë ripagimi të veçantë që gëzojnë të drejtën e preferimit, të mos shlyhen në mënyrë të plotë, nëse plani e parashikon realizimin e pretendimeve të tyre në një masë jo më të vogël se sa ajo që është e realizueshme, për shkak të vendosjes preferenciale, mbi të ardhurat në rast likuidimi, duke pasur parasysh vlerën e aseteve dhe të drejtave sipas tregut mbi të cilat rezulton shkaku i preferimit të deklaruar në raportin e ekspertit.

Neni 178

Paraqitja e planit të riorganizimit

1. Të drejtën për paraqitjen e një plani riorganizimi përpara gjykatës së falimentimit e kanë administratori i falimentimit dhe debitori.

2. Në qoftë se mbledhja e kreditorëve i ka ngarkuar administratorit të falimentimit hartimin e planit të riorganizimi, administratori ia paraqet këtëplangjykatës së falimentimit brenda një afati kohor të arsyeshëm. Gjatë hartimit të planit nga administratori i falimentimit, mund të paraqiten rekomandime e këshilla nga kreditorët dhe debitori.
3. Paraqitja e këtij plani nga debitori mund t'i bashkohet kërkesës për fillimin e procedurës së falimentimit.
4. Planin nuk merret parasysh nëse paraqitet në gjykatën e falimentimit pas mbledhjes përfundimtare të kreditorëve.

Neni 179 **Përmbajtja e planit**

Planin i riorganizimit përbëhet nga pjesa paraqitëse, dhe pjesa e analizës ku plani arsyetohet më hollësisht. Këtyre u shtohen edhe shtojcat e përmendura në nenet Neni 190 dhe Neni 192 të këtij ligji.

Neni 180 **Pjesa paraqitëse**

Në pjesën paraqitëse të planit të riorganizimit përshkruhen masat e marra pas fillimit të procedurës së falimentimit, me qëllim vlerësimin e mundësive të tjetërsimit të të drejtave të palëve të përfshira. Pjesa paraqitëse e planit përmban të gjitha të dhënat e tjera si dhe pasojat e planit, që ndikojnë nëvendimin e palëve të përfshira për pranimin etij, si dhe për miratimin e planit nga gjykata e falimentimit.

Neni 181 **Pjesa arsyetuese**

1. Në pjesën arsyetuese të planit të riorganizimit përcaktohet mënyra e tjetërsimit të të drejtave të palëve të përfshira.
2. Sipas planit, administratori i falimentimit, mund të autorizohet të marrë masat e nevojshme me qëllim zbatimin e planit dhe korrigjimin e çdo gabimi material të tij.

Neni 182 **Krijimi i grupeve**

1. Gjatë përcaktimit të të drejtave të pjesëmarrësve në planin e riorganizimit formohen grupe kreditorësh me të drejta dhe interesa të ekonomike tëndryshëm. Kreditorët me të drejta dhe interesa ekonomike të njëjtë formojnë të njëjtin rang. Nëplan bëhet dallimi ndërmjet rangjeve,të tilla si ato të:
 - a) kreditorëve me të drejtë ripagimi të veçantë, nëse të drejtat e tyre preken nga plani;
 - b) kreditorëve të falimentimit;
 - c) kreditorëve të rangjeve më të ulëta, përveç rastit kur pretendimet e tyre nuk merren parasysh sipas këtij ligji.
 - d) pjesëmarrësve në kapital të debitorit, nëse të drejtat e tyre përfshihen në plan.
2. Brenda një rangui, palët me të drejta të barabarta mund të formojnë grupe, të cilat përveç interesave ekonomike të njëjtë bashkohen me njëri tjetrin edhe sipas kriterëve të specifikuar nga vet plani.

3. Punonjësit mund të formojnë një grup të veçantë nëse ata pretendojnë një sasi të konsiderueshme si kreditorë të falimentimit.

Neni 183

Trajtimi i barabartë i pjesëtarëve brenda grupit

1. Të gjitha palët brenda të njëjtit grupi, kanë të drejta të barabarta.
2. Trajtimi i ndryshëm i pjesëtarëve të një grupi lejohet vetëm me miratimin e të gjithë pjesëtarëve. Në këtë rast, plani i riorganizimit shoqërohet edhe me deklaratën miratuese të secilës prej palëve.
3. Çdo marrëveshje e arritur midis administratorit të falimentimit, debitorit ose personave të tjerë dhe pjesëtarëve të veçantë, e cila parashikon përfitime të paparashikuara në plan për shkak të pranisë së këtyre palëve në votim, ose në përgjithësi, në lidhje me procedurën e falimentimit, është e pavlefshme.

Neni 184

Të drejtat e kreditorëve me të drejtë ripagimi të veçantë

1. Planin nuk cenon të drejtën e kreditorëve me të drejtë ripagimi të veçantë, pa miratimin e tyre. Çdo përjashtim nga ky rregull respekton sigurinë financiare sipas ligjit për bankat.
2. Nëse në plan vendoset një rregullim i ndryshëm për kreditorët me të drejtë ripagimi të veçantë, pjesa analizuese e planit tregon masën në të cilën pakësohen pretendimet e tyre si dhe paraqet me hollësi periudhën e shtyrjes së pretendimeve ose parashikon rregullime të tjera, të cilave u nënshtrohen këta kreditorë. Ulja e pretendimeve të kreditorëve, në çdo rast, nuk duhet të jetë më e vogël se sa ajo që mund realizohet, në rast likuidimi.

Neni 185

Të drejtat e kreditorëve të falimentimit

1. Pjesa arsyetuese e planit të riorganizimit tregon sasinë në të cilën është zvogëluar pretendimi i kreditorëve të falimentimit, hollësitë e periudhës për shtyrjen e pretendimeve, mjetet e sigurimit për to ose parashikon rregullime të tjera, të cilave duhet t'u nënshtrohen këta kreditorë.
2. Për kreditorët e rangjeve jo të ulëta pjesa arsyetuese e planit të riorganizimit tregon sasinë me të cilën do të ulët pretendimi i tyre, përcakton periudhën e shtyrjes së pretendimeve të tyre, shpall mënyrën e sigurimit të shlyerjes së tyre ose parashikon çdo lloj rregullimi tjetër subjekt i të cilit ata janë.

Neni 186

Të drejtat e kreditorëve të rangjeve më të ulëta

1. Nëse në planin e riorganizimit nuk përcaktohet ndryshe, pretendimet e kreditorëve të rangjeve më të ulëta vlerësohen si të përjashtuara.
2. Nëse plani i riorganizimit vendos ndryshe, për pretendimet e çdo grupi të kreditorëve të rangjeve më të ulëta, në pjesën arsyetuese jepen të dhënat e përshkruara në nenin Neni 185 të këtij ligji.
3. Planin i riorganizimit nuk përjashton dhe as kufizon përgjegjësinë e debitorit për pagesat e penaliteteve ose gjobave me natyrë administrative, civile dhe penale, sipas shkronjës “b” të

pikës 1 të nenit Neni 54 të këtij ligji, të cilat shtrihen edhe pas përfundimit të procedurës së falimentimit.

Neni 187

Të drejtat e ortakëve ose aksionerëve

1. Të drejtat e anëtarësimit si dhe të ortakëve ose aksionerëve që pretendohen mbi debitorin nuk ndikohen nga plani i riorganizimit, me përjashtim kur vetë plani parashikon ndryshe.
2. Pjesa e planit që përcakton masat që ndërmerren mund të përfshijë edhe parashikime ku pretendimi i kreditorit mund të konvertohet në anëtarësi ose të drejta mbi aksionet/kuotat e debitorit. Planin mund të parashikojë zmadhim ose zvogëlim të kapitalit, kontribute në natyrë, përjashtime nga të drejtat e parablerjes ose pagesën e rënë dakord me marrëveshje për shkak të tërheqjes së anëtarit, ortakut, aksionerit.
3. Planin mund të parashikojë çdo marrëveshje që lejohet nga ligjislacioni tregtar, në mënyrë të veçantë ato që lidhen me vazhdimësinë e detyrimeve ose përcaktimin e të drejtave dhe përgjegjësisë të anëtarëve, ortakëve dhe aksionerëve, pas prishjes së shoqërisë.

Neni 188

Përgjegjësia e debitorit

1. Nëse në planin e riorganizimit nuk është përcaktuar ndryshe, debitori shkarkohet nga detyrimet e mbetura ndaj kreditorëve të falimentimit, pasi këta kreditorë janë shlyer në mënyrën e parashikuar në pjesën arsyetuese të planit.
2. Kur debitor është një shoqëri e thjeshtë, kolektive ose komandite, pika 1 e këtij neni zbatohet edhe për anëtarët e shoqërisë së thjeshtë, anëtarët e shoqërisë kolektive dhe ortakët e pakufizuar të shoqërisë komandite.

Neni 189

Veprimet lidhur me të drejtat mbi pasuritë e paluajtshme

Nëse në pjesën arsyetuese të planit të riorganizimit, krijohen, ndryshohen, transferohen ose anulohen të drejta mbi sende të paluajtshme, në këto raste, respektohen detyrimet e përcaktuara në legjislacionin e posaçëm.

Neni 190

Administrimi dhe mbikëqyrja e pasurisë. Të ardhurat dhe plani financiar

Në qoftë se kreditorët ripaguhën nga të ardhurat e një veprimtarie, e cila vazhdon të funksionojë nën drejtimin e debitorit ose të një të treti, planin të riorganizimit i bashkëngjitet inventari i pasurive dhe i detyrime të vetë debitorit. Gjithashtu, plani tregon shpenzimet dhe të ardhurat e pritshme për periudhën gjatë së cilës duhet të ripaguhën kreditorët dhe renditjen e shpenzimeve dhe fitimeve me të cilat funksionon veprimtaria gjatë kësaj kohe. Kreditorët të cilët ende nuk kanë regjistruar pretendimet e tyre, do të merren në konsideratë vetëm nëse ata

dhe pretendimet e tyre janë bërë të njohura në momentin kur hartohet plani.

Neni 191

Veprimet që kërkojnë pëlqim

Pjesa arsyetuese e planit të riorganizimit mund të parashikojë që veprimet e debitorit ose të shoqërisë së bashkuar të jenë të vlefshme kur jepet pëlqimi i administratorit mbikëqyrës. Pika 1 e nenit Neni 78 dhe Neni 79 të këtij ligji zbatohen në mënyrë të njëjtë.

Neni 192

Deklaratat shoqëruese të planit

1. Në qoftë se në planin e riorganizimit është parashikuar që debitori, i cili është person fizik, të vazhdojë mbajtjen e veprimtarisë, planit i bashkëlidhet deklarata e gatishmërisë së debitorit për vazhdimin e mbajtjes së veprimtarisë mbi bazën e planit. Kjo deklaratë e debitorit nuk është e nevojshme kur planin e ka parashtruar vetë debitori. Kur debitori është shoqëri e thjeshtë, kolektive ose komandite, planit i bashkëlidhet një deklaratë e ngjashme nga personat, të cilët, sipas planit, janë ortakë të pakufizuar ose anëtarë me përgjegjësi personale në shoqëri.
2. Në qoftë se kreditorët parashikojnë të përfitojnë pjesë ose aksione, të drejta anëtarësimi ose të drejta të tjera në një shoqëri tregtare, në një organizatë jofitimprurëse ose shoqëri të thjeshtë, planit i bashkëlidhet deklarata miratuese e secilit prej këtyre kreditorëve.
3. Në qoftë se një palë e tretë ka marrë përsipër detyrime ndaj kreditorëve në rastin kur plani është miratuar, planit i bashkëlidhet edhe kjo deklaratë.

Neni 193

Dorëzimi i planit

Plani i riorganizimit dorëzohet në gjykatën e falimentimit dhe kjo e fundit dërgon një kopje të tij pranë Agjencisë Kombëtare të Falimentimit.

Neni 194

Mospranimi i planit

1. Gjykata e falimentimit vendos kryesisht për mospranimin e planit të riorganizimit në rastet kur:
 - a) nuk janë respektuar dispozitat që rregullojnë të drejtën për paraqitjen e planit dhe të përmbajtjes së tij, në veçanti ato që lidhen me formimin e grupeve, dhe kërkuar nuk është në gjendje të korrigjojë gabimin ose nuk e korrigjon atë brenda një afati të arsyeshëm, të caktuar nga gjykata e falimentimit;
 - b) nuk ka mundësi që plani i riorganizimit i parashtruar nga debitori të pranohet nga palët ose të miratohet nga gjykata e falimentimit;
 - c) nëse pretendimet e paraqitura nga debitori për palët në pjesën arsyetuese të planit nuk plotësojnë në mënyrë të dukshme interesat e tyre.
2. Gjykata e falimentimit duhet të marrë një vendim brenda dy javëve nga paraqitja e planit.
3. Kur debitori ka paraqitur në procedurën e falimentimit një plan i cili nuk është pranuar nga palët pjesëmarrëse, nuk është miratuar nga gjykata e falimentimit ose është tërhequr nga

vetë debitori pas shpalljes publikisht të datës së mbledhjes për diskutim, gjykata e falimentimit nuk e pranon planin e ri të debitorit kur këtë mospranim e kërkon administratori i falimentimit i cili ka marrë miratimin e komitetit të kreditorëve, nëse është caktuar një i tillë.

4. Kundër vendimit të mospranimit të planit të riorganizimit, paraqitësi i tij ka të drejtën e ankimit të veçantë.

Neni 195

Komente për planin

1. Kur plani i riorganizimit nuk refuzohet, gjykata e falimentimit ia kalon atë për mendim dhe komente:

- a) komitetit të kreditorëve, si dhe organit të përfaqësimit të punonjësve, nëse ka të tillë;
- b) debitorit, nëse planin e ka paraqitur administratori i falimentimit;
- c) administratorit të falimentimit, nëse planin e ka paraqitur debitori.

2. Gjkata e falimentimit cakton një afat jo më shumë se një javë për dorëzimin e komenteve.

Neni 196

Pezullimi i disponimit dhe shpërndarjes

Derisa vazhdimi i disponimit dhe shpërndarjes së pasurisë të masës së falimentimit pengon zbatimin e planit të paraqitur të riorganizimit, gjykata e falimentimit, me kërkesë të debitorit ose të administratorit të falimentimit, urdhëron pezullimin e disponimit dhe të shpërndarjes. Gjkata e falimentimit anulon ose ndalon pezullimin, nëse pezullimi sjell rrezik për dëme të ndjeshme për masën e falimentimitose kur administratori, me miratimin e komitetit të kreditorëve ose mbledhjes së kreditorëve, kërkon vazhdimin e disponimit dhe të shpërndarjes.

KREU II.

PRANIMI DHE MIRATIMI I PLANIT TË RIORGANIZIMIT

Neni 197

Mbledhja për diskutimin dhe mbledhja për votimin e planit

1. Gjkata e falimentimit cakton një afat për mbledhjen e diskutimit të planit të riorganizimit dhe të drejtës së votës së palëve për votimin e tij. Kjo mbledhje caktohet jo më vonë se 30 ditë nga paraqitja e planit dhe mund të lihet në të njëjtën ditë me atë të caktuar për marrjen e komenteve dhe mendimeve sipas nenit Neni 195 të këtij ligji.

2. Data e mbledhjes së diskutimit dhe votimit shpallen publikisht nga gjykata e falimentimit. Publikimi tregon planin dhe çdo koment të dhënë për vlerësimin e tij.

3. Kreditorët e falimentimit që kanë paraqitur pretendime, kreditorët me të drejtë ripagimi të veçantë, administratori i falimentimit, debitori dhe organi i përfaqësimit të punonjësve, nëse ka një të tillë, njoftohen individualisht. Bashkë me ftesën dërgohet edhe një kopje e planit ose një përmbledhje e tij. Nëse në plan përfshihen të drejtat e anëtarëve, ortakëve, aksionerëve që kanë pretendime tek debitori, njoftimi i tyre bëhet individualisht. Ky rregull nuk zbatohet për ortakët ose aksionerët e subjekteve tregtare me përgjegjësi të kufizuar.

Neni 198
Mbledhja e veçantë për votim

1. Gjykata e falimentimit mund të caktojë një mbledhje të veçantë për votimin e planit të riorganizimit. Në këtë rast, perioda kohore ndërmjet mbledhjes për diskutimin e planit dhe mbledhjes për votimin e tij nuk duhet të jetë më shumë se 10 ditë.
2. E drejta e votimit mund të ushtrohet edhe përmes përfaqësimit.
3. Në mbledhjen për votimin e planit thirren palët me të drejtë vote dhe debitori. Kjo nuk aplikohet për ortakët ose aksionerët në të gjitha llojet e subjekteve tregtare me përgjegjësi të kufizuar, për të cilët është e mjaftueshme të publikohet data e caktuar. Në rast se plani ndryshohet, ndryshimi duhet të evidentohet dukshëm.

Neni 199
Përputhja e datës së mbledhjes për diskutimin e planit me atë të mbledhjes për verifikimin e pretendimeve

1. Mbledhja për diskutimin e planit dhe votimin e tij nuk duhet të mbahet përpara mbledhjes për verifikimin e pretendimeve të kreditorëve sipas këtij ligji.
2. Të dy mbledhjet mund të mbahen në të njëjtën ditë.

Neni 200
E drejta e votës së kreditorëve të falimentimit

1. Lidhur me të drejtën e votimit të kreditorëve të falimentimit për planin e riorganizimit, zbatohen rregullimet e parashikuara në nenin Neni 74 të këtij ligji. Kreditorët me të drejtë ripagimi të veçantë mund të votojnë si kreditorë falimentimi vetëm nëse debitori ka përgjegjësi personale ndaj tyre dhe nëse heqin dorë nga ripagimi i veçantë ose kur nuk i kanë realizuar interesat e tyre sipas kësaj të drejte. Përsa kohë mosrealizimi i interesave të tyre nuk është përcaktuar, administratori i falimentimit përcakton vlerën e mundshme të tyre dhe këto merren parasysh për t'u shlyer.
2. Kreditorët, pretendimet e të cilëve nuk dëmtohen nga plani, nuk kanë të drejtë vote.

Neni 201
Lista e votimit

Administratori i falimentimit shënon në një listë kreditorët që rezultojnë me të drejtë vote pas përfundimit të mbledhjes për diskutimin e planit të cilën ia komunikon gjykatës së falimentimit.

Neni 202
Ndryshimi i planit

Pala kërkuese ka të drejtë të ndryshojë përmbajtjen e dispozitave të veçanta të planit të riorganizimit në përputhje me përfundimet e mbledhjes së diskutimit të planit. Për planin e ndryshuar mund të votohet në të njëjtën mbledhje, nëse ndryshimet e propozuara e lejojnë atë, ose në një mbledhje tjetër.

Neni 203

Votimi në grupe

Secili grup, sipas palëve me të drejtë vote, voton veçmas për planin e riorganizimit.

Neni 204

Shumica e nevojshme

1. Pranimi i planit të riorganizimit nga kreditorët kërkon që në çdo grup:
 - a) shumica e kreditorëve me të drejtë vote, të votojnë pro planit;
 - b) shumica e pretendimeve të kreditorëve pro planit, të jetë më shumë se gjysma e shumës së pretendimeve të kreditorëve me të drejtë vote.
2. Kreditorët që gëzojnë një të drejtë bashkërisht ose të drejtat e të cilëve përbëjnë një të drejtë të përbashkët deri në shfaqjen e arsyes për hapjen e procedurës së falimentimit, gjatë votimit, për efekt vote, llogariten si një kreditor. I njëjti rregull vlen nëse mbi një të drejtë ekziston një e drejtë pengu ose uzufrukti.
3. Për personat që zotërojnë aksione të debitorit, zbatohen njëllot pikat 1 dhe 2 të këtij neni, përveç rastit kur shumatat totale të pjesëve që zotërojnë, zëvendësojnë shumën totale të pretendimeve.

Neni 205

Ndalimi i bllokimit

1. Nëse nuk arrihen shumicat e kërkuara, një grup votuesish vlerësohen se kanë dhënë miratimin nëse:
 - a) anëtarët e këtij grupi kanë mundësi që të mos dëmtohen nga plani, krahasuar me gjendjen e tyre sikur plani të mos ekzistonte;
 - b) anëtarët e këtij grupi përfitojnë pjesë në masë të arsyeshme në vlerën ekonomike që do të shkojë palëve në bazë të planit;
 - c) shumica e grupeve votuese kanë votuar pro planit me shumicën e nevojshme.
2. Sipas planit ka pjesëmarrje të arsyeshme të kreditorëve të një grupi në kuptimin e shkronjës (b) të pikës 1 të këtij neni kur:
 - a) asnjë kreditor tjetër nuk përfiton vlerë ekonomike që tejkalon shumën e plotë të pretendimit të tij;
 - b) asnjë kreditor me pretendim të rangut të ulët me ripagim pa plan krahasuar me kreditorët që formojnë grupin e tij, as debitori ose personi që mban kuotat/aksionet e debitorit, nuk përfitojnë vlerë ekonomike;
 - c) asnjë kreditor, i cili në mungesë të planit do të ripaguhej si pjesëtar i një rangut të njëjtë me kreditorët e grupit, nuk ka përfitim më të madh sesa kreditorët e të njëjtë grup.
3. Aksionerët të cilët formojnë një grup sipas qëllimit të shkronjës (b) të pikës 1 të këtij neni, do të konsiderohen për të marrë pjesë në mënyrë të arsyeshme nëse sipas planit:
 - a) asnjë kreditor, nuk do të marrë vlerë ekonomike që tejkalon masën e plotë të pretendimit të tij, dhe
 - b) asnjë ortak/aksioner nuk do të marrë epërsi krahasuar me ortakët/aksionerët e grupit të tij, nëse nuk parashikohet ndryshe në plan.

Neni 206
Miratimi i ortakëve/aksionereve

Nëse asnjëri nga anëtarët e grupit të ortakëve, aksionerëve nuk merr pjesë në votim, miratimi i grupit konsiderohet i dhënë.

Neni 207
Miratimi i debitorit

1. Miratimi i debitorit për planin vlerësohet i dhënë nëse ai nuk e kundërshton atë me shkrim, jo më vonë se datat e mbledhjes për votim.
2. Kundërshtimi sipas pikës 1 të këtij neni quhet i pavlefshëm nëse:
 - a) debitori, nëpërmjet planit, nuk krijon një gjendje më të keqe se sikur të mos kishte një plan;
 - b) asnjë kreditor nuk përfiton një vlerë ekonomike më të lartë sesa vlera e plotë e pretendimit të tij.

Neni 208
Miratimi i planit nga gjykata e falimentimit

1. Pas pranimit të planit të riorganizimit prej palëve dhe pasi debitori jep pëlqimin, plani duhet miratuar nga gjykata e falimentimit.
2. Përpara marrjes së vendimit për miratimin e planit, gjykata e falimentimit dëgjon administratorin e falimentimit, komitetin e kreditorëve, nëse ka një të tillë, dhe debitorin.

Neni 209
Pasojat e shkeljes së dispozitave procedurale

Gjykata e falimentimit, kryesisht, refuzon miratimin e planit nëse:

- a) nuk janë marrë parasysh dispozitat për përmbajtjen dhe aspektet procedurale të planit të riorganizimit, si dhe pranimi nga palët dhe miratimi nga debitori për një çështje thelbësore, si dhe kur e meta e planit nuk mund të korrigjohet;
- b) pranimi i planit është bërë me mjete të papërshtatshme, duke sjellë përfitim për një palë të caktuar.

Neni 210
Mbrojtja e pakicave

1. Me kërkesë të një kreditori ose të një personi që mban kuota/aksione të debitorit nëse debitori nuk është një individ, miratimi i planit nuk pranohet nga gjykata e falimentimit nëse:
 - a) për palën kërkuuese shkaktohet një gjendje më e keqe se sa po të mos kishte plan dhe
 - b) pala kërkuuese ka kundërshtuar planin me shkrim brenda datës së mbledhjes për votim;
2. Kërkesa pranohet vetëm nëse pala kërkuuese i provon gjykatës, të paktën deri në mbledhjen e votimit, që plani krijon disavantazh për të.
3. Kërkesa refuzohet nëse, në seksionin e planit ku shpjegohen masat që do të ndërmerren, parashikohen fonde të cilat do të përdoren në rastet kur një palë dëshmon që ndodhet në një

pozicion jo të favorshëm. Kompensimi ose jo i palëve nga këto фонде, vendoset jashtë procedurave të falimentimit.

Neni 211

Shpallja e vendimit

1. Vendimi me anë të të cilit miratohet ose refuzohet plani i riorganizimit, shpallet në mbledhjen për votim ose në një mbledhje të veçantë, që duhet të caktohet në afatin më të afërt.
2. Kur plani miratohet, një kopje e planitose një përmbledhje thelbësore e tij u dërgohet kreditorëve që kanë depozituar pretendime dhe kreditorëve me të drejtë ripagimi të veçantë, duke vënë në dukje faktin e miratimit. Nëse të drejtat e anëtarësisë ose të ortakërisë/aksioneve të personit që mban anëtarësinë/kuotat/aksionet e debitorit, janë përfshirë në plan, dokumentet si më sipër i dërgohen edhe këtij të fundit. Ky rregull nuk zbatohet për mbajtësit e kuotave në shoqëritë e thjeshta.

Neni 212

Ankimi

1. Kreditorët dhe debitori, nëse ky i fundit nuk është individ, mund të paraqesin ankim kundër vendimit që miraton ose refuzon planin.
2. Kundër vendimit që miraton planin, mund të bëhet ankim vetëm nëse ankuesi:
 - a) ka kundërshtuar me shkrim planin të paktën në mbledhjen e votimit;
 - b) ka votuar kundër planit;
 - c) provon para gjykatës së falimentimit që është në një pozicion më pak të favorshëm sesa në rastin pa plan, dhe ky disavantazh nuk mund të baraspeshohet me një pagesë nga fondet e specifikuara në pikën e tretë të nenit Neni 210 të këtij ligji.
3. Ankimi kundra vendimit të miratimit të planit, pezullon ekzekutimin e planit.

KREU IV.

PASOJAT E PLANIT TË MIRATUAR. MBIKQYRJA E PËRMBUSHJES SË PLANIT

Neni 213

Pasojat e përgjithshme të planit

1. Sapo vendimi i gjykatës së falimentimit që miraton planin e riorganizimit merr formë të prerë, pjesa e analizës së tij është e vlefshme dhe sjell pasoja mbi të gjithëpalët dhe personat e interesuar.
2. Planin nuk cenon të drejtat e kreditorëve të falimentimit kundrejt bashkë-debitorëve ose garantëve të debitorit, si dhe të drejtat e këtyre kreditorëve mbi sende që nuk i përkasin masës së falimentimit ose që burojnë nga një njoftim përparësie në radhën e pagesës për këto sende. Megjithatë, nëpërmjet planit, debitori shkarkohet kundrejt bashkë-debitorëve, garantëve ose palëve të tjera që kanë pretendime ndaj tij në të njëjtën mënyrë siç shkarkohet kundrejt kreditorëve të falimentimit.

3. Nëse pretendimet e kreditorëve konvertohen në të drejta anëtarësimi/ortakërie/aksionesh ndaj debitorit, pasi plani të jetë miratuar, debitori nuk mund të kundërshtojë pretendimet e këtyre kreditorëve si rrjedhojë e mbivlerësimit të pretendimeve në plan.

Neni 214

Të drejtat mbi sendet e luajtshme

1. Nëse në planin e riorganizimit krijohen, ndryshohen, vendosen ose hiqet dorë nga të drejtat mbi sendet e luajtshme, ose nëse transferohen kuotat/aksionet e subjekteve me përgjegjësi të kufizuar, shfaqja e vullnetit të palëve për sa më sipër, konsiderohet se është kryer në formën e kërkuar nga ligji.

2. Nëse të drejtat e anëtarësimit/kuotave/aksioneve të një personi mbi debitorin përfshihen në plan, çdo marrëveshje e bërë nga ortakët/aksionerët dhe çdo shfaqje vullneti nga palët e përfshira në plan, konsiderohet se është kryer në formën e kërkuar nga ligji. Çdo ftesë, lajmërim dhe masë tjetër e kërkuar sipas ligjit mbi tregtarët dhe shoqëritë tregtare, konsiderohet e kryer në mënyrën e kërkuar. Administratori i falimentimit ka përgjegjësinë të depozitojë në regjistrin tregtar aktet e mësipërme.

Neni 215

Pretendimet e kundërshtueshme dhe pretendimet me zëvendësim

1. Nëse një pretendim është kundërshtuar në mbledhjen e verifikimit ose shuma e pretendimit zëvendësues të ngritur nga kreditori i falimentimit me të drejtë ripagimi të veçantë nuk është verifikuar ende, atëherë nuk vërtetohet rasti i mospërmbushjes së detyrimit në zbatim të planit të riorganizimit, me kusht që debitori të marrë parasysh pretendimin derisa të bëhet verifikimi i shumës së kërkuar në masën që i përgjigjet vendimit të gjykatës së falimentimit mbi të drejtën e votës së këtij kreditori për votimin e planit. Në qoftë se gjykata e falimentimit nuk merr vendim për të drejtën e votimit, me kërkesë të debitorit ose të kreditorit, ajo merr një vendim të mëvonshëm për shumën e pretendimit që debitori duhet të marrë parasysh në periudhën e kushteve të përkohshme.

2. Në qoftë se verifikimi përfundimtar tregon se debitori ka paguar në mënyrë të pamjaftueshme, atëherë paguhet shuma e prapambetur. Quhet mospërmbushje e zbatimit të planit në masë të ndjeshme vetëm rasti kur debitori nuk paguan shumën e prapambetur, megjithëse kreditori ka njoftuar me shkrim dhe i ka lejuar një afat prej jo më pak se dy javë.

3. Në qoftë se përcaktimi përfundimtar tregon se debitori ka mbi-paguar, ai mund të kërkojë kthimin e shumës së mbi-paguar vetëm për sasinë që tejkalon shumën e pamaturuar të pretendimit të kreditorit sipas planit.

Neni 216

Zbatimet e planit

1. Kreditorët e falimentimit, pretendimet e të cilëve janë verifikuar dhe janë të pakundërshtuara nga debitori, mund të kërkojnë ekzekutimin e pretendimeve ndaj debitorit në mbledhjen e verifikimit në të njëjtën mënyrë sikur të ishte një vendim i formës së prerë, në bazë të planit të miratuar të riorganizimit. Pretendimi i pakundërshtuar barazohet me një pretendim të cilit i është hedhur poshtë kundërshtimi i ngritur.

2. Rregulli i pikës 1 të këtij neni vlen edhe për ekzekutimin e detyrueshëm të debitorit ndaj një të tretii cili garanton përmbushjen e detyrimeve sipas planit me anë të një deklarate me shkrim dorëzuar gjykatës së falimentimit, pa rezervën e kundërshtimit.
3. Në qoftë se një kreditor pretendon të drejtën që i takon në rastin e moszbatimit të planit të riorganizimit nga debitori në një masë të ndjeshme, kreditori, për të përdorur klauzolën e ekzekutimit për këto të drejta dhe me qëllim që të fillojë ekzekutimin, duhet t'i provojë gjykatës, në mënyrë bindëse, pjesën e papaguar dhe mbarimin e periudhës së njoftimit.

Neni 217

Publikimi i vendimit për miratimin e planit

1. Sapo vendimi i mbledhjes së kreditorëve që miraton planin e riorganizimit, në mungesë të kundërshtimeve ose për shkak të rrëzimit të tyre nga gjykata e falimentimit bëhet i ekzekutueshëm, gjykata e falimentimit pasi e miraton atë, urdhëron shpalljen publike të ekstraktit të këtij vendimi.
2. Shpallja publike, nëse është parashikuar në pjesën arsyetuese të planit, përfshin gjithashtu:
 - a) shtrirjen e mbikëqyrjes edhe mbi shoqërinë e bashkuar;
 - b) kriteret e veprimeve juridike që kërkojnë miratimin e administratorit të falimentimit;
 - c) shumën e kufirit maksimal të huasë.

Neni 218

Pasojat e verifikimit të planit nga gjykata

1. Me publikimin e vendimit për miratimin e planit mbarojnë të gjitha funksionet e administratorit të falimentimit. Administratori mbetet në procedurë si administrator mbikëqyrës i zbatimit të planit.
2. Debitorit, në përputhje me planin e miratuar të riorganizimit, i kthehet e drejta të disponojë masën e falimentimit si dhe e drejta e përfaqësimit në marrëdhënie me të tretët ose gjykatën.

Neni 219

Mbrojtja kundrejt ekzekutimit

1. Me publikimin e vendimit të gjykatës së falimentimit, pezullohet për një afat për tre vjet, çdo kërkesë për ekzekutim ndaj masës së falimentimit, përveç atyre të miratuara shprehimisht në planin e riorganizimit.
2. Gjkata e falimentimit mund të lejojë ekzekutime të veçanta nëse ato nuk cenojnë përmbushjen e planit.

Neni 220

Periudha e kufizimeve të veçanta

1. Pretendimi i një kreditori në procedurën e falimentimit, i paregjistruar gjatë mbledhjes së votimit, parashkruhet me kalimin e afatit prej një viti.
2. Afati i parashkrimit fillon kur pretendimi i kalon afati dhe kur vendimi i gjykatës së falimentimit mbi verifikimin dhe miratimin e planit shpallet publikisht.

3. Pikat 1 dhe 2 të këtij neni, nuk zbatohen për pretendimet të cilat janë parashkruar më shpejt për shkak të parashikimeve të dispozitave të tjera ligjore.
4. Pezullimi i parashkrimit mbaron tre muaj pas përfundimit të mbrojtjes kundër ekzekutimit.

Neni 221

Mbikëqyrja e zbatimit të planit dhe shpenzimet e mbikqyrjes

1. Mbikëqyrja e zbatimit të planit dhe mbikëqyrja e përmbushjes së pretendimeve parashikohet dhe zbatohet sipas pjesës arsyetuese të planit.
2. Mbikëqyrja përfshin përmbushjen e pretendimeve të kreditorëve që ngrihen kundër një personi juridik ose një shoqërie të thjeshtë, të krijuar pas hapjes së procedurës së falimentimit për t'u bashkuar me veprimtarinë ose për ta vazhduar atë ose veprimtarinë e debitorit.
3. Shpenzimet e mbikëqyrjes paguhen nga debitori.

Neni 222

Subjektet mbikëqyrëse të zbatimit të planit të riorganizimit

1. Mbikëqyrja është detyrë e administratorit mbikëqyrës. Funkcionet mbikëqyrëse të anëtarëve të komitetit të kreditorëve, gjykatës së falimentimit dhe Agjencisë Kombëtare të Falimentimit vazhdojnë të ekzistojnë.
2. Gjatë kohës së mbikëqyrjes, administratori mbikëqyrës ka për detyrë t'i raportojë, çdo vit, komitetit të kreditorëve, kur ekziston një i tillë, gjykatës së falimentimit dhe Agjencisë Kombëtare të Falimentimit për gjendjen dhe perspektivën e mëtejshme të realizimit të planit të riorganizimit.
3. Komiteti i kreditorëve, gjykata e falimentimit dhe Agjencia Kombëtare e Falimentimit kanë të drejtë që në çdo kohë të kërkojnë të dhëna të veçanta ose një raport të ndërmjetëm lidhur me gjendjen e planit.

Neni 223

Detyrimi i administratorit mbikëqyrës për të njoftuar

Administratori mbikëqyrës që vëren se pretendimet, shlyerja e të cilave mbikëqyrët, nuk paguhen ose nuk mund të paguhen, këtë fakt ia bën të njohur, pa vonesë, komitetit të kreditorëve, çdo kreditori të papaguar, gjykatës së falimentimit dhe Agjencisë Kombëtare të Falimentimit. Nëse nuk është caktuar komitet kreditorësh, administratori mbikëqyrës njofton të gjithë kreditorët, të cilëve, sipas pjesës arsyetuese të planit të riorganizimit, u takon ripagimi i pretendimeve kundër debitorit ose shoqërisë në të cilën është shndërruar shoqëria ekzistuese.

Neni 224

Konvertimi i procedurës nga riorganizimi në likuidim

1. Çdo kreditor ka të drejtë t'i kërkojë administratorit mbikëqyrës që t'i drejtohet gjykatës së falimentimit për konvertimin e procedurës nga riorganizimi në likuidim, në rastet e:
 - a) mosshlyerjes së detyrimeve të maturuara edhe pas paralajmërimit të kreditorëve në afatin 15 ditor;
 - b) njoftimit të administratorit mbikëqyrës mbi dështimin e debitorit për të paraqitur informacionin për zbatimin e planit brenda afatit të kërkuar ose në kohën shtesë, ashtu siç e kërkon gjykata e falimentimit.
2. Çdo kreditor ka të drejtën e ankimit në gjykatën e falimentimit në rast se administratori mbikëqyrës kundërshton përmbushjen e detyrimeve sipas pikës 1 të këtij neni.
3. Gjykata e falimentimit me kërkesën e administratori mbikëqyrës ose mbi ankimin e kreditorëve, pasi dëgjon debitorin, nëse ekzistojnë kushtet e parashikuara në pikën 1 të këtij neni, vendos konvertimin e procedurës nga riorganizimi në likuidim. Kundër këtij vendimi të ndërmjetëm mund të bëhet ankim i veçantë në gjykatën e apelit.

Neni 225 **Përfundimi i mbikëqyrjes**

1. Gjykata e falimentimit vendos përfundimin e mbikëqyrjes nësepretendimet, shlyerja e të cilave mbikëqyret, janë përmbushur ose përmbushja e tyre është siguruar.
2. Vendimi për përfundimin e mbikëqyrjes publikohet.

KREU V. **VETADMINISTRIMI NGA DEBITORI**

Neni 226 **Kushtet**

1. Në procedurën e falimentimit, debitori mund të administrojë ose disponojë mbi masën e falimentimit nëse gjykata e falimentimit vendos për vetadministrimin në vendimin për hapjen e procedurës së falimentimit, nën kontrollin e administratorit mbikëqyrës. Dispozitat e përgjithshme të këtij ligji zbatohen edhe për këtë kre për aq sa nuk bien në kundërshtim me të.
2. Për dhënien e vendimit sipas pikës 1 të këtij neni kërkohet:
 - a) kërkesa nga ana e debitorit;
 - b) që ky vendim të mos shkaktojë disavantazhe për kreditorin;
3. Në rastin e pikës 1 të këtij neni, vendoset një administrator mbikëqyrës. Pretendimet e kreditorëve të falimentimit depozitohen te administratori mbikëqyrës.

Neni 227 **Anulimi i vendimit të gjykatës së falimentimit për vetadministrim**

1. Gjykata e falimentimit anulon vendimin për vetadministrim nën mbikëqyrjen e një administratori mbikëqyrës, nëse kjo kërkohet nga:
 - a) administratori mbikëqyrës;
 - b) debitori;
 - c) mbledhja e kreditorëve sipas shumicës së përcaktuar në nenin Neni 73, pika 2 të këtij ligji;
 - d) një kreditor me të drejtë ripagimi të veçantë ose nga kreditori i falimentimit edhe nëse nuk ekzistojnë me kushtet e parashikuara nga shkronja (b) e nenit Neni 226 të këtij ligji dhe vetadministrimi mund të dëmtojë seriozisht palën kërkuese;
2. Kërkesa e një kreditori është e pranueshme nëse i vërteton gjykatës së falimentimit, në mënyrë bindëse, se nuk ekzistojnë më kushtet e parashikuara nga ky ligj. Përpara se të vendosë për kërkesën, gjykata e falimentimit dëgjon debitorin. Kreditori dhe debitori kanë të drejtën e ankimit të veçantë kundër këtij vendimi.
3. Administratori mbikëqyrës i deriatëhershëm mund të caktohet si administrator falimentimi.

Neni 228

Publikimi

Vendimi i gjykatës së falimentimit, me të cilin urdhërohet vetadministrimi pas fillimit të procedurës së falimentimit ose me të cilin anulohet ky vendim, publikohet.

Neni 229

Statusi i administratorit mbikëqyrës

1. Rregullimet e përcaktuar në nenin Neni 48 shkronja (b) dhe nenet Neni 55 deri në Neni 62 të këtij ligji, zbatohen në mënyrë të njëjtë për caktimin e administratorit mbikëqyrës, për mbikëqyrjen e tij nga gjykata e falimentimit si edhe për përgjegjësinë dhe shpërblimin e administratorit mbikëqyrës.
2. Administratori mbikëqyrës verifikon gjendjen ekonomike të debitorit, monitoron administrimin e biznesit dhe shpenzimet për përballimin e jetesës.
3. Kur administratori mbikëqyrës vëren rrethana që tregojnë se vazhdimi i vetadministrimit do të dëmtonte kreditorët, këto rrethana, pa vonesë, ia bën të ditur komitetit të kreditorëve dhe gjykatës së falimentimit. Kur nuk është caktuar komiteti i kreditorëve, administratori mbikëqyrës njofton kreditorët e falimentimit që kanë depozituar pretendimet e tyre dhe kreditorët me të drejtë ripagimi të veçantë.

Neni 230

Miratimi nga administratori mbikëqyrës

Debitori nuk mund të ndërmarrë detyrime që tejkalojnë ushtrimin e administrimit të zakonshëm të veprimtarisë, përveç se me pëlqimin e administratorit mbikëqyrës. Debitori nuk mund të ndërmarrë edhe detyrime që kanë të bëjnë me ushtrimin e veprimtarisë, nëse këto kundërshtohen nga administratori mbikëqyrës. Mosmarrëveshjet ndërmjet debitorit dhe administratorit mbikëqyrës zgjidhen me vendim nga gjykata e falimentimit.

Neni 231
Pëlqimi i komitetit të kreditorëve

Debitori merr pëlqimin e komitetit të kreditorëve për çdo veprim juridik të një rëndësie të veçantë për procedurën e falimentimit.

Neni 232
Mospërfshirja e njësive mbikëqyrëse

Nëse debitori është një shoqëri tregtare ose shoqëri e thjeshtë, bordi mbikëqyrës, mbledhja e partnerëve ose organet mbikëqyrëse të administrimit dhe drejtimit të barazvlefshme me to, nuk do të kenë ndikim në administrimin e debitorit. Shkarkimi ose caktimi i personelit me roldrejtues ka vlerë vetëm nëse për këtë jep miratimin gjykata e falimentimit pasi të jetë këshilluar me administratorin mbikëqyrës. Miratimi jepet kur sigurohet se masa e ndërmarrë nuk shkakton dëmtim të interesave të kreditorëve.

Neni 233
Urdhër i gjykatës së falimentimit për miratim

1. Me kërkesë të mbledhjes së kreditorëve, gjykata e falimentimit vendos që veprime juridike të caktuara të debitorit të jenë të vlefshme vetëm me miratimin e administratorit mbikëqyrës.
2. Urdhëri i gjykatës së falimentimit mund të lëshohet me kërkesë të një kreditori me të drejtë ripagimi të veçantë ose të një kreditori të masës së falimentimit kur kërkesa është urgjente, me qëllim që të shmangë dëmtimin e kreditorëve. Urdhri lëshohet kur pala kërkuuese i vërteton gjykatës së falimentimit, në mënyrë bindëse, se janë kushtet për një vendim të tillë.
3. Urdhri shpallet publikisht sipas parashikimeve të këtij ligji. Nëse e drejta për tjetërsim të një pasurie të paluajtshme ose një e drejte tjetër e regjistruar në një regjistër pronësie kërkojnë dhënien e miratimit, sipas nenit Neni 42 të këtij ligji.

Neni 234
Fondet për përballimin e jetesës së debitorit

1. Debitori mund të marrë nga masa e falimentimit një shumë të caktuar e cila i lejon kushte jetese për veten dhe për anëtarët e familjes, sipas përcaktimeve të pikës 2 të nenit Neni 97 të këtij ligji.
2. Nëse debitori nuk është person fizik, zbatohet pika 1 e këtij neni edhe për anëtarët e shoqërisë së thjeshtë, shoqërisë kolektive, ortakëte pakufizuar të shoqërisë komandite.

Neni 235
Kundërshtimi i veprimeve të debitorit në vetadministrim

Vetëm administratori mbikëqyrës ka të drejtë të kundërshtojë veprimet e debitorit për kreditë e përfshira në favor të masës së falimentimit sipas neneve Neni 110 deri Neni 119 të këtij ligji.

Neni 236
Detyrimi i debitorit për raportim

1. Debitori përcakton listën e sendeve të masës së falimentimit, listën e kreditorëve dhe tabelën e pasurive, sipas neneve Neni 122 deri Neni 124 të këtij ligji. Administratori mbikëqyrës verifikon listat dhe tabelën e pasurive dhe jep shpjegime me shkrim për secilën prej tyre, duke treguar nëse rezultatet e verifikimit lënë vend për vërejtje.
2. Debitori raporton në mbledhjen e raportimit. Administratori mbikëqyrës komenton raportimin.
3. Debitori ka për detyrë të paraqesë llogaritë, sipas neneve Neni 63 dhe Neni 126 të këtij ligji. Pika e parë, fjalia e dytë e këtij neni, do të zbatohet njëloj për llogaritë finale të debitorit.

Neni 237
Zotërimi i kolateralit. Disponimi i garancive

1. Debitori ushtron të drejtën e administratorit të falimentimit për të veçuar sendet, të cilat i nënshtrohen të drejtës së ripagimit të veçantë. Shpenzimet për veçimin e sendit dhe detyrimi tatimor i mundshëm caktohen si shpenzime veçimi. Shpenzimet e përcaktimit të sendeve dhe të të drejtave mbi to nuk paguhen.
2. Debitori e ushtron të drejtën e vet për veçim me miratimin e administratorit mbikëqyrës.

Neni 238
Pagimi i kreditorëve të falimentimit

1. Gjatë shqyrtimit të pretendimeve, debitori dhe administratori mbikëqyrës mund të kundërshtojnë pretendimet e depozituara, përveç kreditorëve të falimentimit. Pretendimi i kundërshtuar nga një kreditor falimentimi, nga debitori ose nga administratori mbikëqyrës quhet i pavërtetuar.
2. Debitori kryen shpërndarjen. Administratori mbikëqyrës verifikon të gjitha listat e shpërndarjes dhe deklaron me shkrim, për secilin rast, nëse ka vërejtje për rezultatet e verifikimit.

Neni 239
Plani i riorganizimit

Administratori mbikëqyrës ose debitori merr përsipër detyrën e mbledhjes së kreditorëve për hartimin e planit të riorganizimit. Kur detyra i ngarkohet debitorit, administratori mbikëqyrës bashkëpunon si këshilltar në hartimin e këtij plani.

PJESA E SHTATË.

SHKARKIMI NGA DETYRIMET E PASHLYERA

KREU I.

Neni 240 **Parimi**

Kur debitori është person fizik, ai shkarkohet nga detyrimet e pashlyera ndaj kreditorëve të falimentimit gjatë procedurës së falimentimit, sipas dispozitave të parashikuara në këtë kre të këtij ligji.

Neni 241 **Kërkesa e debitorit për shkarkimin e detyrimeve të pashlyera**

1. Shkarkimi nga detyrimet e pashlyera bëhet me kërkesë me shkrim të debitorit e cila depozitohet në gjykatën e falimentimit. Kjo kërkesë mund t'i bashkohet kërkesës për fillimin e procedurës së falimentimit.
2. Kërkesës i bashkëlidhet deklarata, që vërteton vullnetin e debitorit për t'i kaluar një kujdestari, të caktuar nga gjykata e falimentimit me propozim të debitorit ose të kreditorëve, shumat e tepërta që burojnë nga një kontratë pune ose shërbimi. Në qoftë se debitori ia ka kaluar këto të drejta me kontratën të treti, ky fakt shënohet në deklaratë.
3. Janë të pavlefshme marrëveshjet që përjashtojnë, kushtëzojnë ose, në mënyra të tjera, kufizojnë debitorin të heqë dorë prej pretendimeve për të përfituar pagesat e mësipërme.

Neni 242 **Vendimi i gjykatës së falimentimit për shkarkimin e detyrimeve të pashlyera**

1. Para marrjes së vendimit për shkarkimin e detyrimeve të pashlyera, gjykata e falimentimit në mbledhjen përfundimtare të kreditorëve dëgjon kreditorët dhe debitorin e falimentimit.
2. Gjykata e falimentimit, nëse nuk ka shkaqe për refuzimin e kërkesës, vendos për miratimin e shkarkimit të detyrimeve. Kundër këtij vendimi mund të paraqesë ankim të veçantë debitori ose çdo kreditor, që nuk ka pranuar shkarkimin e detyrimeve të pashlyera në mbledhjen përfundimtare.
3. Gjykata e falimentimit cakton me të njëjtin vendim edhe kujdestarin, të cilit i kalojnë të ardhurat e tepërta të debitorit, sipas deklaratës që bën debitori për këtë qëllim.
4. Vendimi për shkarkimin e detyrimeve të pashlyera, shpallet publikisht.

Neni 243 **Refuzimi për shkarkimin nga detyrimi i mbetur**

1. Gjykata e falimentimit refuzon shkarkimin nga detyrimi i pashlyer kur:

- a) debitori është dënues me vendim të formës së prerë për një vepër penale, sipas dispozitave të Kodit Penal;
 - b) debitori, në tri vitet e fundit para kërkesës për fillimin e procedurës së falimentimit ose pas paraqitjes së kësaj kërkesë, me dashje ose për shkak të pakujdesisë ka dhënë deklaratë, me shkrim, false ose të paplotë, për gjendjen e tij ekonomike, me anë të së cilës debitori ka zbatuar për një kredi, për grante nga fonde publike ose ka shmangur pagesa në favor të fondeve publike;
 - c) debitori është shkarkuar nga detyrimet e mbetura në dhjetë vitet e fundit përpara kërkesës, pavarësisht nëse kjo kërkesë është revokuar;
 - d) debitori, në vitin e fundit përpara ose paskërkesës për shkarkimin e detyrimeve të pashlyera, me dashje ose nga pakujdesia, ka penguar ripagimin e kreditorëve të falimentimit, duke krijuar detyrime të panevojshme, duke shpërdoruar pasuritë ose duke vonuar hapjen e procedurës së falimentimit ose të mundësive për përmirësimin e gjendjes së tij ekonomike;
 - e) gjatë procedurës së falimentimit, debitori me dashje ose nga pakujdesia ka shkelur detyrimin për të dhënë të dhëna ose për të bashkëpunuar;
 - f) debitori ka dhënë deklaratë false ose të paplota, me dashje ose nga pakujdesia, në listat e detyrueshme për t'u paraqitur për pasurinë dhe të ardhurat e tij, të kreditorëve të tij dhe të pretendimeve të ngritura ndaj tij.
2. Nëse ka një kërkesë nga kreditori për refuzim, kërkesë përmban shkaqet për të cilat nuk duhet pranuar shkarkimi nga detyrimi i mbetur.

Neni 244 **Statusi juridik i kujdestarit**

1. Kujdestari ka detyrë t'i njoftojë statusin e vet personit të detyruar për të kryer pagesën. Kujdestari ndan veçmas shumat e marra në bazë të këtij statusi, së bashku me pagesa të tjera të kryera nga debitori ose palë të treta dhe ua shpërndan ato çdo vit kreditorëve mbi bazën e listës përfundimtare.
2. Kujdestari caktohet për një periudhë prej gjashtë vjetësh pas vendimit të gjykatës së falimentimit për shkarkimin e detyrimeve të pashlyera të debitorit.
3. Mbledhja përfundimtare e kreditorëve mund t'i ngarkojë, gjithashtu, kujdestarit detyrën e mbikëqyrjes së debitorit për përmbushjen e detyrave të tij. Në këtë rast, kur vëren shkelje për këto detyrime, kujdestari njofton pa vonesë kreditorët. Kujdestari është i detyruar të mbikëqyrë vetëm nëse është paguar ose parapaguar pagesa shtesë për këtë detyrë.
4. Kujdestari, në përfundim të detyrës së tij sipas pikës 2 të këtij neni, i raporton gjykatës së falimentimit.

Neni 245 **Shpërblimi i kujdestarit**

1. Kujdestari ka të drejtën e shpërblimit për punën e vet dhe për pagimin e shpenzimeve të arsyeshme. Në shpërblim përfshihen koha e shpenzuar nga kujdestari dhe vëllimi i punës së tij.
2. Kriteret dhe mënyra e llogaritjes së masës të shpërblimit për punën e kujdestarit caktohen me Vendim të Këshillit të Ministrave.

Neni 246
Trajtimi i barabartë i kreditorëve

1. Nuk mund të kryhen ekzekutime të detyrueshme mbi pasuritë e debitorit në favor të kreditorëve të veçantë të falimentimit gjatë periudhës kur debitori ia ka kaluar kujdestarit të drejtën e veprimit.
2. Është e pavlefshme çdo marrëveshje e debitorit ose e personave të tjerë me kreditorë të veçantë falimentimi që parashikon përfitime për këta të fundit.
3. Personi i ngarkuar për të kryer pagesa që mbulohen nga veprimet e kujdestarit mund të bëjë një kompensim të ndërsjellë për pretendimet kundër debitorit, që ka të drejtën e kompensimit.

Neni 247
Detyrimet e debitorit

1. Debitori, gjatë kohëzgjatjes së kalimit të të drejtave kujdestarit, ka detyrë të zbatojë rregullat e mëposhtme:
 - a) të zhvillojë një veprimtari të përshtatshme fitimprurëse ose të kërkojë punësim dhe, kur është i papunë, të mos refuzojë një punë të arsyeshme;
 - b) t'i transferojë kujdestarit gjysmën e vlerës së pasurisë që ka fituar me trashëgimi ose në lidhje me një të drejtë të ardhshme që buron nga trashëgimia;
 - c) të njoftojë gjykatën e falimentimit dhe kujdestarin, pa vonesë, për çdo ndryshim të vendbanimit ose të vendit të punës, të mos fshehë të ardhura ose çdo pasuri tjetër sipas pikës 2 të këtij neni, që përfshihen në aktin e kalimit të të drejtave kujdestarit dhe të njoftojë gjykatën e falimentimit dhe kujdestarin, me kërkesën e tyre, për të ardhurat nga punësimi ose për përpjekjet për të gjetur punësim, si dhe për të ardhurat dhe pasurinë e tij;
 - d) t'u kryejë pagesat kreditorëve të falimentimit vetëm nëpërmjet kujdestarit dhe të mos sjellë përfitime të veçanta për asnjë kreditor falimentimi.
2. Në rast se debitori ushtron një veprimtari të pavarur, ai paguan kreditorët nëpërmjet kujdestarit, në të njëjtën mënyrë sikur të kishte hyrë në një kontratë të rregullt shërbimi.

Neni 248
Revokimi i shkarkimit të detyrimeve të pashlyera për shkak të shkeljes së detyrimevetë debitorit

1. Kur debitori, gjatë kohës së veprimtarisë së kujdestarit, shkel një prej detyrimeve të tij dhe, për pasojë, pengon shlyerjen e kreditorëve të falimentimit, atëherë me kërkesë të një kreditori falimentimi, gjykata e falimentimit revokon vendimin e shkarkimit të detyrimeve të pashlyera. Ky rregull nuk zbatohet vetëm kur debitori vepron padashje. Kërkesa e kreditorit mund të paraqitet brenda një viti nga koha kur kreditori ka marrë dijeni për shkeljen e një detyrimi por në cdo rast jo më vonë se gjashtë vjet nga dhënia e vendimit të shkarkimit të detyrimit.
2. Debitori duhet të japë të dhëna mbi detyrimet e veta në mbledhjen përfundimtare dhe, kur e kërkon kreditori, të sigurojë vërtetësinë e të dhënave duke dhënë një deklaratë të betuar.

Kur debitori nuk i jep të dhënat ose deklaratë betimi brenda afatit të caktuar, pa ndonjë justifikim të arsyeshëm, ose kur nuk paraqitet në mbledhjen e caktuar nga gjykata e falimentimit për dhënien e të dhënave ose të deklaratës noteriale, edhe pse i është dërguar njoftim i rregullt dhe nuk ka justifikim të arsyeshëm, gjykata e falimentimit revokon shkarkimin e detyrimeve të pashlyera.

3. Nëse vërtetohet që debitori ka shkelur me dashje një nga detyrimet e tij dhe, si pasojë, ka dëmtuar në mënyrë të ndjeshme kreditorët e falimentimit, gjykata e falimentimit revokon shkarkimin nga detyrimi i pashlyer.

4. Kundër vendimit, pala kërkuese dhe debitori mund të paraqesin ankim të veçantë.

5. Vendimi i revokimit të shkarkimit të detyrimeve të pashlyera, publikohet.

Neni 249

Revokimi i shkarkimit të detyrimeve të pashlyera për shkak të dënimit penal

1. Gjukata e falimentimit revokon vendimin për shkarkimin nga detyrimet e pashlyera me kërkesë të një kreditori falimentimi kur debitori, në periudhën ndërmjet mbledhjes përfundimtare dhe mbylljes së procedurës së falimentimit ose gjatë periudhës së aktit të veprimit të kujdestarit, është dënuar sipas dispozitave të Kodit Penal me vendim të formës së prerë për kryerjen e një vepre penale.

2. Fjalja e dytë dhe e tretë e pikës 1 të nenit Neni 248 të këtij ligji zbatohen në mënyrë të njëjtë.

Neni 250

Revokimi për shkak të mospagimi të shpërblimit të kujdestarit

1. Me kërkesë të kujdestarit, gjykata e falimentimit revokon vendimin për shkarkimin nga detyrimi i pashlyer në rast se shumat e marra për vitin e shkuar të veprimtarisë nuk kanë mbuluar shpërblimin e tij dhe nëse debitori nuk e ka paguar atë, megjithëse kujdestari ka kërkuar me shkrim pagesën brenda një afati të paktën dyjavor, ku ka vënë në dukje mundësinë e revokimit të vendimit të shkarkimit nga detyrimi i pashlyer brenda dy javësh.

2. Përpara marrjes së vendimit, gjykata e falimentimit dëgjon debitorin. Gjukata e falimentimit nuk e refuzon shkarkimin nga detyrimi i pashlyer kur debitori, me kërkesë të gjykatës, paguan shumën e mbetur brenda dy javësh.

Neni 251

Përfundimi i parakohshëm

Nëse vendimi i shkarkimit revokohet, statusi i veprimit të kujdestarit, detyra e tij dhe kufizimi i të drejtave të kreditorëve bëhen të pavlefshme shpalljen e vendimit të gjykatës së falimentimit.

Neni 252

Vendimi për mbylljen e procedurës së falimentimit

1. Në qoftë se ka përfunduar periodha e veprimit të kujdestarit sipas nenit Neni 244 dhe nuk ka përfundim të parakohshëm për shkak të revokimit, gjykata e falimentimit vendos për mbylljen e procedurës së falimentimit pasi dëgjon kreditorët e falimentimit, kujdestarin dhe debitorin.
2. Gjykata e falimentimit refuzon mbylljen e procedurës së falimentimit ku ekzistojnë kushtet për revokimin e vendimit për shkarkimin nga detyrimi i pashlyer me kërkesën e një kreditori të falimentimit ose të kujdestarit.
3. Vendimi shpallet publikisht.
4. Debitori dhe çdo kreditor falimentimi, të cilët gjatë seancës sipas pikës 1 të këtij neni kanë kërkuar refuzimin e mbylljes së procedurës së falimentimit kanë të drejtën e ankimit.

Neni 253

Pasoja e mbylljes së procedurës së falimentimit

1. Nëse miratohet mbyllja e procedurës së falimentimit, shkarkimi është i vlefshëm për të gjithë kreditorët e falimentimit përfshirë edhe kreditorët që nuk i kanë depozituar pretendimet e tyre.
2. Nuk cenohen nga shkarkimi prej detyrimit të pashlyer të drejtat e kreditorëve të falimentimit kundrejt debitorëve të debitorit dhe garantëve, si dhe të drejtat e tyre që burojnë nga një njoftim i regjistruar me përparësi në pagesë, me të cilën sigurohen këta kreditorë ose që buron nga një e drejtë për ripagim të veçantë në procedurën e falimentimit. Megjithatë, debitori shkarkohet kundrejt kreditorëve, bashkë-debitorëve, garantëve ose personave të tjerë me pretendime ndaj tij, në të njëjtën mënyrë, që shkarkohet nga detyrimet e kreditorëve të falimentimit.
3. Në qoftë se një kreditor pa të drejtë pagimi, paguhet si pasojë e shkarkimit nga detyrimi i pashlyer, ky kreditor nuk është i detyruar të kthejë shumën e marrë.

Neni 254

Detyrimet që nuk shkarkohen

1. Debitori nuk shkarkohet nga:
 - a) detyrimet nga kredi pa interes, dhënë debitorit për të paguar shpenzimet e procedurës së falimentimit.
 - b) detyrimet që kanë lindur si pasojë e mashtrimit, dëshmie të rreme ose sjellje të tjera në keqbesim;
 - c) detyrimet që kanë lindur nga dëme të qëllimshme;
 - d) detyrimet për mbështetje financiare të fëmijëve;
 - e) detyrime për pagesën e taksave ose pagesa të tjera të detyrueshme ndaj shtetit, borxhe që kanë lindur gjatë një periudhe tre vjeçare përpara datës së paraqitjes së kërkesës;
 - f) gjobat dhe sanksionet administrative;
 - g) kreditë studentore;
 - h) detyrimet e lindura nga veprime që kanë sjellë si pasojë dëmtimin ose vdekjen ndaj një personi tjetër;
 - i) detyrimet e pashkarkueshme nga një procedurë e mëparshme falimentimi;
 - j) detyrimet mbi pronat të cilat i kanë kaluar personave të lidhur me debitorin;

2. Gjykata e falimentimit mund të revokojë shkarkimin nëse një nga palët vërteton se ky shkarkim është fituar me anë të mashtrimit dhe paraqet kërkesë brenda 1 viti nga marrja në dijeni e mashtrimit.

Neni 255

Prapësimi i shkarkimit nga detyrimi i pashlyer

1. Kërkesa e kreditorit pranohet vetëm nëse depozitohet brenda një viti nga shpallja e vendimit të formës së prerë për shkarkimin nga detyrimi i pashlyer dhe nëse vërtetohet që ekzistojnë kushtet e pikës 1 të këtij neni dhe nëse vërtetohet që kreditori nuk ka pasur dijeni për to deri në kohën kur vendimi ka marrë formë të prerë.
2. Para marrjes së vendimit duhet të dëgjohen debitori dhe kujdestari. Pala kërkuuese dhe debitori kanë të drejtën e ankimit të veçantë kundër vendimit. Vendimi për refuzimin e shkarkimit nga detyrimi i mbetur, bëhet publik.

PJESA E TETË.

PROCEDURA E FALIMENTIMIT PËR KONSUMATORËT DHE

PROCEDURA TË TJERA MË PAK TË RËNDËSISHME

KREU I.

FUSHA E ZBATIMIT

Neni 256

Parime të përgjithshme

1. Në qoftë se debitori është person fizik pa veprimtari ekonomike ose ushtron një veprimtari ekonomike të vogël të pavarur, vlejnë dispozitat e përgjithshme të këtij ligji, me kusht që në këtë pjesë të mos jetë parashikuar ndryshe.
2. Veprimtaria e pavarur ekonomike është e vogël në kuptimin e pikës 1 të këtij neni, veçanërisht nëse për nga lloji dhe madhësia nuk kërkon një strukturë biznesi nga pikëpamja tregtare.

KREU II.

PLANI I SHLYERJES SË DETYRIMEVE

Neni 257

Kërkesa e debitorit për hapjen e procedurës së falimentimit

Me kërkesën për hapjen e procedurës së falimentimit debitori mund të paraqesë një plan për shlyerjen e detyrimeve. Ky plan mund të përmbajë të gjitha dispozitat e përshtatshme për të çuar në një shlyerje të duhur të detyrimeve ku merren parasysh interesat e kreditorëve dhe pasuria e debitorit, si dhe të ardhurat dhe rrethanat familjare. Planit parashikon masën, prekjën e garancive, pengjet dhe forma të tjera sigurimi të kreditorëve.

Neni 258

Pezullimi i procedurës

1. Kur debitori paraqet një plan për shlyerjen e detyrimeve, procedura për kërkesën për fillimin e procedurës së falimentimit pezullohet deri në marrjen e një vendimi mbi planin. Kjo periudhë kohore nuk duhet të jetë më shumë se tre muaj.
2. Pika 1 e këtij neni nuk cenon urdhrin e vendosjes së masave të sigurisë.
3. Kur një kreditor kërkon hapjen e procedurës, gjykata e falimentimit duhet t'i japë mundësinë debitorit të paraqesë kërkesë para se të marrë vendim për hapjen e procedurës. Në qoftë se debitori bën kërkesë dhe dorëzon brenda një muaji një plan për shlyerjen e detyrimeve, pika 1 e këtij neni zbatohet edhe për kërkesën e debitorit.

Neni 259

Shërbimi ndaj kreditorëve

1. Gjykata e falimentimit u jep kreditorëve të përmendur nga debitori planin e shlyerjes së detyrimeve, si dhe listën e pasurive dhe listën e kreditorëve, sipas dispozitave të këtij kreu, dhe njëkohësisht i fton kreditorët, që brenda një periudhe njëmuje, të paraqesin komentet e tyre ndaj listave dhe planit të shlyerjes së detyrimeve. Kreditorët njoftohen për të parë të dhënat e depozituara në gjykatën e falimentimit. Çdo kreditori i jepet mundësia të shqyrtojë të dhënat për pretendimin e tij në listën e pretendimeve, brenda afatit një muaj dhe, kur është e nevojshme, të bëjë plotësime.
2. Nëse komentet e kreditorit, nuk arrijnë brenda afatit të caktuar, atëherë vlerësohet se plani i shlyerjes së detyrimeve është pranuar. Kjo duhet të vihet në dukje në kërkesën për komente.
3. Pasi ka përfunduar afati i bërjes së komenteve nga ana e kreditorëve, debitorit i jepet mundësia, që brenda një afati të caktuar nga gjykata e falimentimit, të ndryshojë ose të plotësojë planin për shlyerjen e detyrimeve, kur kjo është e nevojshme mbi bazën e komenteve të njërit prej kreditorëve ose kur kjo duket e arsyeshme pasi është në interes të shlyerjes me marrëveshje mbi detyrimin e mbetur. Kreditorët duhet të njoftohen për ndryshimet ose plotësimet nëse kjo është e nevojshme.

Neni 260

Pranimi i planit të shlyerjes së detyrimeve

1. Në qoftë se asnjë kreditor nuk ka paraqitur komente ose vërejtje ndaj planit të shlyerjes së detyrimeve ose në qoftë se pranimi zëvendësohet sipas nenit Neni 261 të këtij ligji, plani i shlyerjes së detyrimeve vlerësohet i pranuar. Gjykata e falimentimit e përcakton këtë në vendim. Plan i shlyerjes së detyrimeve ka fuqinë dhe pasojat e një titulli ekzekutiv sipas nenit 510 të Kodit të Procedurës Civile. Një kopje e planit të shlyerjes së detyrimeve dhe e vendimit, u dorëzohet kreditorëve dhe debitorit.
2. Kërkesa për hapjen e procedurës së falimentimit dhe e lëshimit të urdhrat për shkarkimin nga detyrimi i pashlyer vlerësohet e tërhequr.
3. Nëse në listën e debitorit nuk figurojnë pretendimet dhe kur ato nuk janë përmendur gjatë përgatitjes së planit të shlyerjes së detyrimeve, kreditorët mund të kërkojnë që debitori të pajtohet me këto pretendime. Kjo dispozitë nuk zbatohet kur kreditori nuk ka plotësuar, brenda afatit të caktuar, të dhënat për pretendimin e tij në listën e pretendimeve që i është dërguar nga gjykata e falimentimit, sipas pikës 1 të nenit Neni 259 të këtij ligji, edhe pse pretendimi mund të kishte lindur përpara mbarimit të afatit. Në këtë rast pretendimi bëhet i pavlefshëm.

Neni 261

Zëvendësimi i miratimit

1. Në qoftë se plani i shlyerjes së detyrimeve miratohet nga më shumë se gjysma e kreditorëve të regjistruar dhe nëse shumica e pretendimeve të kreditorëve në favor të planit

përbën më shumë se gjysmën e pretendimeve të kreditorëve të regjistruar, gjykata e falimentimit me kërkesën e një kreditori ose të debitorit, zëvendëson kundërshtimin e një kreditori ndaj planit për shlyerjen e detyrimeve me miratimin me marrëveshje. Kjo nuk zbatohet kur kreditori që ka paraqitur kundërshtimin provon se nuk përfshihet në masën e duhur në krahasim me kreditorët e tjerë duke u marrë për bazë edhe të ardhurat, pasuria dhe gjendja familjare e debitorit në kohën e paraqitjes së kërkesës.

2. Para marrjes së vendimit dëgjohet kreditori. Ai duhet të paraqesë shkaqe të besueshme lidhur me arsyet që pengojnë zëvendësimin. Kundër vendimit, kërkuesi dhe kreditori, miratimi i të cilëve zëvendësohet, kanë të drejtën e ankimit të veçantë.

3. Kur kreditori jep shkaqe të besueshme për fakte që krijojnë dyshime bindëse se një pretendim i deklaruar nga debitori ekziston ose i përgjigjet një shume të ndryshme nga ajo që është deklaruar, dhe nëse prej kësaj varet fakti që kreditori është përfshirë në mënyrë të përshtatshme në krahasim me kreditorët e tjerë, miratimi i kreditorit nuk mund të zëvendësohet.

Neni 262 Shpenzimet

Kreditorët nuk mund të ngrenë ndaj debitorit pretendime për pagimin e shpenzimeve që lindin në lidhje me planin e shlyerjes së detyrimeve.

KREU III. PROCEDURË FALIMENTIMI E THJESHTUAR

Neni 263 Fillimi i punës për hapjen e procedurës së falimentimit

Në qoftë se plani i shlyerjes së detyrimeve nuk miratohet, atëherë veprimet që lidhen me procedurën e falimentimit rihapen kryesisht.

Neni 264 Thjeshtimet e përgjithshme të procedurës

1. Shpallja publike do të bëhet me përmbledhje. Kur hapet procedura e falimentimit caktohet vetëm një mbledhje verifikimi.
2. Dispozitat për planin e riorganizimit dhe për vetadministrimin, nuk zbatohen.

Neni 265 Administratori i falimentimit në procedurën e falimentimit të thjeshtuar

1. Administratori i falimentimit në procedurën e falimentimit të thjeshtuar caktohet në fillim të procedurës së falimentimit. Nenet Neni 55 deri në Neni 59 të këtij ligji zbatohen njëjloj.

2. Administratori i falimentimit në procedurën e falimentimit të thjeshtuar nuk ka të drejtën e shfrytëzimit të sendeve të vëna peng ose të caktuara si sende për të drejtë ripagimi të veçantë.
3. Të drejtat e kreditorëve të siguruar mbeten të paprekura.

Neni 266

Shpërndarja e thjeshtuar

1. Me kërkesë të administratorit të falimentimit në procedurën e falimentimit të thjeshtuar, gjykata e falimentimit urdhëron heqjen dorë krejtësisht ose pjesërisht nga likuidimi i masës së falimentimit. Në këtë rast, gjykata e falimentimit udhëzon debitorin që, brenda një afati që e cakton gjykata e falimentimit, t'i paguajë administratorit të falimentimit në procedurën e falimentimit të thjeshtuar një shumë shtesë e cila i përgjigjet vlerës së pasurive që do t'u shpërndahej kreditorëve të procedurës së falimentimit. Ky urdhër nuk zbatohet kur shlyerja e masës së falimentimit duket tepër e nevojshme, veçanërisht në dobi të kreditorëve.
2. Para marrjes së vendimit dëgjohen kreditorët e falimentimit.
3. Vendimi për kërkesën e debitorit për shkarkimin nga detyrimi i pashlyer, nuk merret deri në mbarimin e afatit të përcaktuar sipas pikës 1 të këtij neni. Me kërkesë të njërit prej kreditorëve të falimentimit, gjykata e falimentimit refuzon shkarkimin nga detyrimi i pashlyer kur nuk është paguar shuma sipas pikës 1 të këtij neni, edhe pas përfundimit të një afati tjetër prej dy javësh të caktuar nga gjykata e falimentimit, i cili i referohet mundësisë së mosdhënies së shkarkimit nga detyrimi i pashlyer. Para marrjes së vendimit dëgjohet debitori.
4. Kundër vendimit mund të bëhet ankimi në gjykatën e apelit.

PJESA E NENTË.

LLOJE TË VEÇANTA TË PROCEDURËS SË FALIMENTIMIT

KREU I.

PROCEDURAT E FALIMENTIMIT MBI TRASHËGIMINË

Neni 267

Kompetenca tokësore

Gjykata e falimentimit e vendbanimit/vendqëndrimit të trashëgimlënësit në kohën e vdekjes ka kompetencë për procedurat e falimentimit të hapura për pronën e tij. Nëse trashëgimlënësi ka pasur qendrën e veprimtarisë së tij të vetë-punësimit në një vend tjetër, gjykata e falimentimit e këtij rrethi gjyqësor është gjykata kompetente.

Neni 268

Hapja e procedurës së falimentimit

1. Hapja e procedurës së falimentimit nuk duhet të pengohet nga fakti se trashëgimtari nuk e ka pranuar ende kalimin e pasurisë për veten e tij ose për faktin se ai është subjekt i përgjegjësisë së pakufizuar për detyrimet që rëndojnë mbi këtë pasuri.
2. Nëse ka disa trashëgimtarë, procedura e falimentimit mund të hapet edhe pas pjesëtimit të pasurisë.
3. Nuk do të ketë procedura falimentimi në lidhje me një pjesë të pasurisë.

Neni 269

E drejtpër të kërkuar hapjen e procedurës

1. Hapja e procedurave të falimentimit në lidhje me pasurinë e trashëgimlënësit mund të kërkohej nga çdo trashëgimtar, nga çdo kujdestar tjetër i trashëgimit ose ekzekutori i testamentit dhe nga çdo kreditor i pasurisë.
2. Nëse kërkesa nuk është bërë nga të gjithë trashëgimtarët, kjo pranohet nëse arsyeja për të hapur procedurën e falimentimit është provuar në mënyrë të pranueshme përpara gjykatës së falimentimit. Gjykata e falimentimit dëgjon edhe trashëgimtarët e tjerë.
3. Në rast se administrimi i pasurisë i është caktuar si detyrë një kujdestari të trashëgimit ose ekzekutori i testamentit, gjykata e falimentimit do të dëgjojë përkatësisht kujdestarinë trashëgimit ose ekzekutorin e testamentit, në qoftë se kërkesën e ka bërë trashëgimtari, ose trashëgimtarin, nëse kërkesën e ka bërë kujdestarii trashëgimit ose ekzekutori i testamentit.

Neni 270
E drejta e kërkesës mbi pasurinë martesore

1. Të drejtën për të bërë kërkesë për hapjen e procedurës së falimentimit e ka bashkëshorti që nuk është trashëgimtar por që administron pasurinë bashkëshortore sipas rregullave të regjimit pasuror martesor të përcaktuara nga Kodi i Familjes.
2. Pëlqimi i bashkëshortit tjetër nuk kërkohet. Gjykata e falimentimit dëgjon bashkëshortin që nuk është dakord.

Neni 271
Afati i kërkesës

Kërkesa e një kreditori për të hapur procedurën e falimentimit nuk pranohet nëse ka kaluar afati prej dy vjetësh që nga çasti që trashëgimtari ka pranuar që atij t'i kalojë pasuria.

Neni 272
Ekzekutimi ndaj trashëgimisë

Masat e ekzekutimit kundrejt pasurive të cilat janë marrë si rrjedhojë e trashëgimisë, nuk i njihen një kreditori me të drejtë ripagimi të veçantë.

Neni 273
Veprimi i kundërshtuar nga trashëgimtari

Nëse trashëgimtari ka plotësuar pretendimet e pasardhësve për një pjesë të detyrueshme, trashëgimitë ose trashëgimi të mëparshme përpara hapjes së procedurës të falimentimit, ky veprim mund të kontestohet në të njëjtën mënyrë si begatim pa shkak të dhënë nga trashëgimtari.

Neni 274
Shpenzimet e trashëgimtarit

Trashëgimtari mund të mos pranojë shlyerjen e detyrimeve të tij për shkak të shpenzimeve të cilat duhet t'i rimbursohen atij nga pasuria.

Neni 275
Shpenzimet mbi pasuritë e përfshira në procedurat e falimentimit

Përveç shpenzimeve të përmendura në nenet Neni 48 dhe Neni 49 dhe të këtij ligji, konsiderohen si shpenzime mbi pasuritë e përfshira në procedurat e falimentimit edhe:

- a) shpenzime të rimbursueshme të trashëgimtarit;
- b) kostot e funeralit të trashëgimlënësit;
- c) kostot për procedurën e deklarimit të vdekjes së trashëgimlënësit, që përfshihen në masën e falimentimit;

- d) kostot për çeljen e trashëgimisë dhe kostot gjyqësore e noteriale;
- e) detyrimet ndaj veprimeve të bëra nga kujdestari i trashëgimit ose ekzekutori i testamentit;
- f) detyrimet e krijuara nga administrimi i pasurisë trashëgimore nga ana e kujdestarit të trashëgimit, ekzekutori i testamentit ose një trashëgimtar i cili nuk e ka pranuar kalimin e pasurisë për veten e vet, të cilat janë në detyrim të trashëgimtarit deri në masën që këto detyrime do të jetë detyrë e kreditorëve të pasurive.

Neni 276

Detyrimet mbi masën e falimentimit

Në procedurën e falimentimit të hapur për një pasuri, mund të pretendohen vetëm detyrimet mbi pasurinë.

Neni 277

Pretendimet e trashëgimtarit

1. Trashëgimtari mund të kërkojë të drejtat e tij ndaj trashëgimlënësit.
2. Në qoftë se trashëgimtari ka përmbushur një detyrim ndaj pasurisë dhe, nëse kjo nuk konsiderohet si e bërë për llogari të pasurisë, ai do të zëvendësojë kreditorin përveç rastit kur ai është subjekt me përgjegjësi të pakufizuar për detyrimet ndaj pasurisë.
3. Në qoftë se trashëgimtari ka përgjegjësi të pakufizuar ndaj një kreditori individual, ai mund të pretendojë të drejtën e kreditorit në qoftë se kreditori nuk e kërkon atë.

Neni 278

Detyrimet e rangjeve më të ulëta

1. Nëse trashëgimlënësi ka urdhëruar me testament një radhë prioritare mbi pasurinë trashëgimore të një trashëgimtari përpara një trashëgimtari tjetër, atëherë vullneti i tij do të mbizotërojë.
2. Detyrimet ndaj kreditorëve të përjashtuar nga procedura e paraqitjes së pretendimeve ndaj pasurive ose të kreditorëve të përjashtuara sipas nenit 378 të Kodit Civil do të përmbushen vetëm pas detyrimeve të përmendura në nenet Neni 48 dhe Neni 49, nëse janë pjesë e detyrimeve sipas pikës 1 të këtij neni, këto detyrime përmbushen vetëm pas detyrimeve me të cilat ato do të ishin në të njëjtin rang. Në aspekte të tjera, kufizime të tilla nuk do të ndikojnë në rendin e kërkesave.

Neni 279

Objektet e kthyera

Çdo objekt i cili i kthehet aseteve të përfshira në procedurën e falimentimit për shkak të kundërshtimit të transaksionit të bërë nga trashëgimlënësi ose të bëra në lidhje me të, mund të mos përdoret për përmbushjen e detyrimeve të përmendura në nenin Neni 278 pika 1.

Neni 280

Blerja e Pasurisë trashëgimore

1. Nëse trashëgimtari ka shitur pasurinë e trashëguar, vendin e tij në procedurat e falimentimit e zë blerësi i saj.
2. Trashëgimtari mund të kërkojë hapjen e procedurës së falimentimit si një kreditor i pasurisë trashëgimore në lidhje me një detyrim që rëndon mbi pasurinë e trashëgimlënësit i cili rëndon për t'u shlyer nga blerësi për shkak të marrëdhënies së tij kontraktore me trashëgimtarin. Trashëgimtari ka të njëjtën të drejtë në lidhje me një detyrim tjetër që rëndon mbi pasurinë trashëgimore përveçse kur trashëgimtari është subjekt me përgjegjësi të pakufizuar ose kur i është ngarkuar administrimi i pasurisë trashëgimore. Nenet Neni 274, Neni 275 paragrafi 1, pika 1 dhe Neni 277, do të zbatohen për trashëgimtarin që hyn me zëvendësim për shitjen e bërë nga ky i fundit të pasurisë së trashëgimlënësit.
3. Paragrafi i parë dhe i dytë i këtij neni, do të zbatohen njëjloj në rastet kur një person ka shitur një pasuri të fituar me anë të kontratës ose në ndonjë mënyrë tjetër duke qenë i detyruar të shesë një pasuri të fituar nga ai me ligj ose në një mënyrë tjetër.

KREU II.

PROCEDURAT E FALIMENTIMIT QË LIDHEN ME BASHKËPRONËSINË E NJË BASHKËSIE TË VAZHDUESHME

Neni 281

Referimi në hapjen e procedurës së falimentimit

1. Në rastet e bashkësisë së vazhdueshme të tilla si shoqëria e thjeshtë, familja bujqësore dhe të tjera të ngjashme me to, nenet Neni 267 deri Neni 280 do të zbatohen njëjloj në procedurën e falimentimit që ka të bëjë me pasurinë e përbashkët.
2. Vetëm ata kreditorë, pretendimet e të cilëve kanë ekzistuar si detyrime mbi pronën e përbashkët kur ky bashkim u krijua, do të jenë kreditorë të procedurës së falimentimit.
3. Pasardhësit me të drejtë të pjesshme nuk kanë të drejtë të kërkojnë hapjen e procedurës. Ata do të dëgjohen nga gjykata e falimentimit në rastin e një kërkesë për të hapur procedurën e falimentimit.

KREU III.

PROCEDURA E FALIMENTIMIT LIDHUR ME ADMINISTRIMIN E PËRBASHKËT TË PASURISË SË PËRBASHKËT MARTESORE

Neni 282

E drejta për të paraqitur kërkesë. Kushtet për hapjen e procedurës së falimentimit

1. Çdo kreditor i cili mund të kërkojë përmbushjen e një detyrimi nga pasuria bashkëshortore ka të drejtë të kërkojë hapjen e procedurave të falimentimit në lidhje me pasurinë e përbashkët të administruar bashkërisht nga bashkëshortët.

2. Çdo bashkëshort ka të drejtë të paraqesë kërkesë. Nëse kërkesa nuk është ngritur nga të dy bashkëshortët, ajo do të jetë e pranueshme nëse natyra e pasurisë bashkëshortore që nuk lidhet me likuiditetet është treguar në mënyrë të pranueshme në gjykatë. Gjykata e falimentimit dëgjon bashkëshortin tjetër. Nëse kërkesa është paraqitur nga të dy bashkëshortët, mungesa e pashmangshme e likuiditeteve përbën arsye për hapjen e procedurës.

Neni 283

Përgjegjësia personale e bashkëshortëve

1. Gjatë procedurave të falimentimit, përgjegjësia personale e bashkëshortëve për detyrimet, përmbushja e të cilave mund të jetë kërkuar për llogari të bashkëpronësisë së bashkëshortëve mund të kërkohej vetëm nga një kujdestar i caktuar sipas nenit Neni 244 të këtij ligji.
2. Në rastin e një plani falimentimi, pika 1 e nenit Neni 188 të këtij ligji zbatohet njëllë për përgjegjësitë personale të bashkëshortëve.

PJESA E DHJETË.

PROCEDURA E FALIMENTIMIT E LIDHURME SHTETE TË TJERA

KREU I.

DISPOZITA TË PËRGJITHSHME

Neni 284

Qëllimi i procedurave ndërkombëtare të falimentimit

Kjo pjesë e ligjit synon të parashikojë mekanizma efektivë në rastet e falimentimit ndërkombëtar për të promovuar objektivat në lidhje me:

- a) bashkëpunimin ndërmjet gjykatave dhe autoriteteve të tjera të Shqipërisë me shtetet e tjera të përfshira në falimentim ndërkombëtar;
- b) sigurinë më të lartë për tregti dhe investime;
- c) administrimin e drejtë dhe eficient të rasteve të falimentimit ndërkombëtar në mbrojtje të interesave të gjithë kreditorëve dhe personave të tjerë të interesuar, përfshirë edhe debitorin;
- d) mbrojtjen dhe maksimizimin e vlerës së pasurisë së debitorit, dhe
- e) lehtësimin e shpëtimit të shoqërive me probleme financiare, duke mbrojtur kështu, investimet, si edhe tregun e punës.

Neni 285

Kufijtë e zbatimit të procedurave ndërkombëtare të falimentimit

1. Ky ligj zbatohet kur:

- a) kërkohet ndihmë nga një gjykatë e huaj ose një përfaqësues i huaj në lidhje me një procedurë falimentimi, ose
- b) kërkohet ndihmë në një shtet të huaj në lidhje me një procedurë sipas këtij ligji, ose
- c) zbatohen njëkohësisht një procedurë e huaj si edhe një procedurë sipas këtij ligji, ose
- d) kreditorët ose persona të tjerë të interesuar në një shtet të huaj kanë një interes në lidhje me kërkesën ose pjesëmarrjen në një procedurë falimentimit sipas këtij ligji.

2. Këto dispozita nuk aplikohet për procedurat që lidhen me debitorët që operojnë në sektorët me interes publik ose strategjik sipas nenit Neni 11 të këtij ligji.

Neni 286

Detyrimet ndërkombëtare të Shqipërisë sipas ligjit të falimentimit

Nëse ky ligj bie ndesh me detyrimet që burojnë nga marrëveshje të nënshkruara midis shtetit shqiptar me shtete të tjera, detyrimet e këtyre të fundit mbizotërojnë mbi këtë ligj.

Neni 287
Juridiksioni i falimentimit ndërkombëtar

Njohja e procedurës së huaj dhe bashkëpunimi me gjykatate huaja dhe organe të tjera kompetente është në kompetencë të gjykatës së falimentimit.

Neni 288
Autorizimi i administratorit të falimentimit për të vepruar jashtë Shqipërisë

Administratori i falimentimit, është i autorizuar që të veprojë jashtë Shqipërisë sipas procedurave të këtij ligji dhe në pajtim me legjislacionin e vendit në të cilin do kryejë veprimet.

Neni 289
Refuzimi për Papajtueshmëri me Rendin Publik

Ky ligj nuk e ndalon gjykatën e falimentimit që të refuzojë kryerjen e një veprimi, nëse nuk pajtohet me parimet bazë të legjislacionit shqiptar.

Neni 290
Ndihma për përfaqësuesin e huaj

Ky ligj nuk i kufizon kompetencat e gjykatës së falimentimit ose të administratorit të falimentimit që, sipas legjislacionit shqiptar, t'i ofrojnë ndihmë përfaqësuesit të huaj.

Neni 291
Interpretimi

Gjatë zbatimit të dispozitave mbi falimentimin ndërkombëtar, gjykata e falimentimit zbaton parimin e mirëbesimit në mënyrë të njëjtë në rastin kur ka nevojë për interpretimin e normave me karakter ndërkombëtar.

KREU II.
AKSESI I PËRFAQËSUESVE DHE KREDITORËVE TË HUAJ PËRPARA
GJYKATËS SË FALIMENTIMIT

Neni 292
E drejta për akses të drejtpërdrejtë

Përfaqësuesi i huaj është i legjitimuar të aplikojë drejtpërdrejtë në gjykatën shqiptare të falimentimit.

Neni 293

Juridiksioni i kufizuar

Legjitimimi i përfaqësuesit për t'iu drejtuar gjykatës shqiptare të falimentimit nuk mund të interpretohet si zgjerim i juridiksionit të gjykatave shqiptare mbi përfaqësuesin e huaj ose pasuritë e huaja dhe biznesin e debitorit, për qëllime të tjera nga ai i aplikimit.

Neni 294

E drejta e përfaqësuesit të huaj për fillimin e procedurës të falimentimit

Përfaqësuesi i huaj, mund të kërkojë hapjen e procedurave të falimentimit vetëm nëse ekzistojnë shkaqet e parashikuara në këtë ligj.

Neni 295

Pjesëmarrja e një përfaqësuesi të huaj në procedurë falimentimi shqiptare

Pas njohjes së një procedure të huaj, përfaqësuesi i huaj ka të drejtë të marrë pjesë në procedurë ndaj debitorit në pajtim me këtë ligj.

Neni 296

Aksesi i Kreditorëve në procedurë sipas ligjit shqiptar të falimentimit

1. Kreditorët e huaj kanë të njëjtat të drejta si çdo kreditor në Shqipëri për hapjen dhe pjesëmarrjen në procedurat e falimentimit sipas këtij ligji.
2. Paragrafi i parë i këtij neni nuk ndryshon radhën e pretendimeve në një procedurë falimentimi sipas këtij ligji, me përjashtim të faktit që, pretendimet e kreditorëve të huaj ulen në rangje më të ulëta sesa ato të kreditorëve të siguruar vetëm për shkak të mbajtjes së pretendimit nga një kreditor i huaj.

Neni 297

Njoftimi i kreditorëve të huaj në një procedurë falimentimi sipas ligjit shqiptar

1. Njoftimi u jepet kreditorëve të njohur që nuk kanë adresë në Shqipëri. Gjykata e falimentimit mund të kërkojë që të merren masat e duhura për të njoftuar çdo kreditor për të cilët nuk dihen adresat.
2. Njoftim për kreditorët e huaj bëhet individualisht vetëm nëse gjykata e falimentimit nuk konsideron që, nën rrethana të caktuara, të përdori format të tjera më të përshtatshme komunikimi. Komunikimi i kreditorëve të njohur të huaj mund të bëhet me njoftim në gazeta të huaja nëse administratori i falimentimit e konsideron këtë mënyrë si të përshtatshme për të siguruar njoftimin e kreditorëve të njohur të falimentimit. Nuk kërkohen letra zyrtare.

3. Njoftimi i hapjes së procedurës së falimentimit që i dërgohet kreditorëve të huaj duhet të:

- a) tregojë një periudhë të arsyeshme kohore për të regjistruar pretendimet dhe të specifikojë vendin e regjistrimit;
- b) tregojë nëse kreditorët e siguruan duhet të regjistrojnë pretendimet e tyre, si edhe
- c) përmbajë çdo informacion tjetër që duhet të përfshihet në një njoftim të tillë ndaj kreditorëve në Shqipëri sipas këtij ligji, përfshirë urdhrat e gjykatës të falimentimit.

KREUIII.

NJOHJA E PROCEDURAVE TË HUAJ TË FALIMENTIMIT DHE NDIHMAT

Neni 298

Kërkesa për njohje të procedurës së huaj

1. Përfaqësuesi i huaj mund të paraqesë pranë gjykatës të falimentimit një kërkesë për njohje të procedurës së huaj në të cilën është emëruar.
2. Kërkesës për njohje të procedurës së huaj i bashkëlidhet:
 - a) një kopje e certifikuar e vendimit për hapjen e procedurës së huaj dhe emërimin e përfaqësuesit të huaj, ose
 - b) një vërtetim nga gjykata e huaj që konfirmon ekzistencën e procedurës së huaj dhe emërimin e përfaqësuesit të huaj, ose
 - c) në mungesë të provave të parashikuara në germën ‘a’ dhe ‘b’ të kësaj pike, çdo provë tjetër të pranueshme nga gjykata e falimentimit mbi ekzistencën e procedurës të huaj dhe emërimin e përfaqësuesit të huaj.
3. Kërkesa për njohjen e procedurës së huaj shoqërohet nga një deklaratë që identifikon të gjitha procedurat e huaja në lidhje me debitorin që janë në njohuri të përfaqësuesit të huaj.
4. Gjykata e falimentimit mund të kërkojë përkthimin në shqip të dokumenteve të dhëna në kërkesën e njohjes të procedurës së huaj.

Neni 299

Prezumime në lidhje me njohjen

1. Nëse vendimi ose vërtetimi i parashikuar në pikën e dytë të nenit Neni 298 tregon që procedura e huaj është një procedurë sipas nenit Neni 3, pika 26, dhe që përfaqësuesi i huaj është një person ose institucion sipas të nenit Neni 3, pika 23, gjykata e falimentimit mund t'i konsiderojë faktet si të vërtetuara.
2. Dokumentet e dorëzuara bashkëlidhur kërkesës për njohje, mund të konsiderohen autentike nga gjykata e falimentimit, pa marr parasysh nëse janë legalizuar.
3. Nëse nuk provohet e kundërta, konsiderohet se selia e debitorit, ose vendbanimi i tij nëse bëhet fjala për person fizik, është qendra e tij kryesore e interesit.

Neni 300
Vendimi mbi njohjen e procedurës së huaj

1. Sipas nenit Neni 289 të këtij ligji, një procedurë e huaj njihet si e tillë nëse:
 - a) procedura e huaj është një procedurë sipas kuptimit të nenit Neni 3, pika 26 e këtij ligji;
 - b) përfaqësuesi i huaj që aplikon për njohjen e procedurës së huaj, është një person ose institucion sipas kuptimit të nenit Neni 3, pika 23 e këtij ligji;
 - c) kërkesa për njohjen e procedurës së huaj plotëson kriteret e pikës 2 të nenit Neni 298 të këtij ligji, dhe
 - d) kërkesa është regjistruar në gjykatën e falimentimit sipas nenit Neni 287 të këtij ligji.
2. Procedura e huaj njihet:
 - a) si një procedurë e huaj kryesore, nëse zhvillohet në shtetin ku debitori ka qendrën kryesore të interesit, ose
 - b) si një procedurë e huaj dytësore, nëse debitori ka në shtetin e huaj një vendndodhje sipas pikës 29 të nenit Neni 3 të këtij ligji.
3. Aplikimi për njohjen e procedurës të huaj, vendoset në kohën më të shkurtër të mundshme.
4. Nenet Neni 298, Neni 299, Neni 300 dhe Neni 301 të këtij ligji nuk ndalojnë modifikimin ose mbylljen e njohjes së procedurës së huaj, nëse provohet që kushtet e njohjes nuk janë të plota ose kanë pushuar së ekzistuari.

Neni 301
Informacionet e mëvonshme

Nga momenti i kërkesës për njohjen e procedurave të huaja, përfaqësuesi i huaj informon gjykatën e falimentimit menjëherë mbi:

- a) çdo ndryshim të konsiderueshëm në statusin e procedurës së huaj të njohur ose në statusin e emërimit të përfaqësuesit të huaj, si edhe
- b) çdo tjetër procedurë të huaj në lidhje me debitorin, për të cilën përfaqësuesi i huaj është në dijeni.

Neni 302
Ndihma që ofrohet gjatë aplikimit për njohjen e procedurës së huaj

1. Pas kërkesës për njohjen e procedurës së huaj dhe derisa të merret vendimi, me kërkesën e përfaqësuesit të huaj, gjykata e falimentimit mund të garantojë një ndihmë të përkohshme aty ku është e nevojshme për të mbrojtur pasurinë e debitorit ose interesat e kreditorëve, duke përfshirë:
 - a) bllokimin e ekzekutimit kundrejt pasurisë së debitorit sipas germës ‘a’ dhe ‘b’ të pikës 2 të nenit Neni 31 të këtij ligji.
 - b) vendosjen e administrimit ose realizimin e një pjese ose të gjithë pasurisë të debitorit që ndodhet në Shqipëri, për të mbrojtur dhe ruajtur vlerën e pasurisë, që për natyrën ose për shkak të rrethanave, mund të humbasë vlerë ose të vihet në rrezik, me anë të përfaqësuesit të huaj ose të një administratori të përkohshëm falimentimi.

- c) çdo ndihmë të parashikuar nga germa ‘c’, ‘d’ dhe ‘g’ e pikës 1 të nenit Neni 304 të këtij ligji.
2. Nëse nuk parashikohet ndryshe në germën ‘f’ të pikës 1 të nenit Neni 304 të këtij ligji, ndihma e garantuar sipas këtij neni, mbaron kur merret vendimi për zbatimin e njohjes së procedurës.
3. Gjykata e falimentimit mund të refuzojë të garantojë ndihmën sipas këtij neni, nëse kjo do të ndërhynte me administrimin e procedurës së huaj.

Neni 303

Efektet e njohjes së procedurës kryesore të huaj

1. Pas njohjes së një procedure të huaj që është procedurë kryesore:
- a) ndalohet hapja ose vazhdimi i veprimeve ose procedurave individuale në lidhje me pasuritë, të drejtat, detyrimet e debitorit;
 - b) ndalohet ekzekutimi kundrejt pasurisë së debitorit;
 - c) pezullohet e drejta për të transferuar, penguar ose disponuar pasuritë e debitorit.
2. Qëllimi, ndryshimi dhe heqja e bllokimit dhe pezullimit të referuar në pikën 1 të këtij neni, vendosen nga gjykata e falimentimit sipas këtij ligji ose kur procedura kryesore e huaj nuk garanton interesat e mira të subjekteve shqiptare.
3. Pika 1, germa ‘a’ e këtij neni nuk ndryshon të drejtën për të ndërmarrë veprime individuale ose procedura në masën e nevojshme për të ruajtur një pretendim ndaj një debitorit.
4. Pika 1 e këtij neni nuk ndryshon të drejtën për të kërkuar hapjen e një procedure ose të drejtën për të regjistruar pretendimet sipas këtij ligji.

Neni 304

Ndihma që mund të garantohet pas njohjes së një procedure të huaj

1. Pas njohjes së procedurës së huaj, pavarësisht nëse është kryesore ose dytësore, nëse është e nevojshme për shkak të mbrojtjes së pasurisë së debitorit ose interesave të kreditorëve, me kërkesë të përfaqësuesit të huaj, gjykata e falimentimit mund të ofrojë ndihmë duke vendosur masa mbi:
- a) ndalimin e fillimit të procedurave te reja ose vazhdimin e veprimeve ose procedurave individuale në lidhje me pasurinë, të drejtat, detyrimet dhe përgjegjësitë e debitorit, nëse këto nuk janë ndërprerë sipas parashikimeve të germës ‘a’ të pikës 1 të nenit Neni 303;
 - b) ndalimin e ekzekutimit ndaj pasurisë së debitorit nëse nuk është ndërprerë sipas germës ‘b’ të pikës 1 të nenit Neni 303;
 - c) ndalimin e të drejtës së transferimit, ngarkimit ose disponimit të pasurisë së debitorit, nëse kjo nuk është ndërprerë sipas germës ‘c’ të pikës 1 të nenit Neni 303;
 - d) dëgjimin e dëshmitarëve ose dhënien e provave të tjera, si dhe dhënien e të dhënave në lidhje me pasurinë, veprimtarinë, të drejtat, detyrimet dhe përgjegjësitë e debitorit;
 - e) besimin ndaj përfaqësuesit të huaj ose një personi tjetër të zgjedhur nga gjykata e falimentimit, për administrimin ose shitjen e pasurisë së debitorit e cila gjendet në Shqipëri;

- f) zgjatjen e vlefshmërisë së masave sipas pikës 1 të nenit Neni 302 të këtij ligji;
 - g) dhënien e autorizimeve të tjera që ka administratori i falimentimit në bazë të këtij ligji dhe vendosjen e ndalimeve të tjera sipas këtij ligji.
2. Pas njohjes së procedurës së huaj, kryesore ose dytësore, me kërkesë të përfaqësuesit të huaj, gjykata e falimentimit mund t'i besoj përfaqësuesit të huaj ose një personi tjetër, zbatimin e shpërndarjes së pasurisë së debitorit e cila gjendet në Shqipëri, me kusht që gjykata e falimentimit të përcaktojë se është siguruar mbrojtja e përshtatshme e interesit të kreditorëve në Shqipëri.
3. Në dhënien e ndihmës ndaj një përfaqësuesi të huaj në rastin e një procedure dytësore të huaj sipas këtij ligji, gjykata e falimentimit përcakton që ndihma qëi referohet pasurisë disponohet në kuadër të procedurë dytësore të huaj ose i referohet të dhënave që nevojiten në procedurë.

Neni 305

Mbrojtja e kreditorëve dhe personave të tjerë të interesuar

1. Gjatë marrjes së vendimit mbi dhënien ose refuzimin e ndihmës sipas neneve Neni 302 dhe Neni 304 të këtij ligji, ose vendimit mbi ndryshimin ose shfuqizimin e masave të tilla në pajtim me paragrafin e tretë të këtij neni, gjykata e falimentimit siguron nëse është siguruar mbrojtja adekuatë e interesave të kreditorëve dhe personave të tjerë të interesuara, duke përfshirë edhe debitorin.
2. Gjkata mund të kushtëzojë efektin e masave të vendosura sipas neneve Neni 302 dhe Neni 304 të këtij ligji, në mënyrën që e vlerëson të përshtatshme.
3. Me kërkesë të përfaqësuesit të huaj ose personit tek i cili ndikojnë masat e vendosura në kuadër të ofrimit të ndihmës sipas neneve Neni 302 dhe Neni 304 të këtij ligji ose sipas detyrës, gjykata e falimentimit mund t'i ndryshojë ose t'i shfuqizojë masat e vendosura.

Neni 306

Veprimet për të shmangur dëme ndaj kreditorëve

1. Pas njohjes së procedurës së huaj, përfaqësuesi i huaj mund të marrë masa për të shmangur ose anuluar aktet që dëmtojnë kreditorët.
2. Kur procedura e huaj është procedurë dytësore e huaj, gjykata përcakton se veprimet e lidhura me pasurinë, sipas ligjit shqiptar, administrohen në kuadër të procedurës dytësore të huaj.

Neni 307

Ndërhyrja e përfaqësuesit të huaj në procedurën e falimentimit që zhvillohet në Shqipëri

Pas njohjes së procedurës së huaj në pajtim me ligjin shqiptar, përfaqësuesi i huaj mund të jetë pjesëmarrës në çdo procedurë në të cilën debitori është palë.

KREUIV.
BASHKËPUNIMI ME GJYKATAT E HUAJA DHE PËRFAQËSUESIT E HUAJ

Neni 308

Bashkëpunimi dhe komunikimi i drejtpërdrejtë midis gjykatës së falimentimit dhe gjykatave të huaja ose përfaqësuesve të huaj

1. Në rastet e parashikuara në nenin Neni 284 të këtij ligji, gjykata e falimentimit duhet të bashkëpunojë sa më ngushtë të jetë e mundur me gjykatat e huaja ose përfaqësuesit e huaj, në mënyrë të drejtpërdrejtë ose nëpërmjet administratorit të falimentimit.
2. Gjykata ka të drejtë të komunikojë ose të kërkojë informacion ose ndihmë të drejtpërdrejtë nga gjykatat e huaja ose përfaqësuesit e huaj.

Neni 309

Bashkëpunimi dhe komunikimi i drejtpërdrejtë midis administratorit të falimentimit dhe gjykatave të huaja ose përfaqësuesve të huaj.

1. Në rastet e parashikuara në nenin Neni 284 të këtij ligji, administratori i falimentimit është i detyruar që, gjatë ushtrimit të detyrave të veta dhe nën mbikëqyrjen e gjykatës së falimentimit, të bashkëpunojë sa më ngushtë që mundet me gjykatat e huaja ose me përfaqësuesit e huaj.
2. Administratori i falimentimit ka të drejtë, gjatë ushtrimit të detyrave të veta dhe nën mbikëqyrjen e gjykatës së falimentimit, t'i drejtohet drejtpërdrejtë gjykatave të huaja ose përfaqësuesve të huaj.

Neni 310

Format e bashkëpunimit

Bashkëpunimi sipas neneve Neni 308 dhe Neni 309 të këtij ligji mund të zbatohet në mënyrë të përshtatshme, posaçërisht:

- a) me emërimin e personit ose organit që ndërmerr veprimet sipas urdhrit të gjykatës së falimentimit;
- b) me komunikimin e të dhënave në mënyrën që gjykata e falimentimit vlerëson si më të përshtatshme;
- c) me ndërthurjen e administrimit dhe mbikëqyrjes së pasurisë dhe veprimtarisë së debitorit;
- d) me miratimin dhe zbatimin e marrëveshjeve mbi ndërthurjen e procedurave nga ana e gjykatave;
- e) me ndërthurjen e procedurave të menjëhershme që udhëhiqen ndaj debitorit të njëjtë.

KREUV PROCEDURA TË NDËRTHURURA

Neni 311

Hapja e procedurës së falimentimit pas njohjes së procedurës kryesore të huaj

1. Pas njohjes së procedurës kryesore të huaj, mund të hapet një procedurë falimentimi në Shqipëri sipas këtij ligji, vetëm nëse debitori ka pasuritë e tij në Shqipëri.
2. Efektet e kësaj procedure kufizohen në pasurinë e debitorit në Shqipëri dhe, në masën e nevojshme për të bashkëpunuar dhe koordinuar sipas neneve Neni 308, Neni 309 dhe Neni 310 të këtij ligji, mbi pasurinë tjetër të debitorit, që sipas këtij ligji, duhet administruar në procedurën e falimentimit.

Neni 312

Ndërthurja e procedurës së falimentimit dhe procedurës së huaj

1. Kur procedura e huaj dhe procedura e falimentimit udhëhiqen njëkohësisht ndaj të njëjtit debitor, gjykata e falimentimit kërkon bashkëpunim dhe ndërthurjennë pajtim me nenet Neni 308, Neni 309 dhe Neni 310 të këtij ligji dhe sipas parashikimeve në vijim:
2. Kur në kohën e paraqitjes së kërkesës për njohje të procedurës së huaj është paraqitur propozimi për fillim të procedurës së falimentimit:
 - a) çdo ndihmë që ofrohet në pajtim me nenet Neni 302 dhe Neni 304 të këtij ligji duhet të jetë në pajtim me procedurat e falimentimit në Shqipëri, dhe
 - b) nëse procedura e huaj njihet në Shqipëri si procedurë kryesore falimentimi, neni Neni 303 nuk aplikohet.
3. Kur procedura e falimentimit në Shqipëri hapet pas njohjes ose kërkesës të procedurës së huaj:
 - a) gjykata e falimentimit rishikon çdo ndihmë të ofruar sipas neneve Neni 302 dhe Neni 304 dhe këto do të ndryshohen ose shfuqizohen nëse janë në kundërshtim me procedurat e falimentimit në Shqipëri, dhe
 - b) nëse procedura e huaj është një procedurë kryesore e huaj, ndalimi dhe pezullimi i referuar në pikën 1 të nenit Neni 303 ndryshohen ose shfuqizohen sipas pikës 2 të nenit Neni 303, nëse janë në kundërshtim me procedurat e falimentimit në Shqipëri.
4. Gjatë vendosjes, zgjatjes ose ndryshimit të ndihmës të ofruar kundrejt një përfaqësuesi të një procedure dytësore të huaj, gjykata e falimentimit përcakton se ndihma i referohet pasurisë që, nën ligjin shqiptar, administrohet në procedurën dytësore të huaj ose lidhet me të dhënat e kërkuara në këtë procedurë.

Neni 313

Ndërthurja e disa procedurave të huaja

Në rastet sipas nenit Neni 284 kur ndaj një debitori ka më shumë se një procedurë të huaj, gjykata e falimentimit kërkon bashkëpunim dhe ndërthurjen sipas neneve Neni 308, Neni 309 dhe Neni 310, dhe aplikon si më poshtë:

- a) çdo ndihmë që i ofrohet një përfaqësuesi të huaj sipas neneve Neni 302 ose Neni 304 të këtij ligji pas njohjes së procedurës së huaj, duhet të jetë në pajtim me procedurat kryesore të huaja.
- b) nëse vendimi për njohjen e procedurës kryesore të huaj është marrë pas njohjes së procedurës dytësore të huaj ose pas paraqitjes së kërkesës për njohjen e procedurës dytësore të huaj, gjykata e falimentimit rishqyrton çdo ndihmë që është ofruar sipas neneve Neni 302 ose Neni 304 të këtij ligji dhe ndryshon ose shfuqizon të gjitha masat që janë në kundërshtim me procedurën kryesore të huaj.
- c) nëse, pas njohjes së procedurës dytësore të huaj, merret vendimi mbi njohjen e ndonjë procedure tjetër dytësore të huaj, sipas detyrës ose me kërkesë të përfaqësuesit të huaj, gjykata e falimentimit vendos, ndryshon ose shfuqizon masat e ndihmës për qëllim të sigurimit të ndërthurjessë procedurave.

Neni 314

Prezumimi i paaftësisë paguese bazuar në njohjen e një procedure kryesore të huaj

Nëse nuk provohet e kundërta, me qëllimin e hapjes së procedurës së falimentimit, njohja e procedurës kryesore të huaj është provë e paaftësisë paguese të debitorit.

Neni 315

Shlyerja e pagesave në procedurat e ndërthurura

Kreditori, pretendimi i të cilit është shlyer pjesërisht në një procedurë që është zbatuar në pajtim me një ligj që rregullon falimentimin në një Shtet të huaj, nuk mund të shlyhet për të njëjtin pretendim në një procedurë falimentimi në Shqipëri, që drejtohet ndaj të njëjtit debitor, për aq sa shumat e shlyerjes ndaj kreditorëve të tjerë në të njëjtën radhë preferimi janë proporcionalisht më të ulëta nga shuma që ai kreditor ka marrë ndërkohë, pa prekur në këtë situatë, pretendimete kreditorëve të siguruar ose me ripagim të veçantë

PJESA E NJËMBËDHJETË.

AGJENCIA KOMBËTARE E FALIMENTIMIT

Neni 316 **Agjencia Kombëtare e Falimentimit**

Kjo pjesë rregullon krijimin e Agjencisë Kombëtare të Falimentimit (në vijim Agjencia).

Neni 317 **Statusi i Agjencisë**

1. Agjencia është person juridik publik, të drejtat, detyrat dhe përgjegjësitë e së cilës janë të përcaktuara me ligj.
2. Agjencia vepron në përputhje me legjislacionin për shërbimin civil.
3. Agjencia ka selinë e vetë në Tiranë.
4. Organizimi dhe funksionimi i Agjencisë përcaktohen me vendim të Këshillit të Ministrave.

Neni 318 **Përgjegjësitë e Agjencisë**

Agjencia ka përgjegjësitë e mëposhtme:

- a) të japë, të heqë ose të rinovojë licenca për administratorët e falimentimit, në përputhje me parashikimet e bëra në ligj;
- b) të organizojë dhe të zhvillojë provimin për administratorët e falimentimit;
- c) të mbajë regjistrin e administratorëve të çertifikuar të falimentimit;
- d) të mbikëqyrë veprimtarinë e administratorëve të falimentimit dhe të monitorojë ecurinë dhe zhvillimin e këtij profesioni;
- e) të mbikëqyrë, brenda kompetencave të veta, zbatimin e dispozitave të këtij ligji;
- f) të mbledhë dhe të përpunojë të dhëna statistikore dhe të dhëna të tjera që lidhen me zbatimin e procedurave të falimentimit;
- g) të propozojë kritere lidhur me administrimin e masës së falimentimit dhe Kodin e Etikës;
- h) të kryejë çdo detyrë tjetër sipas këtij ligji.

Neni 319 **Veprimtaria mbikëqyrëse e Agjencisë**

1. Agjencia, gjatë ushtrimit të veprimtarisë të saj mbikëqyrëse, inspekton nëse administratori i falimentimit kryen detyrat në përputhje me këtë ligj, me standardet kombëtare të administrimit të masës së falimentimit, si dhe me Kodin e Etikës të miratuar me Vendim të Këshillit të Ministrave.
2. Agjencia kryen veprimtari mbikëqyrëse të parashikuara në pikën 1 të këtij neni nëpërmjet vlerësimit të raporteve të shkruara të paraqitura nga administratori dhe gjyqtari i falimentimit si dhe në bazë të dokumenteve të tjera të mbajtura në kuadër të veprimeve të administratorit në procedurat e falimentimit.

3. Agjencia është e detyruar të kërkojë të paktën një raportim në çdo 3 muaj nga ana e administratorit të falimentimit, një kopje të të cilit ia dërgon gjykatës së falimentimit.

Neni 320

Ekspertiza e huaj

Për ushtrimin e detyrave të caktuara, të cilat kanë nevojë për ekspertizë të veçantë, Agjencia mund të kontraktojë persona fizikë ose juridikë, vendas ose të huaj.

Neni 321

Burimet e financimi të Agjencisë

Burimet financiare për krijimin dhe funksionimin e Agjencisë sigurohen nga Buxheti i Shtetit, si dhe nga tarifat e realizuara nga veprimtaria e saj.

Neni 322

Kundërvajtjet Administrative

1. Depozitimi i dokumenteve dhe deklaratave që përmbajnë të dhëna të rreme nga debitori, anëtar i bordit të drejtorëve ose organit drejtues, ndonjë nga ortakët ose ndonjë person që vepron në emër të debitorit, nëse nuk përbëjnë vepër penale, konsiderohet kundërvajtje administrative dhe dënohet nga gjykata e falimentimit me gjobë nga 50 000 (pesëdhjetë mijë) lekëderi në 200 000 (dyqind mijë) lekë.
2. Depozitimi i dokumenteve dhe deklaratave që përmbajnë të dhëna të rreme nga një person fizik që kërkon të hapë një procedurë falimentimi, nëse nuk përbën vepër penale, konsiderohet kundërvajtje administrative dhe dënohet nga gjykata e falimentimit me gjobë nga 50 000 (pesëdhjetë mijë) deri në 200 000 (dyqind mijë) lekë.
3. Fshehja, transferimi ose tjetërsimi i pasurisë ose dokumenteve për administratorin ose gjykatën e falimentimit, me qëllim pengimin e procedurës së falimentimit, nëse nuk përbën vepër penale konsiderohet kundërvajtje administrative dhe dënohet nga gjykata e falimentimit me gjobë nga 50 000 (pesëdhjetë mijë) deri në 200 000 (dyqind mijë) lekë.
4. Mospërmbushja e detyrimeve të përcaktuara nga nenet Neni 92, Neni 94 dhe Neni 96 të këtij ligji konsiderohet kundërvajtje administrative dhe dënohet nga gjykata e falimentimit me gjobë nga 50 000 (pesëdhjetë mijë) deri në 200 000 (dyqind mijë) lekë.
5. Kundër vendimit të gjykatës së falimentimit mund të bëhet ankim në gjykatën e Apelit.

Neni 323

Kundërvajtjet administrative të administratorit

1. Moszbatimi i vendimeve ose urdhrave të gjykatës së falimentimit nga ana e administratorit të falimentimit, nëse nuk përbën vepër penale, konsiderohet kundërvajtje administrative dhe dënohet nga gjykata e falimentimit me gjobëduke filluar nga 50 000 (pesëdhjetë mijë) lekë deri në 200 000 (dyqind mijë) lekë.
2. Refuzimi i administratorit të falimentimit për të dorëzuar pasuritë dhe dokumentacionin përkatës në rastin kur ai shkarkohet nga detyra, konsiderohet kundërvajtje administrative dhe

dënohet nga gjykata e falimentimit me gjobë duke filluar nga 50 000 (pesëdhjetë mijë) lekë deri në 200 000 (dyqind mijë) lekë.

3. Kundër vendimit të gjykatës së falimentimit mund të bëhet ankim në gjykatën e Apelit.

Neni 324 **Dispozita Tranzitore**

1. Ligji nr.8901, datë 23.05.2002 “Për falimentimin”, shfuqizohet.
2. Neni 104 i ligjit nr. 9920 datë 19.05.2008 “Për procedurat tatimore në R. e Shqipërisë”.
3. Të gjitha Vendimet e Këshillit të Ministrave dhe akte nënligjore në zbatim të ligjit nr.8901, datë 23.05.2002 “Për falimentimin”, mbeten në fuqi dhe zbatohen për atë që nuk bien ndesh me këtë ligj.
4. Këshilli i Ministrave miraton brendatë muajve nga hyrja në fuqi e ligjit, aktet nënligjore për zbatimin e tij.

Shfuqizohet neni 104 i ligjit “Për procedurat tatimore”.

Neni 325 **Ky ligj hyn në fuqi**